

## Procesverbal

*Nga Mbledhja III (e tretë) e rregullt e Kuvendit Komunal në Dragash , e mbajtur më datë:  
21.03.2024*

### *Rend Dite*

1. Miratimi i Raportit për zbatimin e Planit Komunal për Integritet për vitin 2023;
2. Propozim – vendim për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2023 në vitin 2024; dhe
3. Miratimi i Raportit të Punës së kryetarit dhe organeve ekzekutive të Komunës së Dragashit për vitin 2023;

**Arijeta Skeraj:** Përshëndetje, kryetar! Përshëndetje anëtarë të Kuvendit dhe të gjithë të pranishmit në sallë! Mirë se keni ardhë në Seancën III të rregullt për vitin 2024. Materialin besoj që e keni pranuar të gjithë. I kemi tri pika të rendit të ditës: Miratimi i Raportit për zbatimin e Planit Komunal për Integritet për vitin 2023; Propozim – vendim për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2023 në vitin 2024; dhe Miratimi i Raportit të Punës së kryetarit dhe organeve ekzekutive të Komunës së Dragashit për vitin 2023. Para se ta qesim në votim rendin e ditës, nëse ka dikush rreth rendit të ditës, mundeni me e marrë fjalën.

**Nexhat Selaj:** Përshëndetje kryesuese, përshëndetje kryetar, kolegë! Po më duket se po përsëritem, kjo është ndoshta hera e tretë që e bëjmë një vërejtje. Te pikat e rendit të ditës, po caktohen, pikë eventuale nuk kemi. Po më vjen pak is zor më thënë, por po detyrohem të them, përpos një sistemi komunist që po zhvillohet në këto seanca, nuk po shoh një pluralizëm demokratik. Pika eventuale, mos lejoni bre kryesuese të largohet nga rendi i ditës! Pikat të cilat po i caktoni, numrat i keni, gishtat i keni, pse po vijmë ne? Në pikën eventuale, unë po besoj se këtu duhet të harxhohen të gjitha ato potenciale, qoftë pozitive, qoftë negative. Kështu që, propozoj që pikë e rendit të ditës të është pika eventuale. Faleminderit!

**Nedžmidin Sejdilar:** Pershendetje te gjitheve, ate qe tha kolegu Selaj dhe une e mbeshtes, mundesisht ta perfshijme piken eventuale, e kuptoj qe agjenda eshte e gjere dhe se kemi raporte per punen e ekzekutivit, por duhet te dime qe keto jane raportet e vitit te kaluar. Kemi shume pyetje per te bere kete vit. Ju lutemi vendoseni ne votim pikene e propozuar, nese eshte e mundur.

**Uran Halimi:** Faleminderit, kryesuese! Përshëndetje për të gjithë ju të pranishëm! Propozimit të z.Selaj dhe z.Sejdilar i bashkëngjitemi edhe ne si GP i LVV-së. Nuk është në pyetje që kemi apo s'kemi çka me thënë, pika eventuale po besoj që është një pjesë ku, përmese neve si delegatë, qytetarët i bien shqetësimet e tyre. Domethënë, mungesa e pikës eventuale është mungesë e zërit qytetar në këtë

Kuvend. Andaj, e nderuara kryesuese, është mirë që me e qit në votim propozimin e grupeve parlamentare. Është mirë edhe nga delegatët e pozitës që me e mbështet, jo për hatër tonin po për hatër të qytetarëve tanë. Faleminderit!

**Shpetim Hajredini:** Faleminderit, kryesuese! Përshëndetje për të gjithë! Desha vetëm një pyetje t'ia bëj ekzekutivit. Këtu na ka ardhë në rend dite, në pikën e tretë, miratimi i Raportit të Punës së kryetarit dhe organeve ekzekutive të Komunës së Dragashit. Ndërsa, në material e kemi edhe planin për vitin 2024. A do ta diskutojmë edhe Planin e Punës për 2024-shin, apo vetëm Raportin, se këtu nuk e kemi të specifikuar Planin hiç.

**Arijeta Skeraj:** Faleminderit, Shpetim! Atëherë, pasi kërkesa e tre asambleistëve nga radhët e PDK-së, VV-së dhe PG-së, ishte kërkesa që pika eventuale të qitet si pikë e rendit të ditës, unë nuk e kam bërë për diçka tjetër, po pasi ka qenë e ngjeshur pika e tretë që ka me raportue kryetari i Komunës bashkë me ekzekutivin, e kam largue. Po pasi është dëshira e juaj, edhe unë e mbështes dhe e qes në votim që pika eventuale të qitet si pikë e rendit të ditës. Kush është pro që të vendoset pika eventuale në rend të ditës? A ka kundër? A ka abstenim? Me 23 vota pro, zero kundër edhe zero abstenim, pika eventuale është pika e katërt e rendit të ditës. Atëherë po fillojmë me pikën e parë: Miratimi i Raportit për zbatimin e Planit Komunal për Integritet për vitin 2023. E ftoj z.Fitim Spahiun që të marrë fjalën, pasi që është koordinator për Planin për Integritet.

**Fitim Spahi:** Faleminderit, znj.Kryesuese! Të nderuar delegatë, para jush prezantoj Raportin e Planit të Integritetit për vitin 2023. Plani i Integritetit është një mjet për vendosjen dhe verifikimin e integritetit të Komunës dhe është një process i dokumenteve për të vlerësuar nivelin e cënueshmërisë së Komunës, ekspozimin e saj ndaj praktikave joetike dhe të korrupsionit. Plani është një dokument operativ që ofron masa të mbështetura tek rreziku, për arritjen e objektivave të integritetit të Komunës. Plani e rithekson përkushtimin e Komunës së Dragashit, duke shtuar dhe fuqizuar kontrollin ekzistues operativ të të gjitha aktiviteteve, duke u fokusuar në ofrimin e shërbimeve efikase, transparente dhe të orientuara kah qytetarët. Plani përshkruan masat e bazuara në rrezikun, për arritjen e objektivave të Komunës, dhe forcimin e sundimit të ligjit, si dhe vlerat dhe standardet profesionale. Ky Raport është hartuar për vitin kalendarik 2023. Raporti për këtë Plan bëhet një herë në vit dhe Kuvendi Komunal duhet ta shqyrtojë dhe ta miratojë këtë Plan. Pastaj ky Plan dorëzohet në organet kompetente, konkretisht në Agjencionin Kundër Korrupsionit. Ky Plan është pjesë domethënëse e arritjes së standardeve të performancës së Komunës, i cili poentohet për arritjen e fitimit të Grantit të Performancës. Në këtë Plan kanë raportuar të gjitha drejtoritë komunale dhe tre sektorë të veçantë, siç janë Njësi i Burimeve Njerëzore, Auditimi i Brendshëm dhe Prokurimi Publik. Pasi që ju e keni pas këtë Plan, e keni shqyrtue, kërkoj që jeni konstruktivë dhe ta bëni miratimin e këtij Plani dhe ky Plan të shkojë më tutje. Faleminderit shumë!

**Arijeta Skeraj:** Faleminderit! A do dikush me e marrë fjalën për këtë pikë të rendit të ditës? Në qoftë se nuk ka, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me 14 vota pro, zero kundër dhe 6 abstenime, miratohet kjo pikë e rendit të ditës. Fillojmë te pika e dytë: Propozim – vendim për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2023 në vitin 2024.

**Bexhet Xheladini:** E nderuar kryesuese, të nderuar delegatë, të nderuar të pranishëm të tjerë, mjete të informimit, përfaqësues të OSBE-së! Ju përshëndes të gjithëve, pasi është mbledhja e parë e Asamblesë në kuadër të muajit të Ramazanit, të gjithëve jua uroj këtë muaj të shenjtë, ju dëshiroj agjërim të lehtë dhe të pranuar nga Zoti! Sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, ju e keni marrë materialin. Asambleja Komunale duhet të debatojë dhe të bjer vendim për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2023 në vitin 2024. Ju e keni marrë propozimin për bartjen e këtyre mjeteve. Unë vetëm dua të theksoj se këto janë mjete të cilat nuk janë shpenzuar në vitin e kaluar, gjithashtu edhe mjetet të cilat është tejkualuar plani i grumbullimit të mjeteve. Në përgjithësi janë 229,515.99 euro. Gjithashtu, ju duhet ta dini se – sigurisht që edhe e dini, sepse shumica jeni delegatë nga përbërja e kaluar – këto mjete të cilat janë bart nga viti i kaluar në këtë vit, duhet të orientohen patjetër në kategoritë e njëjta. Nëse këto mjete kanë qenë të parapara në arsim, atëherë këto mjete patjetër duhet të planifikohen për arsim. Nëse kanë qenë të parapara në shëndetësi, atëherë duhet patjetër të parashihen në shëndetësi. Ndërsa mjetet të cilat nuk janë shpenzuar nga viti i kaluar dhe ato të cilat janë grumbulluar përtej planifikimit, ato kanë mund të planifikohen në të gjitha llojet e kategorive. Unë nuk kam nevojë me humb më shumë kohë me jua lexue tabelën, jam në disponimin tuaj me ju dhënë sqarime në bazë të pyetjeve që ju mund t'i bëni. Faleminderit!

**Driton Ademi:** Faleminderit, kryesuese! Përshëndetje për të gjithë! Atëherë, të tabela numër 4, te qekjo mbuloja e stadionit në fshatin Bresanë. Kryetar, 21 mijë euro – këtu janë lëshue diku 230 mijë euro, me sa e di unë, te mbuloja e stadionit. Plus sivjet i ke edhe 50 mijë euro që janë ndarë për brenda, për parket me ndreq. Unë s'e di çka ke me bo me 21 mijë euro, kurse kërkesa në dëgjimin buxhetor që e kemi mbajt, në mos gabofsha në korrik, ka qenë, siç të kam thënë, për ujin që po vjen te varrezat aty. Me këto 21 mijë euro, ujin te varrezat që po vjen, edhe me e qit te Ura e Madhe na që i themi. Shumë ma mirë është këto 21 mijë euro me i destinue qaty. Ose është edhe një kërkesë tjetër. Ti e dish që para një muaj kemi pas edhe ...kah rruga Bresanë-Zaplluxhe ka shpejtësi shumë të madhe. Kemi nevojë për shumë policë të vdekur për me i vu. Ju gjithmonë po ankoheni, ne nuk po mundim me marrë leje prej ministrisë. Kur juve po ju konvenon me marrë leje prej ministrive të linjave, ju po i merrni ato leje. Pse nuk po e merrni lejen prej ministrisë, qat pjesën e asfaltit për me shti gypin. Shumë lehtë është me e marrë, edhe normal e bini në të njëjtin nivel. Prapë shtroni asfalt edhe e bëni. Ose pjesën e policëve të vdekur. Unë i kam tri propozime: e kisha parapa, ma e mira është qekjo e ujërave që po vijnë të shiut, me e shti. Por një propozim më me rëndësi është te mbuloja e stadionit. Kur e ka mbulue stadionin, nuk

ka pengesa, as gypat e ujit te mbuloja nuk janë. Aty ka pas, në bazë të qytetarëve me sa kam dëgjue, ka pas rrëshqitje të borës që ka mund me i zënë disa nxënës. Nëse ka mundësi do mjete me i nda për pengesa për rrëshqitjen e borës edhe gypa të ujit të palestrës, është mirë. Tash, unë t'i kam dhënë tri opsione, nëse ke naj zgjidhje mirë ishte konë, tani dal unë edhe një herë.

**Bexhet Xheladini:** Driton, unë nuk po them që kërkesat që i bëre nuk janë të arsyeshme, po unë t'i shpjegova në fillim. Mjetet të cilat kanë qenë të parapara me u shpenzue në arsim, duhet patjetër në arsim, nuk mundesh me i destinue, me i çue diku tjetër, nuk kemi të drejtë. Këto mjete kanë qenë të parapara me u shpenzue në arsim. "Mbuloja e stadioni" është emri i projektit që ju e keni propozue para tri viteve. Në kuadër të mbulojës së stadionit është ndërtue ajo salla e sporteve. Kështu që, kanë mbet edhe 21 mijë euro punë të papaguara që jan krye vitin e kaluar. Këto janë paratë të cilat nuk është arrit me u pague vitin e kaluar. Edhe te 50 mijë eurshi po ashtu kanë qenë të planifikuara vitin e kaluar, por për rregullimin e brendshëm të sallës, shtrimin e podit, pajisjen me gola, me kosha, shtruarja e vijave, dhe këtu është e paraparë edhe me i vu ato hekrat për rrëshqitjen e borës. Kështu që, nuk ka mundësi me u ridestinue këto mjete nga arsimi në infrastrukturë rrugore.

**Driton Ademi:** Edhe një pyetje e kam për kryetarin. Kryetar, po thuesh që është e paraparë, a duhet me e fut në bazë të qysh është këtu, ndërtimi i mbulojës së stadionit, me i fut në vazhdimësi edhe pengesat këtu, apo veç është e paraparë. Domethënë, me i fut pengesat për ndalesën e borës. Në përshkrim të projektit a mudim me e bo këtë, a jo? Okej, falemnderit!

**Nedžmidin Sejdlar:** Artikulli 13621 shoh se 10.000 euro mbeten të pashpenzuara për ngrohjen e QKMF. Fondet që planifikoni të investoni në ngrohjen e QKMF. Pse e latë atë staf mjekësor të ngrijë atje lart? Unë personalisht kam qenë atje dhe kam parë që stafi është ngrohur me ngrohës kuarci që nga viti 1963. Tani e shoh që ju mbaruan paratë dhe nuk u dhatë atyre ngrohjen lart.

**Behar Brenoli:** Sa i përket transferimit të fondeve, ju si deputetë keni qenë përgjegjës për destinimin e këtyre fondeve vitin e kaluar, po të kishit lexuar materialin do t'ju kujtohej se vitin e kaluar 25 mijë euro i keni drejtuar shëndetësisë për blerjen e automjeteve. Meqenëse nuk ia dolëm për shkak të kufizimeve të ministrisë, ato mjete janë kthyer sërish dhe këtë vit ato mjete i kemi drejtuar për ndërtimin e qendrës së mjekësisë familjare në Krushevë dhe rregullimin e ngrohjes këtu në Dragash.

**Uran Halimi:** I nderum drejtor, nëse e ke keqkuptue, pyetja ka qenë pse nuk i keni shfrytëzue me kohë këto pare, që me e rregullue nxemjen në QKMF. E jo pikë e rendit të ditës vjet çka ka qenë bartja e mjeteve. Ajo duhet me u bo, është normale, se na s'i lëmë mjetet me ik, mirëpo pyetja ke pse nuk i keni shfrytëzue që me pas nxemje në QKMF. Përgjigjen e ke dhënë jo të duhurën, ose përkthimi ka qenë gabim.

**Bexhet Xheladini:** Megjithëse drejtori e dha sqarimin, unë dua ta plotësoj pak. Vitin e kaluar Asambleja e ka miratue buxhetine dhe ka ndarë 25 mijë euro për blerjen e dy automjeteve për nevojat

e Komunës së Dragashit. Në momentin kur kemi dashtë ne me e shpallë tenderin për blerjen e automjeteve, Qeveria e Kosovës ka prurë një Vendim që komunat nuk kanë të drejtë me shpallë tenderë me ble automjete, por ajo e ka caktuar një kompani qendrore, që përmes saj duhet të bëhet blerja e automjeteve. Por ndërkohë, Qeveria nuk ka mundur ta zgjedhë kompaninë për sigurimin e automjeteve, për arsye se kanë ndodhur ankesa nga ana e kompanive që kanë konkurruar, dhe deri në fund të vitit kjo ankesë nuk është zgjidhë. Kështu që, të gjithë ato komuna të cilat kanë ndarë mjete për blerjen e automjeteve, të gjitha ato mjete iu kanë shkue në suficit, jo vetëm neve por të gjitha komunave të Kosovës. Asnjë komunë s'ka mundur me ble automjete. Kështu që, këto mjete na janë kthyer tash, 25 mijë euro, edhe ne kemi pas të drejtë që këto mjete t'i orientojmë prapë në shëndetësi. Pasi tash nuk ka mundur prapë me ble automjete, ne i kemi orientuar në rregullimin e nxemjes qendrore edhe një pjesë të mjeteve për kompletimin apo përfundimin e punimeve në QMF në Krushehtë. Do të thotë, këto mjete s'kemi mundësi me i çue diku tjetër por vetëm në shëndetësi. Tash vetëm është bërë një riorientim. Vitin e kaluar nuk kanë qenë të planifikuar këto me e bo këtë nxemjen qendrore. Këto kanë qenë të planifikuara për automjete. Faleminderit!

**Arijeta Skeraj:** Faleminderit, kryetar! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Nëse jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro kësaj pike të rendit të ditës? A ka kundër? Abstenim? Me 12 vota pro, 1 kundër dhe dy abstenime, e miratojmë këtë pikë të rendit të ditës. Fillojmë me pikën e tretë: Miratimi i Raportit të Punës së kryetarit dhe organeve ekzekutive të Komunës së Dragashit për vitin 2023.

**Bexhet Xheladini:** Raportit të Punës së kryetarit dhe organeve ekzekutive të Komunës së Dragashit për vitin 2023 dhe Plani i Punës për vitin 2024.

*Qytetarë të Komunës së Dragashit,*

*Bazuar në ligjin për vetëqeverisje lokale Nr.03/L-040 dhe Statutin e Komunës së Dragashit 01nr.06-103/1 i datës 11.09.2008, kam nderin dhe kënaqësinë që para jush të paraqes raportin vjetor janar – dhjetor 2023 për te arriturat, sukseset, angazhimet por edhe sfidat dhe vështirësitë me të cilat është përballur Komuna e Dragashit gjatë vitit 2023.*

*Si rezultat i punës së përbashkët dhe bashkëpunimit të mirë brenda dhe jashtë institucionit, kemi arritur që të kryejmë pjesën më të madhe të objektivave, aktiviteteve si dhe detyrave sipas planifikimeve strategjike dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

*Që të jetë sa më transparent për publikun, Komuna e Dragashit përmes këtij dokumenti ka ofruar një pasqyrë të përgjithshme të aktiviteteve të saj, për t'iu dhënë mundësi qytetareve që të njohin dhe vlerësojnë punën e institucioneve Komunale.*

Synimet politike në qeverisje nuk do t'i lexoj, për mos me humbur kohë, ju i keni ato në material. Edhe këto nga disa aktivitete nuk do t'i lexoj, por do të filloj prej gjysmës së kësaj faqe:

- Shoqata "Jetimat e Ballkanit" në bashkëpunim me Komunën e Dragashit kanë përfunduar 4 shtëpi për 4 familje nevojtare në territorin Komunës sonë duke përfshirë pjesën e Opojës dhe Gores, ku këtë vit pritet të përfundohet edhe shtëpia e pestë,
- Janë nënshkruar kontratat për dhënien e subvencioneve për Kulturë, Rini dhe Sport, në Komunën e Dragashit. Prioritet i Komunës është që të vazhdoj të i qëndrojë afër rinisë, kulturës, sportit, etj.
- Blerja e Autoambulancave me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa me cilësore për qytetarët e Komunës sonë,
- Blerja shtese edhe të një traktori për pastrimin e rrugëve nga bora si dhe rekrutimi i stafit për ofrimin e këtyre shërbimeve,
- Komuna e Dragashit ka ndihmuar fermerët me subvencione në vlerë prej 90.000.00 €
- Kemi filluar ndërtimin e stadiumit brenda standardeve që kërkohet, gjithashtu është trasuar edhe rruga brenda standardeve që kërkohet që të shpie te stadiumi i qytezës së Dragashit,
- Jemi në angazhim të gjithmbarshëm si Komunë, për eliminimin e të gjitha deponive ilegale,
- Rritja e transparencës dhe llogaridhënies, disiplina dhe rregulli në të gjithë sektorët, vizita sistematike në terren dhe përballje me shqetësimet e qytetarëve etj.
- Në QKFM-në e Dragashit kemi angazhuar oftamologun, neuropsikiatrin, kardiologun dhe gjinekologun për të ofruar shërbime pa pagesë për qytetarët e Komunës sonë,
- Në kuadër të partneritetit me Zyrën e UNICEF-it, kemi hapur dy qendra me bazë në komunitet në fshatin Bresanë, me qëllim që t'u ofrojmë fëmijëve tanë qasje në shërbime cilësore edukative dhe kushte sa më të mira për zhvillim në fëmijërinë e hershme,
- Kemi zhvilluar takime konsultative me përfaqësues të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, me qëllim të bashkërendimit të veprimeve për të pasur një proces të rregullt të regjistrimit të Popullsisë,
- Përmes organizimit të një takimi njoftues ndërmjet pronarit të kompanisë "Viva Fresh" dhe fermerëve të Komunës së Dragashit, kemi ofruar mbështetjen tonë me qëllim të rritjes së bashkëpunimit ndërmjet bizneseve të sektorit privat dhe fermerëve tanë dhe ofrimit të mundësive për t'i plasuar produktet e tyre në tregun vendor,
- Në bashkëpunim me dy këshillat e Bashkësisë Islame të Opojës dhe Gorës, si dhe Kryqin e Kuq e shoqatën 'Bereqeti', kemi zhvilluar takime dhe aktivitete të përbashkëta për t'u dalë në ndihmë Komunës së Skënderajt dhe komunave të tjera të prekura nga vërshimet,
- Për këtë qëllim, kemi pasur takime edhe me biznese dhe kompani ndërtimore lokale,
- Pas bashkërendimit të aktiviteteve me të gjithë akterët brenda Komunës, kemi pasur një vizitë në Komunën e Skënderajt, ku jemi takuar me Kryetarin Fadil Nura për ta njoftuar në lidhje me iniciativën e ndërmarrë për t'u dalë në ndihmë qytetarëve të Skënderajt të prekur nga vërshimet,
- Kemi zhvilluar takime me përfaqësues të Zyrës Ndërlidhëse Sllovaqe në Prishtinë, për të diskutuar për projektet e financuara nga kjo Zyrë (parku i qytetit) dhe thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit,
- Kemi zhvilluar vizita të rregullta në QKMF, QMF dhe AMF të Komunës, për të përcjellur nga afër, si punimet që janë bërë në renovimin e objekteve, po ashtu edhe ecurinë e punës dhe angazhimin e stafit në ofrimin e shërbimeve shëndetësore për qytetarë,
- Me qëllim të furnizimit të Shërbimit të Zjarrfikësve të Komunës sonë me pajisje teknike dhe mjete të tjera mbështetëse, kemi pasur takime me përfaqësues të CIMIC-ut dhe KFOR-it Italian,
- Në javën e parë të muajit shkurt 2023, kemi marrë njërin ndër vendimet më të rëndësishme që do të ndikojë direkt në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve tanë: Vendimin për fillimin

*e procedurave të tenderimit për projektin e Ujësjellësit Qendror për 15 fshatra dhe qytezën e Dragashit,*

- *Jemi takuar me përfaqësues të Organizatës OFAP me të cilët kemi diskutuar për projektet e mbështetura nga UNICEF-i lidhur ofrimin e zgjidhjeve të qëndrueshme për fëmijet pa pa kujdes prindëror,*
- *Përgjatë gjithë vitit për të cilin po raportojmë kemi pasur takime dhe bashkëpunim të shkëlqyeshëm me Njësinë e LMT-së së KFOR-it Turk në Dragash, Këshillin Turk, shoqatën ‘Yunus Emre’, Konsullatën e Përgjithshme Turke në Prizren dhe Ambasadën e Republikës së Turqisë në Kosovë, ku falë mbështetjes së tyre kemi realizuar një sërë projektesh të rëndësishme, siç janë hapja dhe trasimi i disa rrugëve të bjeshkëve nëpër disa lokalitete në Opojë dhe Gorë, furnizimi me pajisje të ndryshme nëpër institucione shëndetësore dhe arsimore etj.,*
- *Me rastin e shënimit të datave të rëndësishme historike, festave shtetërore e kombëtare, siç janë Flaka e Janarit, Dita e Pavarësisë së Kosovës, Epopeja e UÇK-së dhe 28 Nëntori, kemi përgatitur agjenda me aktivitete të shumta kulturore dhe sportive, turne në futboll me nxënës dhe mësimdhënës nëpër shkolla si dhe me institucione të tjera publike lokale, turne në volejball, programe artistike, orë letrare, defile me nxënës të shkollave etj.*
- *Kemi pritur për një vizitë zyrtare nënkryetaren e Republikës së Bullgarisë, znj. Iljana Jotova, të shoqëruar nga ambasadori i Bullgarisë në Kosovë, z. Hristo Gudjev,*
- *Kemi marrë pjesë në hapjen solemne të Turneut Mbarëkombëtar të Shahut të mbajtur në Dragash, si dhe kemi ofruar përkrahjen tonë për Klubin e Shahut ‘Sharri’ për zhvillimin dhe promovimin e kësaj loje sportive dhe shahistëve nga Komuna jonë,*
- *Kemi ndërmarrë aksione të shpeshta për pastrimin e rrugëve dhe hapësirave publike nëpër të gjithë territorin e Komunës së Dragashit,*
- *Gjatë vitit për të cilin po raportojmë, në bashkëpunim me akterë relevantë institucionalë dhe organizata joqeveritare kemi hartuar një sërë dokumentesh të rëndësishme për Komunën, siç janë Rregullorja për Përcaktimin e Procedurave për Dhënie në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, Statuti i Muzeut të Komunës së Dragashit, Plani i Punës i Ekipit për të Drejtat e Fëmijës, Planin Lokal i Veprimtimit për Barazi Gjinore, ndërkaq jemi në proces të hartimit të Rregullores Komonale për Menaxhimin e Mbeturinave,*
- *Kemi pasur takime me presidentin e Federatës së Futbollit të Kosovës (Agim Ademi) dhe kryetarin e Lidhjes Rajonale të Futbollit (Mirsad Çollaku), me qëllim të thellimit të bashkëpunimit për përmirësimin e infrastrukturës sportive në Komunën e Dragashit,*
- *Me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal dhe Ministrin Fikrim Damka kemi filluar bashkëpunimin për financimin e disa projekteve që do të realizohen në të mirë të të gjitha komuniteteve, siç janë asfaltimi i rrugës së re të stadiumit të qytetit, ndërtimi i shtigjeve të ecjes në fshatin Brod dhe një projekt turistik për Liqenin e Breznes,*
- *Me rastin e 8 Marsit – Ditës Ndërkombëtare të Gruas, me Zyrën për Barazi Gjinore kemi realizuar një takim me gra të të gjitha komuniteteve dhe gjithashtu, bashkë me gratë pjesëmarrëse në këtë takim kemi realizuar një vizitë në Qendrën për Promovimin e të Drejtave të Grave në Drenas, ku jemi njohur për së afërmi aktivitetet dhe punën e grave anëtare të kësaj qendre,*
- *Me OJQ “Avoko” kemi nënshkruar një Memorandum bashkëpunimi për të angazhuar dhjetë të rinj në punë praktike në Administratën Komonale,*
- *Me Ministrinë e Infrastrukturës kemi nënshkruar Memorandumin për Bashkëfinancimin e pjesës së mbetur të rrugës Restelicë – Kufiri i Maqedonisë së Veriut, me vlerë totale 210 mijë euro,*

- Në bashkëpunim me KOSTT-in dhe Bankën Gjermane për Zhvillim kemi nënshkruar Marrëveshjen për ndërtimin e Nënstacionit të ri 110/35/10 kV në Dragash,
- Kemi zhvilluar takime të shpeshta me përfaqësues të Postës së Kosovës, me qëllim të thellimit të bashkëpunimit për të ngritur cilësinë e shërbimeve komunale për qytetarët tanë,
- Në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës, kemi themeluar Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijës dhe Sekretariatit të Ekipit, me të cilët kemi zhvilluar takime të rregullta dhe kemi hartuar Planin e Punës për të rritur angazhimin komunal në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të të gjithë fëmijëve pa dallim. Nëpërmjet këtij mekanizmi synohet të krijohen kushte dhe mjedise të favorshme për zhvillimin e fëmijëve, duke garantuar mbrojtjen e tyre nga çdo formë e dhunës, shfrytëzimit, dhe diskriminimit,
- Me Federatën e Futbollit të Kosovës kemi nënshkruar Memorandum të Bashkëpunimit për financimin e përbashkët të projektit për ndërtimin e Stadiumit të qytetëzës së Dragashit,
- Me qëllim të reformimit në tërësi të sistemit të menaxhimit të mbeturinave dhe krijimit të një ambienti sa më të pastër, kemi ndërmarrë hapa të rëndësishëm me JICA-n japoneze për hartimin e Rregullores së re komunale për menaxhimin e mbeturinave,
- Kemi nënshkruar Marrëveshje të Mirëkuptimit me Forumin Kosovar të Aftësisë së Kufizuar për angazhimin e një asistenti mbështetës për fëmijët me nevoja të veçanta në ShFMU “Fetah Sylejmani” në Dragash,
- Me ministrin e Zhvillimit Rajonal, z.Fikrim Damka, kemi nënshkruar Marrëveshje të Mirëkuptimit për bashkëfinancim të projektit “Asfaltimi i rrugës për te Stadiumi i qytetit me infrastrukturë përcjellëse”,
- Kemi pasur bashkëpunime të vazhdueshme me përfaqësues të Policisë së Kosovës, Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, lidhur me konkurset për pranim të kandidatëve në Polici dhe FSK, ku kemi ofruar mbështetjen tonë dhe kemi informuar qytetarët për mundësitë dhe procedurat e rekrutimit në këto institucione,
- Kemi zhvilluar takime të ndryshme me përfaqësues të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit “Hidroregjioni Jugor”, me të cilët kemi dakorduar për bashkëpunim në përmërsimin e kushteve infrastrukturore dhe teknike të stafit të Njësisë së Hidroregjionit në Dragash, e po ashtu edhe në rritjen e shërbimeve të kësaj kompanie për qytetarët e Komunës sonë, pas përfundimit të projektit të Ujësjellësit qendror,
- Në bashkëpunim me CIMIC-un e KFOR-it Italian, kemi siguruar pajisje teknike të nevojshme për Shërbimin e Zjarrfikësve në Komunën tonë,
- Në bashkëpunim me Qendrën për Promovimin e të Drejtave të Grave në Drenas kemi hapur Këndin e Kurajos brenda objektit të Komunës, ku ekspozohen punime të ndryshme dore të punuara nga gratë e kësaj Qendreje,
- Në qershor të vitit për të cilin po raportojmë, për një vizitë në zyrën time kam pritur edhe kryeministrin e Kosovës, z.Albin Kurti, të cilin e kam informuar për sfidat dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohemi çdo ditë si Komunë, si dhe kam kërkuar bashkëpunim dhe ndihmë nga Qeveria për projekte të rëndësishme që lidhen me mirëqenien e qytetarëve, e sidomos për projektin kryesor kapital të Ujësjellësit kryesor,
- Kemi organizuar një ceremoni, ku i kemi shpërblyer me disa dhurata simbolike të gjithë kontributdhënësit e pensionuar gjatë periudhës njëvjeçare të administratës komunale, arsimit dhe shëndetësisë së Komunës tonë,
- Në një vizitë studimore në Turqi, së bashku me grupin e Asamblistëve, kryesuesin e asamblesë ,nënkryetarin e Komuniteteve dhe shefin e zyrës së Komuniteteve, vizitua Komunën simotër Orhaneli ku u pritëm nga Kryetari i kësaj komune.z.Ali Aykurt. Gjithashtu, vizitua dhe



*komunën e Bursës, ku u pritëm nga nënkryetari I komunës z.Ali Mersin. Në këto takime biseduam për mundësitë e thellimit të bashkëpunimit mes këtyre komunave dhe Komunës së Dragashit, me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe praktikave pozitive,*

- *Në kuadër të aktiviteteve kulturore, kemi organizuar Manifestimin Tradicional “Sofra e Ymer Prizrenit” në fshatin Zgatar, me pjesëmarrës poetë dhe artistë të shumtë nga të gjitha trojet shqiptare,*
- *Në kuadër të Agjendës për Ditën e Çlirimit të Dragashit, për herë të parë kemi organizuar Mitingun e Motokrosit, ku kanë marrë pjesë qindra motoristë nga Kosova dhe rajoni,*
- *Pastaj garat tradicionale të vrapimit të kuajve dhe tërheqjes së peshave të rënda, të cilat poashtu kanë mbledhur pjesëmarrës nga të gjitha anët,*
- *Kemi organizuar Festivalin Folklorik Buurimor me karakter ballkanik “Opoja Vallëzon”, ku kanë performuar shoqëri kulturo-artistike nga Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Ukraina, Polonia, Turqia, Bullgaria, Sanxhaku dhe Novi Pazari,*
- *Në kuadër të këtij Festivali, kemi dhënë mirënjohje dhe dekorata për të gjitha vendet pjesëmarrëse,*
- *Në natën e fundit të këtij Festivali kemi shpallur ‘Qytetare Nderi e Komunës së Dragashit’ znj.Janet Reineck, studiuesen amerikane e cila ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në studimin dhe promovimin e traditave, dokeve, zakoneve dhe veshjeve kombëtare opojane,*
- *Në kuadër të Ditëve të Mërgatës, kemi organizuar aktivitetet të ndryshme me program të larmishëm kulturo-artistik te Liqeni i Breznes, në Brod dhe te vendi i quajtur ‘Koščë’,*
- *Në bashkëpunim me Shoqatën e Afaristëve ‘Sharri’, kemi organizuar Edicionin e Dytë të Panairit me Produkte Vendore Lokale “EXPO SHARRI”, ku me produktet e tyre kanë marrë pjesë një numër i madhë i bizneseve lokale,*
- *Për një vizitë zyrtare në Komunën e Dragashit kemi pritur presidenten e Republikës së Kosovës, znj.Vjosa Osmani, me të cilën kemi diskutuar për çështjet të shumta që lidhen me Komunën tonë, kemi pasur takim në sallën e Asamblesë me delegatët, familjarët e dëshmorëve, veteranët e Luftës, zyrtarëve dhe qytetarëve të shumtë, si dhe bashkërisht kemi vizituar dy OJQ-të lokale nga të dy komunitetet, “AVOKO” dhe “SENSA”,*
- *Me qëllim të bashkëpunimit për asfaltimin e rrugës Mavrorë - Kufiri i Maqedonisë së Veriut, kemi zhvilluar takim me kryetarin e Komunës Mavrovë-Rostushë, ku kemi biseduar lidhur me planifikimet që ka bërë qeveria e Maqedonisë së Veriut për asfaltimin e kësaj rruge,*
- *Për planifikimin e buxhetit komunal për vitin 2024 dhe përfshirjen sa më të gjerë të qytetarëve në hartimin e këtij buxheti, kemi organizuar gjithsej nëntë (9) dëgjime buxhetore me qytetarë të të gjitha komuniteteve, me gra, vajza, të rinj, organizata të shoqërisë civile, media etj.*
- *Kemi pasur takime të shpeshta me zyrtarët komunalë përgjegjës për raportim për Grantin e Performancës, me qëllim të koordinimit*
- *Në fillim të vitit të ri shkollor, kemi zhvilluar takime me drejtorë të shkollave, ku kemi diskutuar lidhur me përgatitjet për vitin shkollor, investimet nëpër objektet arsimore, gjetjen e zgjidhjeve për sigurimin e teksteve shkollore dhe materialve përcjellëse*
- *Në bashkëpunim me Institutin për Planifikim hapësinor në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, kemi zhvilluar takime konsultative për hartimin e Draft Planit Hapësinor për Parkun Kombëtar ‘Sharri’, duke u fokusuar në mundësitë e zgjerimit të potencialeve për zhvillimin ekonomik dhe turistik në këtë zonë,*
- *Për ndërtimin e rrugës Mavrovë-Strazimir kemi pasur takim edhe me drejtorin e Ndërmarrjes Publike ‘Rrugët Shtetërore’ z.Ejup Rustemi në Republikën e Maqedonisë së Veriut,*

- Në kuadër të aktiviteteve për Muajit Rozë të Vetëdijesimit për Kancerin e Gjirit, në bashkëpunim të ngushtë me Grupin e Grave Asambleiste kemi organizuar ligjërata vetëdijesuse me gra dhe vajza, si dhe kemi siguruar kryerjen e ekzaminimeve ekografike dhe mamografike për mbi 40 gra nga Komuna jonë,
- Për të qenë sa më afër bizneseve lokale, kemi marrë pjesë në Panairin Ndërkombëtar të Agroturizmit “AGROKOS”, ku kemi kërkuar nga përfaqësuesit qeveritarë që fermerët tanë në të ardhmen të subvencionohen për kullota dhe të rritet shuma e subvencioneve për bujqësi, për shkak të kushteve specifike gjeografike të trevës sonë,
- Në bashkëpunim me Shoqatën “Doën Syndrom Kosova”, me të cilët kemi diskutuar për hartimin e Planit Komunal të Veprimit për Ofrimin e Shërbimeve për Fëmijë me Aftësi të Kufizuar, projekt i cili është mbështetur nga UNICEF-i,
- Në nëntor të vitit për të cilin po raportojmë , i jemi bashkuar fushatës së Qeverisë qendrore për informimin e qytetarëve lidhur me udhëtimin pa viza nga 1 janari i vitit 2024,
- Kemi pritur në takim përfaqësues nga Parku Kombëtar i Mavrovës nga Maqedonia e Veriut, me të cilët jemi dakorduar për thellimin e bashkëpunimit sa i përket shkëmbimit të përvojave dhe adresimit të sfidave lidhur me zonat e shpallura si parqe nacionale,
- Pas 14 viteve, kemi bërë hapjen zyrtare të vendgjuetiës “Sharri”, për t’ua mundësuar qytetarëve që merren me gjueti ushtrimin e ligjshëm të aktiviteteve të tyre,
- Me Ministrinë e Infrastrukturës kemi nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit për financimin e projektit të asfaltimit të Stacionit të Autobusëve në Dragash,
- Me ambasadorin e Republikës së Bullgarisë në Kosovë, z.Hristo Gudjev, kemi bërë përrurimin e këndit të lojërave për fëmijë dhe renovimin e shkollës fillore në fshatin Kërstec, porjekte këto të mbështetura nga Ambasada e Bullgarisë në Kosovë,
- Përmesë Zyrës për Barazi Gjinore dhe në bashkëpunim me OJQ lokale dhe bështetje të OSBE-së, kemi organizuar tyryzën me temën “Barazia gjinore dhe dhuna në familje” në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizmit kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore,
- Në bashkëpunim me UNDP-në, përmes Programit ReLoaD kemi shpallur thirrje publike për angazhim në punë praktike të personave të diplomuar por të papunësuar, në institucionet publike lokale dhe në sektorin privat,
- Kemi pritur në takim ministren e Drejtësisë, znj.Albulena Haxhiu, ku kemi pasur një bisedë lidhur me aktivitetet që kanë për qëllim luftimin dhe parandalimin e dhunës me bazë gjinore, si dhe zbatimin e mekanizmave ligjorë dhe institucionalë në këtë drejtim.
- Bazuar në rregulloret dhe instruksionet e BQK-së, përmes Inspektoratit Komunal kemi ndërmarrë masa për njoftimin e biznesve dhe qytetarëve lidhur me përdorimin dhe identifikimin e monedhave metalike të falsifikuara,
- Në kuadër të Programit të BE-së për Stabilizimin e Komuniteteve, në bashkëpunim me IOM dhe përmes Zyrës për Komunitete kemi bërë hapjen e këndit të lojërave për fëmijët e komuniteteve në qytezën e Dragashit,
- Gjatë gjitha vitit 2023, kemi realizuar vizita dhe inspektime të vazhdueshme nëpër të gjitha vendpunimet ku janë kryer punime, për të përcjellë nga afër ecurinë dhe mbarëvajtjen e tyre, duke filluar që nga punimet hapjes, trasimit dhe asfaltimit të rrugëve të ndryshme, ndërtimet dhe renovimet e objekteve arsimore, shëndetësore e sportive, punimet në sistemet e kanalizimit, punimet në Ujësjellësin qendror, në instalimet e ndriçimeve publike nëpër fshatra, ndërtimin e mureve mbrojtëse, urave, trotuareve, ndërtimin e parqeve dhe këndeve të lojërave për fëmijë, e shumë projekte të tjera të cilat kanë ndikuar në transformimin e infrastrukturës së përgjithshme dhe zhvillimin e Komunës tonë.

Tash do të kalojë në Planin e Punës për këtë vit:

***Prioritetet tona kryesore për Dragashin vazhdojnë të jenë:***

- *Administratë efikase, e përgjithshme dhe me shërbime moderne,*
- *Qeverisje energjike, vepruese dhe vendimmarrje pa vonese,*
- *Organizimi me i mire i punës dhe efikasiteti i plotë i administratës së Komunës,*
- *Realizim i suksesshëm i projekteve dhe i buxhetit,*
- *Realizimi i planit të të hyrave të Komunës,*
- *Rritja e përkrahjes për bujqësinë dhe për fermerët,*
- *Furnizimi me ujë të pijshëm,*
- *Zhvillimi i turizmit dhe ndërtimi i infrastrukturës përcjellëse,*
- *Nxitje të investimeve dhe projekteve në turizëm,*
- *Trotuare dhe shtigje të ecjes për këmbësorë dhe biçiklistë,*
- *Investime për ndriçim publik,*
- *Rritje e cilësisë dhe investime në arsim,*
- *Investime në nyje sanitare dhe meremetim të shkollave,*
- *Bursa për student,*
- *Hartimi i PZHK-se dhe Hartës zonale,*
- *Terrene të reja sportive dhe përkrahje e sportit, aktivitete të planifikuara me të rinjtë,*
- *Krijimi i kushteve të përshtatshme për investime të drejtpërdrejta për të mirën e qytetareve përmes krijimit të vendeve të përhershme të punës si dhe zhvillimit ekonomik,*
- *Bashkëpunimi i vazhdueshëm me kompanitë publike për shtimin e kapaciteteve për ujë të pijes dhe për shërbime me efikase në grumbullimin e mbeturinave për një ambient sa më të pastër dhe futjen në sistemin e menaxhimit të mbeturinave për fshatrat që ende nuk janë të kyçura në sistem,*
- *Rregulli dhe disiplina në institucione,*
- *Mbarëvajtja e punëve dhe rritja e efikasitetit të punonjësve.*
- *Bashkëpunimi me komunitetin fetar, shoqëritë civile, OJQ-të ndërkombëtare, vendore dhe partnerë të tjerë.*

Lëndët e miratuara nga kryetari i Komunës, unë vetëm do t'i numëroj. Janë bërë 258 vendime. Sa i përket vendimeve financiare, ku pjesa më e madhe e vendimeve kanë qenë nga subvencionet. Ndërsa janë refuzuar afër 114 kërkesa. Mjetet e lejuara nga pozicionet tjera, prapë bëhet fjalë për mjete financiare, janë 69 vendime. Marrëveshje, memorandume, kontrata, kërkesa dhe njoftime, në përgjithësi janë 334. Vendimet e kryetarit në bashkëpunim me Zyrën e Prokurimit janë 421. Faleminderit për vëmendjen! Unë jam në disponimin tuaj, nëse ka dikush me pyet.

**Arijeta Skeraj:** Faleminderit, kryetar! Para se me ua dhënë drejtorëve fjalën, kisha kërkuar, nëse është disponimi i anëtarëve të Kuvendit, që të gjitha drejtoritë pasi të raportojnë, ne pastaj të kyçemi me pyetje për çdo drejtori. Qysh ta shihni më mirë, e bëjmë. Okej, atëherë fjalën për Drejtorinë e Administratës e ka nënkryetari i Komunës, z.Resul Fetahu.

**Resul Fetahu:** E nderuar kryesuese, i nderuar kryetar, të nderuar delegatë dhe ju të pranishëm të tjerë!  
Më lejoni që, në mungesë të drejtorit të Administratës, të bëj prezantimin e Raportit për vitin 2023, për këtë Drejtori.

*Raporti vjetor i hartuar nga Drejtoria për Administratë të Përgjithshme ka për qëllim që të pasqyrojë aktivitetet dhe punën që është zhvilluar gjatë vitit 2023 në sektorët që i përkasin kësaj drejtorie si dhe informimin e drejtë të qytetarëve, institucioneve komunale, shoqërisë civile dhe të gjitha palëve që janë të interesuara për punën e kryer gjatë këtij viti.*

*Marrë parasyshë faktin se Drejtoria e Administratës është ura lidhëse e shërbimeve të institucioneve lokale me qytetarët dhe institucionet qendrore, shërbimi i Administratës Komunale ka qenë i përkushtuar në ofrimin e shërbimeve sa më cilësore. Kjo drejtori ka bërë ushtrimin dhe zbatimin e shërbimeve të përgjithshme administrative për organet administrative dhe organet tjera komunale dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarët e Komunës së Dragashit konform ligjeve, udhëzimeve administrative dhe rregulloreve në fuqi, gjatë vitit 2023. Shërbimet të cilat komuna u ofron qytetarëve të saj bazohen në nevojat dhe kërkesat e qytetarëve duke qenë në harmoni të plotë me ligjet dhe udhëzimet administrative të Republikës së Kosovës. Drejtoria për Administratë të Përgjithshme punën e saj e bazon brenda kornizave ligjore të cilat janë në fuqi si:*

- *Ligji për Vetëqeverisjen Lokale;*
- *Ligji për Zyrtarët Publik;*
- *Ligjin mbi Librat Amzë;*
- *Statutin e Komunës;*
- *Rregulloret komunale;*
- *Urdhëresat dhe Udhëzimet Administrative;*

*Drejtoria për Administratë të përgjithshme është kujdesur që gjatë vitit 2023 të krijojë kushte më të përshatshme të punës për zyrtarët në mënyrë që shërbimet të jenë në nivel të kënaqur për qytetarët e Komunës së Dragashit.*

*Nga buxheti i Drejtorisë për Administratë të përgjithshme ashtu siç janë planifikuar mjetet kemi arritur që t'i realizojmë qëllimet duke mbuluar:*

- *Pagat për stafin që i përkasin Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme,*
- *Shërbimi i telefonisë mobile,*
- *Shërbimet postare,*
- *Shërbimet e shtypjes (printim dhe skanim),*
- *Shërbimet e ujësjellësit,*
- *Shërbimi i mirëmbajtjes së veturave zyrtare në kuadër të DAP,*
- *Furnizimi me inventar për nevojat e Komunës së Dragashit,*
- *Furnizim me material hargjues-higjienik për nevojat e Komunës së Dragashit,*
- *Furnizim me derivate për nevojat e automjeteve zyrtare,*
- *Rregullimi dhe mirëmbajtja e autoparkut dhe hapësirave për parking,*
- *Përmbushja e nevojave të tjera rreth objektit të Komunës së Dragashit,*
- *Bashkëpunim me drejtoritë e tjera për realizimin e projekteve.*

*Të gjitha shpenzimet e Drejtorisë për Administratë të përgjithshme janë të paraqitura edhe në raportet financiare.*

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme në aspektin organizativ ndahet në disa sektorë që do të paraqiten si në vijim:

**I. Sektori i Gjendjes Civile (Ofiqaria);**

**II. Zyra për Shërbime të Qytetarëve dhe Arkivi;**

**III. Zyra e Prokurimit;**

**IV. Shërbimet Teknike;**

**V. Njësia për IT;**

## **I. Sektori i Gjendjes Civile (Ofiqaria)**

Shërbimi i Gjendjes Civile në Komunën e Dragashit gjatë periudhës Janar-Dhjetor të vitit 2023 ka arritur që të jetë shumë efikas dhe ti shërbejë të gjithë qytetarët në kohë optimale. Gjatë kësaj periudhe ky shërbim në kuadër të kompetencave të tij kryen një sërë aktivitete që do të paraqesim në vazhdim të këtij raporti.

Me punën e zyrtarëve të Gjendjes Civile arrihet që të lëshohen një numër i konsiderueshëm i dokumenteve nga ky sektor ku varion nga 35,000 sosh deri në 40,000 sosh brenda një viti. Kjo tregon që shërbimi për marrjen e një dokumenti të nevojshëm për qytetarët është shumë i shpejtë, efikas, i qëndrueshëm dhe i përgjegjshëm me kapacitetet aktuale që kemi.

Ashtu siq edhe e thekson statuti i Komunës sonë, Shërbimi i Gjendjes Civile (Ofiqaria) është i organizuar në pesë lokacione të cilat gjenden si në vijim:

- Dragash,
- Bresanë,
- Llapushnik,
- Krushevë,
- Brod.

Këto pesë lokacione janë të vendosura në këtë mënyrë me qëllim që qytetarët ti kenë sa më afër Shërbimet e Gjendjes Civile ku mbulohet i gjithë territori i Komunës sonë.

Gjatë këtij viti jemi ballafaquar me rritje të kërkesave për shërbimet që ofron Zyra e Gjendjes Civile dhe me ardhjen e bashkëatdhetarëve tanë të cilët jetojnë jashtë Republikës së Kosovës, nga data 15.07.2023 deri me datën 20.08.2023 ky shërbim ka punuar edhe gjatë fundjavës (ditës së shtunë) me orar nga ora 09:00 deri në ora 13:00 ndërsa vlen të theksohet se edhe gjatë ditëve të punës (e hënë-e premte) është punuar me orar të zgjatur nga ora 15:30 deri në ora 17:00.

Drejtoria e Administratës është kujdesur që të sigurojë kushte të punës për të gjithë zyrtarët duke vazhduar pajisjen me mjete moderne të IT në mënyrë që të rritet efënca e shërbimeve.

Më poshtë do ta paraqesim në mënyrë tabelare punën e Shërbimit të Gjendjes Civile ku në detaje janë të paraqitura statistikat varësisht nga lloji i certifikatës, regjistrimet në regjistrat themeltar dhe regjistrimet në regjistrat e veqantë nga bota e jashtme.

❖ Për periudhën Janar –Dhjetor të vitit 2023 janë lëshuar këto dokumente të Gjendjes Civile:

<b>Nr.</b>	<b>Lloji i çertifikates</b>	<b>Brenda vendit</b>	<b>Jashtë vendit</b>	<b>Totali</b>
1.	Certifikate lindje	577	6519	7096
2.	Ekstrakt lindje	15119	1725	16844
3.	Certifikate martesë	2405	2502	4907
4.	Deklaratë e bashkësisë familjare	894	2479	3373
5.	Certifikate vendbanimi	879	507	1386
6.	Certifikate e shtetësisë	56	179	235
7.	Certifikate e gjendjes martesore	554	249	803
8.	Vertetim nga arkiva	458	511	969
9.	Certifikate vdekje	1579	338	1917
<b>Totali</b>				<b>37530</b>

Dëshmi vdekje (Aktvdekje).....212

❖ Regjistrimet në regjistrat themeltar:

<b>Nr.</b>	<b>Lloji</b>	<b>Sasia</b>
1.	Aktet e Lindjes	16
2.	Aktet e Martesës	271
3.	Akte të Vdekjes	151

❖ Regjistrimet ne regjistrat e veçantë nga bota e jashtme:

<b>Nr.</b>	<b>Lloji</b>	<b>Sasia</b>
1.	Aktet e Lindjes	571
2.	Aktet e Martesës	152
3.	Akte të Vdekjes	179

-Kërkesa për lirim nga shtetësia e RKS kanë aplikuar 37 persona.

-Kërkesa për fitimin e shtetësisë se RKS kanë aplikuar 104 persona.

-Në bazë të Nenit 31 dhe Nenit 32 të [LIGJI NR. 04/L-215 PËR SHTETËSINË E KOSOVËS](#) janë regjistruar 36 persona.

-Shkurorëzime janë regjistruar 99.

Të hyrat e inkasuara nga Shërbimi i Gjendjes Civile në periudhën **01.01.2023** deri **31.12.2023** dhe të dorëzuara tek Zyrtari i Pasurisë së Komunës kanë vlerën prej **39,028.00€**.

Sa i përket zbatimit të Platformës Elektronike eKosova, viti 2023 shënon një rritje të përdorimit të kësaj platforme ku në total kemi **6728 dokumente të lëshuara**, dhe të ndara si vijon:

<b>NR.</b>	<b>LLOJI I DOKUMENTIT</b>	<b>SASIA</b>
1.	Certifikata e lindjes	2598
2.	Ekstrakt nga RQGJ	2947
3.	Certifikata e martesës	989
4.	Certifikata e vdekjes	194
	<b>TOTAL:</b>	<b>6728</b>

Po ashtu me qëllim mirëmbajtjen e stokut të formularëve është bërë edhe furnizimi me formular të certifikatave nëpër zyret e Gjendjes Civile në total prej 11,100 sosh.

Të gjitha këto statistika të pasqyruara në këtë raport si dhe tabelat e detajizuara janë përcjellur në baza të rregullta në Entin e Statistikave të Kosovës.

## **II. Zyra për Shërbime të Qytetarëve dhe Arkivi**

Zyra për shërbim të Qytetarëve u shërben qytetarëve për t'u informuar me procedurat e nevojshme për kryerjen e punëve administrative në harmoni me dispozitat ligjore për kryerjen e shërbimeve të ndryshme nga organet e administratës komunale. Zhvillimi i procedurave bëhet si në vijim: fillimisht paraqitet kërkesa, protokolohehet, skenohet, ruhet në sistemin e INTRANET-it dhe më pas shpërndahet me anë të librave të brendshëm dhe elektronikë deri tek drejtoritë përkatëse nga ana e personit të autorizuar për kryerjen e këtij shërbimi. Protokoli për këtë procedurë administrative mbahet në mënyrë elektronike si dhe me shkrim, njëherit të gjitha kërkesat, dokumentet dhe shkresat të cilat janë të protokoluara, skenohen dhe më pas përcillen në ministri dhe në drejtori përkatëse me anë të sistemit të INTRANET-it. Kështu në çdo moment mund të përcjellim në këtë sistem azhurimet e shërbimeve përbrenda komunës. Në periudhën kohore 01.01.2023 – 31.12.2023 në këtë zyrë janë regjistruar gjithsejt **34,235 lëndë**.

Gjatë këtij viti është bërë edhe furnizimi i kësaj zyreje me skanerët portativ të cilët kanë përmirësuar dukshëm shpejtësinë e ofrimit të shërbimeve nga Zyra e Pritjes.

Po ashtu, këtë vit është bërë edhe renovimi i tërësishëm i Zyres së Pritjes, me qëllimin e vetëm ngritjen e kualitetit të shërbimeve për qytetarët.

Në këtë zyre gjithashtu kryhen edhe pagesat e shërbimeve komunale sipas Rregullores mbi Taksat Komunale për shërbime të caktuara. Gjatë vitit 2023 janë inkasuar gjithsejt **17,883.00 €**.

## **III. Zyra e Prokurimit**

Zyra e Prokurimit funksionon në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës dhe akteve të tjera që janë nxjerrë nga ky Ligj.

Kjo zyrë, edhe pse me mungesë stafi konform nevojave, gjatë vitit 2023 ka qenë mjaftë efikase duke arritur që të kryejë të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë me një dinamikë të jashtëzakonshme duke realizuar kështu me sukses buxhetin e planifikuar për këtë vit. Të gjitha projektet, duke përfshirë projektet e investimeve kapitale, projektet për blerjen e mallrave dhe shërbimeve si dhe për nevoja të tjera të të gjitha sektorëve të Komunës së Dragashit kemi arritur t'i realizojmë me sukses dhe në kohë. Në vazhdim do të paraqesim punët që ka kryer kjo zyrë duke pasur bashkëpunim të ngushtë me të gjitha drejtoritë përkatëse në mënyrë që të realizohen të gjitha objektivat e parapara për këtë vit.

Gjatë vitit 2023 kjo zyrë ka zhvilluar gjithsejt **199 aktivitete prokurimi** me një vlerë totale të parashikuar të kontratave prej **7,699,161.69€** dhe si rezultat, shuma e kontratave të nënshkruara të projekteve të investimeve kapitale, mallrave dhe shërbimeve arrin shumën prej **6,683,909.06€**, shumë kjo e cila iu është bërë në formë pagese Operatorëve Ekonomik (OE) të ndryshëm.

Kjo vlerë e paraqitur në këtë raport është realizuar me një numër të madh operatorësh ekonomik, të

*cilët kanë marrë pjesë përmes ofertimit në procedurat e iniciuara nga ana e Komunës së Dragashit. Me qëllim ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies, të gjitha kontratat e nënshkruara me Operatorët Ekonomikë janë publikuar edhe në ëeb faqen e Komunës së Dragashit në mënyrë që të gjithë qytetarët apo grupet e ndryshme të interesuara për aktivitetin e Zyrës së Prokurimit të kenë qasje dhe të përcjellin nga afër punën e kësaj zyreje dhe qeverisjes lokale në përgjithësi.*

#### **IV. Shërbimet Teknike**

*Në kuadër të këtij shërbimi janë të përfshira këto njësi:*

- 1. Autoparku i Komunës;**
- 2. Rojet e objekteve Komunale;**
- 3. Shërbimi i pastrimit të objekteve Komunale;**
- 4. Depo e Komunës;**

**Autoparku:** Ky shërbim gjatë vitit 2023 ka qenë i organizuar me katër punonjës të stafit teknik, ku dy nga këta janë vozitës të autobusëve të komunës dhe dy të tjerë vozitës të veturave të Administratës. Kështu që gjatë këtij viti kanë funksionuar dy autobusë për plotësimin e nevojave të ndryshme të paraqitura kohë pas kohe sipas kërkesave specifike të drejtorive komunale, klubeve të futbollit dhe shoqerisë civile, ndërsa veturat zyrtare të komunës janë shfrytëzuar nga zyrtarët komunal të cilët për nevoja të komunës kanë udhëtuar brenda komunës, regjionit, jashtë regjionit dhe jashtë vendit, varësisht nga ftesat apo punët zyrtare që janë paraqitur nga zyrtarët e drejtorive të ndryshme. Zyrtarët e autoparkut të komunës janë kujdesur për evitimin e problemeve të ndryshme të veturave dhe autobusëve zyrtarë të komunës ku janë angazhuar në përcjelljen e afateve të servisimit të rregullt të tyre, sigurimin dhe regjistrimin e të gjitha automjeteve zyrtare duke respektuar afatet kohore në mënyrë që automjetet të jenë sa më funksionale dhe në gjendje gatishmërie për të iu përgjigjur nevojave dhe kërkesave të drejtorive të ndryshme brenda komunës dhe jashtë saj.

**Sigurimi i Objekteve Komunale:** Ky shërbim kujdeset për sigurinë e objekteve komunale gjatë natës. Shërbimi është i organizuar me tre puntorë të cilët janë përgjegjës për sigurinë nga rreziqet e ndryshme që mund të paraqiten në objektin e Komunës së Dragashit dhe objektin e ZGJC-Dragash. Gjatë këtij viti nuk kemi pasur kurrfarë vështirësish rreth mirëmbajtjes dhe ruajtjes së objekteve Komunale.

**Pastruesit e objektit:** Ky shërbim është përgjegjës për mirëmbajtjen dhe pastrimin e objektit të komunës, duke përfshirë të gjitha zyret dhe hapsirat që janë brenda objektit të Komunës dhe të gjitha hapësirat që gjenden në objektin e ZGJC-Dragash. Shërbimi i pastrimit funksionon aktualisht me tre puntorë të cilët furnizohen në bazë javore me material higjienik në deponë e komunës, duke siguruar ambiente pune të pastërta për zyrtarët komunal dhe ambiente shërbimi sa më të pastërta ndaj qytetarëve.

**Depo e Komunës:** Shërbimi në depon e Komunës është i organizuar me një zyrtar të depos-depoist. Ky shërbim është përgjegjës për pranimin e mallrave shpenzues, menaxhimin e tyre dhe shpërndarjen sipas kërkesave të personelit të Komunës së Dragashit.

Ky shërbim gjatë vitit 2023 ka qenë shumë efikas duke arritur të plotësojë kërkesat dhe nevojat për furnizim me material shpenzues (zyrtar dhe higjienik) për të gjithë personelin e Komunës, institucionet arsimore dhe Qendrën Kryesore të Mjeksisë Familjare(QKMF-Dragash).



## V. Njësia e Teknologjisë Informative

Njësia për Teknologji Informative është zyrë shumë dinamike dhe konsiderohet si kyçe në punët Administrativo-teknike. Kjo zyrë e ka këtë rëndësi për shkak të vizionit dhe realizimit të përditshëm të një qeverisje elektronike, duke u kujdesur që planet të realizohen në vepra me përdorim të teknologjisë moderne softëerike dhe hardëerike.

Kjo zyrë gjatë kësaj periudhe ka zhvilluar në baza ditore aktivitetet si në vijim:

- Intervenime rutinore nëpër kompjuterë të punëtorëve të administratës komunale të cilat kanë pasur nevojë për ruajtjen e shënimeve, formatizimin e tyre, intervenime softëerike, etj;
- Mirëmbajtjen e sistemit të INTRANET-it;
- Furnizimi dhe konfigurimi i skanerëve në zyrën e pritjes;
- Mirëmbajtja e sistemit elektronik të arkivimit;
- Mirëmbajtja e sistemit të e-Pasuria;
- Kontrollimi dhe mirëmbajtja e përditshme e serverëve komunal;
- Puna e përditshme në ëeb faqen e Komunës;
- Mirëmbajtja e llogarive të emailit zyrtar për tërë zyrtarët komunal;
- Krijimin e shfrytëzuesve të ndryshëm në sistemin e INTRANETI-it dhe në domenin qeveritar;
- Punë të ndryshme sipas kërkesave në fushën e teknologjisë informative;
- Takime të ndryshme me ftesë nga Ministria dhe Kolegjiumi i IT-ve në kuadër të AKK;
- Asistenca në mbarëvajtjen e mbledhjeve të asamblesë komunale, lidhja direkte në kanalën zyrtar në youtube, dhe plasimi i xhirimeve në ëeb faqen e komunës;
- Intervenime në teren dhe Zyret e Gjendjes Civile.

Kjo ishte sa i përket Raportit të Punës për vitin 2023. Atëherë sa i përket Planit të Punës së kësaj drejtorie për vitin 2024:

Duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-040 mbi Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin Nr.03/L-149 mbi Sherbimin Civil, Ligjin Nr.04/L-003 për Gjendjen Civile, Udhëzimeve Administrative, Statutin e Komunës, Rregulloret Komunale, Urdhëresat dhe Udhëzimet komunale që specifikojnë rregullat dhe modalitetet e aplikimit të Ligjit dhe veprimit administrativ, Drejtoria e Administratës Komunale do të ushtrojë aktivitetin në të gjithë sektorët e saj organizativ si në vijim:

- Sektori i Gjendjes Civile (Ofiqaria).
- Zyra për Shërbime të Qytetarëve dhe Arkivi.
- Zyra e prokurimit.
- Shërbimet teknike.
- Njësia për IT.

Për të siguruar një punë efikase Drejtoria e Administratës përgatitë Planin e Punës për vitin 2024, në të cilin plan do të paraqiten objektivat dhe dinamika e arritjes së këtyre objektivave për këtë vit. **Qëllimi i këtij plani është** të përgatisim një plan menagjimi të bazuar në kapacitete organizative dhe teknike, përmirësim të kushteve të punës, performancës së deritashme dhe shfrytëzimit sa më të mirë të kapaciteteve që ka kjo drejtoria me qëllim rritjen e nivelit të performancës dhe ofrimit të shërbimeve për qytetarët. Zbatimi i përvojës që është krijuar nga stafi i sektorëve dhe mundësia e përmirësimit të shërbimit për secilin sektorë do të jetë sfidë dhe objektiv i ynë i përbashkët.

## RËNDËSIA DHE HAPAT

Rëndësia e këtij plani qëndron në mundësinë e eliminimit të dobësive që kanë përcjellur Administratën Komunale nga viti paraprak dhe që kanë ndikuar drejtëpërdrejtë në performancë. Menagjimi i bazuar në performancë është një qasje që në mënyrë sistematike mundëson përmirësimin e performancës përmes një procesi të vazhdueshëm të vendosjes së objektivave, matjes së performancës përmes grumbullimit, analizimit dhe rishikimit të të dhënave.

Vlerësojmë se Plani Vjetor i Punës duhet të bazohet në performancë e jo në numër të aktiviteteve, sepse rezultatet janë ato që flasin. Dinamika e punës sipas këtij plani duhet të përcillet çdo javë me qëllim që mos të ketë ngecje në përmbushjen e objektivave, por në mënyrë sistematike të përcillen të arriturat të përcaktuara në këtë plan. Problemet sikurse është mungesa e hapësirave të nevojshme dhe kushteve optimale tashmë është përmirësuar dhe jemi në kërkim e sipër edhe të zgjerimit të mëtejshëm të hapësirave ekzistuese. Procesi i filluar tashmë i digjitalizimit të shërbimeve administrative dhe rregullimi i statusit të zgjidhjes së lëndëve mbetet gjithashtu sfidë edhe këtë vit.

### Sektori i Gjendjes Civile

#### ❖ Objektivat

#### 1. Regjistrimi i lindjeve, martesave dhe vdekjeve brenda dhe jashtë vendit

1.1 Dhënia e infomatave korrekte dhe infomimi për procedurat e regjistrimit të lindjeve, martesave dhe vdekjeve.

1.2 Perpjekja që qytetarët të jenë të kënaqur me kohën dhe shërbimet e mira.

#### 2. Lëshimi i dokumenteve të Gjendjes Civile

2.1 Lëshimi i dokumenteve të GJC në kohë optimale dhe tani me UA të MPB nr.01/2022 lëshohen me QR Code që nënkupton vërtetimin e autenticitetit, duke zbatuar legjislacionin në fuqi të RKS.

#### 3. Përcjellja e punës dhe aktiviteteve të të gjithë zyrtarëve të sektorit të Gjendjes Civile.

3.1. Punë efikase, shërbime dhe rezultate më të mira.

3.2 Përmirësim i kushteve të punës, furnizimi i zyrave me orman metalik, karrige dhe tavolina te punës dhe stol qëndrimi për palët si dhe vendosja e një printeri multifunksional në shërbim të qytetarëve gjatë sezonës kur ka fluks më të madh të qytetarëve.

#### 4. Bashkëpunimi i ngushtë me ministrinë përkatëse MPB, MAPL, MAP si dhe departamentet që operojnë në këto ministri.

4.1 Bashkëpunim me DRGJC –ARC në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

4.2 Bashkëpunim me sektorët e Teknologjisë Informative për programet që përcjellin punën dhe veprimtarinë tonë.

4.3. Për vitin 2024 jemi të përgatitur që të zbatojmë çdo direktivë, udhëzim nga ARC-MPB sa i përketë kërkesave që vijnë në kuadër të liberalizimit të vizave dhe realizimit të standardeve europiane.

## **5. Raportimi i punës në sektorin e Gjendjes Civile**

5.1 Raportet javore, mujore dhe vjetore në forma tabelare me statistikat përkatëse për lindjet, martesat dhe vdekjet. Po ashtu me këto të dhëna njoftohet edhe Enti i Statistikës së Republikës së Kosovës.

## **6. Zbatimi i ligjeve dhe udhëzimeve të reja në sektorin e Gjendjes Civile.**

6.1 Përcjellja në kohë e njoftimeve dhe informacioneve tek zyrtarët e Gjendjes Civile.

## **Zyra për Shërbime të Qytetarëve dhe Arkivi**

### **❖ Objektivat**

- Zyra për shërbimin e qytetarëve do të funksionojë si pjesë e strukturës organizative të administratës së komunës.
- Çdo shërbim publik që ofron komuna, duhet të protokollohet përmes zyrës dhe secila drejtori duhet të jetë e lidhur me këtë zyrë.
- Zyra do të pranohet dhe procedon për shqyrtim dhe vendosje kërkesat e qytetarëve në drejtorinë komunale dhe njësitë organizative brenda drejtorive.
- Zyra ofron shërbime tjera si vijon: shërbimet e arkivës, shërbimet e gjendjes civile, tatimin në pronë, shërbimet kadastrale dhe të gjitha shërbimet tjera.
- Zyra duhet të këshillojë dhe të ndihmojë në çështjet teknike-administrative për mënyrën e plotësimit të kërkesave.
- Do të bëjë pranimin dhe regjistrimin e kërkesave.
- Do të bëjë mbajtjen e dosjeve, statistikave të kërkesave të paraqitura nga qytetarët.
- Gjithashtu do të protokollojë të gjitha aktet e nxjerra nga organet e komunës.
- Do të vazhdojë implementimin dhe përditësimin e të dhënave në kohë reale në sistemin e INTRANET-it.

## **Zyra e Prokurimit Publik**

Kjo zyrë përveç realizimit të buxhetit të aprovuar nga Asambleja Komonale për investime kapitale dhe shpenzime të ndryshme që ka komuna gjithashtu do të përkujdeset për ofrimin dhe procesimin e të gjitha kërkesave dhe nevojave që vijnë nga drejtorinë komunale.

Në mënyrë që projektet të realizohen me sukses për t'a arritur një përqindje të konsiderueshme të realizimit të buxhetit që është paraparë për vitin 2024, zyra e Prokurimit do të bashkëpunojë ngushtë me të gjitha drejtorinë komunale si në projektet e investimeve kapitale poashtu edhe me furnizimet e nevojshme për organet e administratës komunale. Po ashtu, me qëllim ngritjen e transparencës e gjithë veprimtaria e zyrës së prokurimit do të publikohet në ëeb faqen e komunës si dhe në platformën eProkurimi.

## Shërbimet Teknike

### ❖ **Njësia e Autoparkut Komunal:**

*Njësia e autoparkut të komunës është planifikuar në atë mënyrë që:*

- *Të gjithë përdoruesit e automjeteve duhet që të përdorin automjetet zyrtare në mënyrë sa më ekonomike dhe efikase.*
- *Do të bëhet mirëmbajtja e simboleve apo shenjave identifikuese të Komunës së Dragashit tek automjetet zyrtare.*
- *Do të bëhet servisimi i rregullt i automjeteve në mënyrë që automjetet të jenë vazhdimisht në dispozicion për kryerjen e detyrave zyrtare.*
- *Varësisht nga kostoja, do të shqyrtohet mundësia e paisjes me GPS e të gjitha automjeteve zyrtare.*

### ❖ **Sigurimi i Objekteve Komunale:**

*Sigurimi i objektit të Komunës do të kryej punën sipas aktivitetit si në vijim:*

- *Do të jetë në gjendje që gjatë natës të kujdeset për objektin e Komunës.*
- *Do të përcjellë sigurinë e objektit.*
- *Do të mundohet që të parandalojë rreziqet që mund të paraqiten gjatë natës.*
- *Do të mbajë evidencë për hyrje-daljen e zyrtarëve gjatë natës.*
- *Do të adresojë problemet eventuale që mund të paraqiten gjatë punës.*

### ❖ **Shërbimi i pastrimit:**

*Ky shërbim do të kujdeset që hapsirat e objektit të Komunës të jenë të pastërta duke u kujdesur për secilën hapsirë të komunës dhe të objektit të ZGJC-Dragash.*

*Gjithashtu nevojat për mjete pastrimi do të ju sigurohen në bazë të kërkesave të tyre pranë Depos së Komunës dhe konform kontratave të cilat organizohen nga Zyra e Prokurimit.*

## Njësia e Teknologjisë Informative

*Objektivat apo planet e njësisë së IT-së për vitin 2024 janë si në vijim:*

- *Mirëmbajtja e paisjeve teknologjike për të gjithë punëtorët e Administratës.*
- *Zhvendosja e lokacionit të dhomës së serverëve (Server Room) në një hapsirë më të madhe.*
- *Përmirësimi i infrastrukturës së rrjetit, hartimi i planit detal të LAN-it dhe implementimi i projektit.*
- *Instalimi i sistemit të ri të monitorimit të kamerave për objektin e Komunës së Dragashit.*
- *Asistencë në implementimin e sistemit të INTRANET-it për të gjithë punëtorët e Administratës Komunale.*

**Ju faleminderit!**

**Samidin Xheladini:** Të nderuar të pranishëm, ju përshëndes të gjithëve! Ju uroj muajin e shenjtë të Ramazanit! Unë kam disa shqetësime të cilat në vazhdimësi po vazhdojnë. Kam kërkuar teleprezencën, nuk ka ardhë. Këtu është bo Pazar i gjove. Bëhet muhabet nonstop. Veç kam vëzhgime, asnjë person nuk e dëgjon atë që po raporton. E dyta: Raporti nuk ka nevojë neve me na i lexue tekstet të cilat i kemi përballë. Neve me na i kallxue ndryshimet, arritjet, planet. Nuk kemi kohë na me ju ngue ka dy sahat këtu, drejtorat me na kallxue neve ato që i kemi para sysh, përpara. Edhe, në lidhje me Raportin e zyrtarit të Administratës, unë nuk pashë që ju keni në plan me e sjellë teleprezencën. Në vazhdimësi kam kërkuar teleprezencën të jetë prezent. Në vazhdimësi ajo i sheh krejt këndet, neve na sheh edhe çka jemi t'u bo. Pse është hek ajo teleprezencë, asnjëherë s'më kanë dhënë mu zyrtarisht. Kërkoj me ngulm tash, sot në këtë seancë me më dhënë mu përgjigje, pse teleprezencën u heq prej këtu? Dhe pse nuk bihet teleprezencën? Ju faleminderit!

**Qamil Kolloni:** Përshëndetje kryesuese, kryetar, përshëndetje juve të gjithë delegatëve! Do të mundohem të jem më i shkurtër, meqenëse jemi në muajin e Ramazanit. Ndoshta, me siguri edhe pak mund me hup edhe koncentrimi. Gjithashtu, Samidin, unë s'kam të drejtë me të dhënë përgjigje, po në qoftë se më pranosh kështu, në mënyrë shoqërore po ta them. Jo që po mundohemi t'i lexojmë, se ju i keni ato, po është qëllimi se ne po transmetohemi në media dhe në publik del gjysë kuptim ky diskutim i juaji, për arsye se ju po jepni vërejtje prej materialit, kurse dëgjuesit nuk e kanë dëgjue se për çfarë materiali po bëhet fjalë, dhe kështu po është një vakuum. Për me iu shmang këtij vakumi, kemi marrë si qëndrim që t'i lexojmë për dëgjuesit, dhe në momentin që delegatët bëjnë pyetje, të dalë si material i kompletuar. Për kurgjo tjetër ma shumë, se na e dimë që ju i lexoni materialet, i keni në tavolinë përpara dhe besoj se për shumë probleme për të cilat diskutojmë këtu jeni më të njoftuar në raport me qytetarët. Prandaj kjo bëhet për hir të qytetarëve dhe jo për hir të delegatëve, ta heqim këtë keqkuptim. Këtë ta thashë në mënyrë shoqërore, nuk kisha pas qef me më bo replikë në këtë. Në qoftë se më lejohet, po filloj me Raportin e Punës për vitin 2023. Drejtorati për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim, siç e dini, punët e veta i kryen në pesë sektorë apo njësi punuese: Zhvillimi ekonomik, që ka për detyrë informimin, orientimin dhe promovimin e resurseve ekonomike, gjithashtu edhe punon në implementimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal. Sektori i dytë është Buxheti dhe Financat, ku detyrë primare kanë parashikimin e buxhetit dhe shpërndarjen e tij, raportimin financiar mujor, tremujor dhe vjetor, dhe gjithashtu si detyrë primare ka transaksionet financiare. Sektorin e tretë e kemi Zyrën e Tatimit në Pronë, e cila detyrë kryesore ka vlerësimin, faturimin dhe inkasimin si e hyrë vetanake e tatimit në pronë në Komunën e Dragashit. Zyra për Regjistrimin e Biznesit, gjithashtu detyrë primare ka regjistrimin e bizneseve, përcjelljen e kontratave me bizneset dhe kontratat të cilat kanë në shfrytëzim pasurinë komunale. Kemi Njësitin e Thesarit, që bën regjistrimin e pasurisë, gjithashtu detyrë kryesore ka edhe përdorimin e CASH-it. Po në këtë zyrë bëhet edhe inventarizimi i pasurisë

komunale nën 1000 euro dhe investimeve kapitale mbi 1000 euro. Të hyjmë më detajisht. Zyra për zhvillim ekonomik konsiderohet si pikë kyçe në nxitjen dhe mbështetjen e investimeve të huaja në vend, si promotorë e zhvillimit të mëtejshëm të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe si një entitet i fortë stimulues për produktet vendore lokale. Gjatë vitit 2023, pikërisht për promovimin e Komunës dhe promovimin e bizneseve lokale, Komuna e Dragashit ka qenë prezentë në Panairin Ndërkombëtar të Turizmit, që është mbajtur në sallën “1 Tetori” në Prishtinë, gjatë datave 26-28 prill 2023. Me këtë rast, ka qenë prezent dhe ka promovue gjithashtu, me fjalën e tij, edhe kryetari i Komunës. Po gjatë vitit 2023, për promovimin e bizneseve vendore lokale, është organizuar Panairi “EXPO SHARRI”, në bashkëpunim me Shoqatën e Afaristëve, për të cilën mendoj se nuk kam nevojë shumë të ju jap sqarime, sepse keni qenë të gjithë vetë pjesëmarrës. Njëkohësisht, edhe për promovimin e produkteve vendore, DEFZh ka marrë pjesë në Panairin Ndërkombëtar për Promovimin e Produkteve Vendore “Agro Turizmi”, gjithashtu në sallën “1 Tetori”, i cili është mbajtur më 19-20 tetor 2023. Po në këtë panair, gjithashtu prezent ka qenë edhe kryetari i Komunës dhe ka bërë promovimin e Komunës. Njësia Punuese për Buxhet, besoj se çdo tre muaj keni pasur mundësinë t’i keni në dispozicion raportet buxhetore të cilat janë të parapara dhe i kemi analizue, si me Qarkoren buxhetore, gjithashtu edhe më Ligjin për Financat e Kosovës. Prandaj, ky sektor bën edhe KAB-in, raportet vjetore, dhe gjithashtu mban në evidencë të gjitha transaksionet ekonomike që bëhen në mes të Komunës dhe operatorëve ekonomikë. Zyra e Tatimit në pronë gjithashtu, ju e dini se ka tregue një varg rezultatesh dhe është një prej zyrave shumë funksionale, e cila për dy vite ka arritur që 14% të bëjë ngritjen e inkasimit të të hyrave nga tatimi në pronë. Prandaj, sukseset e saj shihen në tabelën të cilën e keni përballë. Çka është krye gjatë këtij viti dhe cilat janë rezultatet e kësaj zyre? Zyra e Tatimit në Pronë ka shpërndarë 9435 fatura.

Nga këto fatura:

<b>Nr.rendor</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>	<b>Shuma</b>
<b>1</b>	Faturat e shpërndara	Cope	<b>9435</b>	-----
<b>2</b>	Ngarkesa për objekte	-----	-----	<b>275, 980.13 €</b>
<b>3</b>	Ngarkesa për toka	-----	-----	<b>125, 825.66 €</b>
<b>4</b>	Ngarkesa totale 2023	-----	-----	<b>401,805.79 €</b>
<b>5</b>	Te hyrat 2023	-----	----	<b>320.985,50 €</b>
<b>6</b>	Te hyrat nga free balanc	-----	-----	<b>324,437.87 €</b>
<b>7</b>	Te hyrat per vitin 2022	-----	-----	<b>295.238,46 €</b>
<b>8</b>	Diferenca % <b>2022-2023</b>			<b>9 % Plus</b>

Realisht, kemi pas edhe një rritje vitin e kaluar prej 7% dhe për dy vite kemi një rritje prej 16% të të hyrave, derisa jemi në qeverisje, dhe në vendimet dhe aplikimin e normave të reja të përqindjes që i kemi aplikue. Në këtë zyrë kanë ardhur 140 ankesa të tatimpaguesve, prej tyre 139 janë zgjidhur, 129 ankesa janë pranuar dhe 10 janë refuzuar. Njësia e Thesarit, realisht me Thesarin kemi të bëjmë me përdorimin e CASH-it dhe regjistrimin e pasurisë. Në arkën kryesore këtë vit janë inkasuar 57,246 euro, ndërsa janë tërhequr 500 euro në fatura me para të imëta nën 100 euro. Po ashtu, në këtë vit kalendarik kemi tërhequr 96 avanse, paradhënie për udhëtime zyrtare në shumë prej 10,096 euro. Gjatë këtij viti kemi regjistruar investime kapitale në SMFK, pasurinë mbi 1 mijë euro dhe gjithashtu kemi regjistruar në sistemin e-Pasuria – pjesërisht – për arsye se në gjysmë të vitit 2023 kemi arritur ta aktivizojmë dhe ta bëjmë funksionale e-Pasurinë, e cila sot e kësaj dite është funksionale – dhe kemi bërë regjistrimin e pasurisë nën 1 mijë euro. Zyra për Regjistrimin e Bizneseve është një zyrë që në vazhdimësi kryen punimet në ARBK, regjistrimin e bizneseve të reja dhe njëkohësisht mban evidencat për kontratat të cilat lidhen nga komisionet e krijuara përmes ankandit, nga Kuvendi Komunal. Të japim disa të dhëna të ARBK-së që janë të vlefshme për çdo zyrtar komunal, sa i përket biznesit privat:

***Totali i Bizneseve të regjistruara në Komunën e Dragashit:***

<b>Nr.</b>	<b>Llojet e Bizneseve</b>	<b>Numri i Bizneseve</b>
<b>1</b>	Biznese Individuale B.I	<b>1737</b>
<b>2</b>	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara SH.P.K	<b>106</b>
<b>3</b>	Ortakëri të përgjithshme	<b>13</b>
<b>4</b>	Koperativa Bujqësore	<b>6</b>
<b>5</b>	Ndërmarrje shoqërore N.SH	<b>1</b>

***Numri i bizneseve të hapura në katër vitet e fundit:***

<b>Viti</b>	<b>Numri i bizneseve të reja</b>
<b>2020</b>	<b>60</b>
<b>2021</b>	<b>53</b>
<b>2022</b>	<b>54</b>
<b>2023</b>	<b>48</b>
<b>Totali</b>	<b>215</b>

***Aktivitetet që ofrohen nga bizneset e Komunës së Dragashit janë si në vijim:***

<b>Nr.</b>	<b>Aktivitetet që shërbejnë më shumë</b>	<b>Numri Bizneseve</b>
<b>1</b>	Tregti me pakicë në dyqane jo të specializuara	<b>125</b>
<b>2</b>	Aktivitetet shërbyese të pijeve	<b>90</b>
<b>3</b>	Tregti me pakicë në dyqane ku mbizotëron ushqimi, pijet	<b>80</b>
<b>4</b>	Restorante dhe aktivitete shërbyese të ushqimit	<b>75</b>
<b>5</b>	Prodhimi i bukës, simiteve dhe ëmbëlsirave	<b>69</b>
<b>6</b>	Ndërtimi objekteve banesore dhe jo banesore	<b>41</b>
<b>7</b>	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	<b>36</b>

**Llojet e bizneseve sipas gjinisë në Komunën e Dragashit:**

<b>Nr.</b>	<b>Llojet e bizneseve</b>	<b>Meshkuj</b>	<b>Femra</b>
<b>1</b>	Biznese Individuale B.I	<b>674</b>	<b>74</b>
<b>2</b>	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara SH.P.K	<b>81</b>	<b>17</b>
<b>3</b>	Ortakëri e Përgjithshme O.P	<b>2</b>	<b>1</b>
<b>4</b>	<b>Numri total i bizneseve për meshkuj dhe femra</b>	<b>757</b>	<b>92</b>

Të nderuar delegatë, për këto biznese, për mbarëvajtjen e tyre, për ofrimin e konsulentëve, përdoret Zyra për Regjistrimin e Bizneseve. Tash më lejoni ta paraqes para jush edhe Planin për vitin 2024:

*Drejtorati për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim i komunës së Dragashit, duke pas për bazë detyrat, obligimet dhe përgjegjësitë që dalin nga dispozitat ligjore dhe statuti i komunës së Dragashit, punën dhe veprimtarinë e vetë në vitin 2024 do ta përqendrojë në:*

**1. Menaxhimin e buxhetit ne baze të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësiwe, Ligjit mbi Financat e Pushtetit Lokal, Udhëzimeve Administrative dhe rregullave financiare të lëshuara nga MF dhe Komuna;**

**2. Monitorimin e regjistrimeve efikase dhe të sakta te të gjitha të hyrave, si dhe lehtësimin e rrjedhës së lirë të shpenzimeve në një mënyrë që është në konsistencë me rregullat e duhura të menaxhimit financiar dhe të bëjë regjistrimin e saktë të tyre;**

**3. Të përgatiten raporte financiare sipas kërkesave të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike në pajtim me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit të sektorit publik i bazuar në paratë e gatshme dhe me statistikat qeveritare;**

**4. Të plotësohen nevojat për informata nga ana e palëve kryesore të interesuara, duke përfshirë Kuvendin, Qeverinë, Donatorët, komunitetin dhe publikun;**

**5. Të siguroj që të bëhet barazimi sipas kërkesave te LMFPP në mes të SIMFK-së dhe Organizatës buxhetore;**

**6. Rritja e efikasitetit në punë në arkëtimin e të hyrave vetanake, tatimit në pronë, taksave dhe ngarkesave të ndryshme komunale dhe mundësia e gjetjes së burimeve tjera financiare, përmes donacioneve apo formave tjera;**

**7. Rritja e transparencës në nivelin me të lartë, para qytetarëve në grumbullimin, Shpërndarjen dhe shpenzimin e parasë publike;**

**8. Propozimi i rregulloreve financiare ne asamblenë komunale;**

**9. Përgatitjen dhe hartimin e strategjisë për zhvillim ekonomik lokal;**



*10. Informomi, orientimi dhe Promovimi i vlerave dhe produkteve vendore si resurse për zhvillim ekonomik si: Natyrore, Trashëgimisë kulturore, gastronomisë dhe potencialëve të biznesit privat në sektorë të ndryshëm.*

Në afatin kohor, punët i kemi ndarë. Deri më 12.01.2024 janë bërë punët përgatitore për fillimin e vitit buxhetor. Deri më datën 26.01.2024 është bërë barazimi i të hyrave dhe shpenzimeve me të dhënat në SIMFK. Më 29.01.2024 Përgatitja dhe dorëzimi i Pasqyrave financiare për vitin e përfunduar më janar-dhjetor 2023. Regjistrimi dhe raportimi për të hyrat vetanake të Komunës është detyrë e përhershme; Regjistrimi dhe ekzekutimi i urdhërpagesave në SIMFK është detyrë e përhershme; Regjistrimi dhe tërheqja e paradhënieve është detyrë e përhershme; Regjistrimi i pasurisë mbi 1000 euro në SIMFK dhe regjistrimi në e- pasuri nën 1000 euro është detyrë e përhershme; Regjistrimi i bizneseve, konsulta të ndryshme rreth bizneseve, mbajtja e kontratave, është detyrë e përhershme; Përgatitja e nismës për iniciimin e shpenzimeve për investime kapitale, në shkurt 2024; Shtypja e faturave, specifikat dhe vlerësimet e tokave për tatimpaguesit fillon në shkurt 2024; Shpërndarja e faturave të tatimit në pronë, shkurt-mars, fundi i marsit, është 31 marsi afati i fundit; Pranimi i ankesave dhe vërejtjeve nga qytetarët për faturat e tatimit në pronë është gjatë muajit mars; Bartja e të hyrave vetanake të pashpenzuara në mars-prill; gjithashtu më 16-17 prill 2024 kemi të konfirmuar pjesëmarrjen e Komunës në Panairit e Turizmit dhe Sportit, që do të mbahet përsëri në Prishtinë, ku do të marrin pjesë edhe disa biznese vendore; Raporti periodik mbi shpenzimin e mjeteve buxhetore për periudhën janar –mars 2024, për TM1 do të jepet në prill; Përgatitja dhe hartimi i strategjisë për zhvillim ekonomik lokal, që do të përgatitet në bashkëpunim me Kuvendin; Raporti mbi numrin e bizneseve të regjistruara, punë e vazhdueshme; Seleksionimi, verifikimi dhe printimi i faturave të tatimit në pronë do të kryhet gjatë muajit maj; Regjistrimi i të gjitha objekteve të reja të ndërtuara dhe verifikimi i objekteve tjera ekzistuese, detyrë e përhershme në Zyrën e Tatimit në Pronë; Bartja e shitblerjeve të kontratave dhe bashkëpunimi me MEF, Departamenti i Tatimit në Pronë, në vazhdimësi; Raporti mbi inkasimin e mjeteve nga shfrytëzimi i tokës, detyrë në vazhdimësi; Pagesa e tatimit, lëshuara e certifikatave të ndryshme për pagesën e tatimit dhe regjistrimi i objekteve të reja, në vazhdimësi; Përgatitja dhe procedimi i urdhër zotimeve për pagesë, në vazhdimësi; Gjithashtu, parashohim që gjatë këtij viti ta organizojmë edhe Panairin e Produkteve Lokale “EXPO SHARRI” 2024, mbetet në muajin korrik, data varet prej Kuvendit edhe Thirrjes publike të cilën do ta organizojmë. Meqenëse ka edhe shumë detyra të cilat nuk mund të përmblihen në Planin për 2024-tën, ne mendojmë që edhe këtë vit ta organizojmë edhe të jemi pjesëmarrës me bizneset në Panairin Ndërkombëtar për Promovimin e Produkteve “AGROKOS” në Prishtinë, i cili do të mbahet prej 19-20 tetor. Të nderuar delegatë, faleminderit për durimin e juaj! Ju uroj një ditë të mbarë!

**Erdžan Limanče: TË NDERUAR!** Në bazë të dispozitave ligjore në fuqi për rolin dhe kompetencat e Drejtorisë, Planin e Punës dhe detyrat specifike të përmbajtura për vitin 2023 si aktivitetet bazë dhe puna e Drejtorisë përkatëse gjatë vitit 2023 u zhvilluan si më poshtë.

### **SEKSIONI PËR BUJQËSI, TURIZËM DHE ZHVILLIM RURAL:**

**Bashkpunimi me MBPZHR:** Duke pasur parasysh se politika agrare shtetërore definohet në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtorati për Bujqësi, Inspektion, Turizëm, Pylltari dhe Zhvillim Rural, përmes Seksionit për Bujqësi dhe Turizëm, ka realizuar bashkëpunim të plotë me MBPZHR dhe zyrën regjionale të MBPZHR në Prizren, për t'u siguruar fermerëve rrugën më të shkurtër të shërbimeve dhe përfitimit të mjeteve të pagesës së drejtpërdrejtë (subvencioneve), si dhe mjeteve të Grantit për zhvillimin e bujqësisë.

Programi i pagesave direkte të MBPZHR për vitin 2023 - subvencionet janë realizuar për 306 aktivitete bujqësore sipas caqeve të mbuluara në afatet në vijim:

- Prodhimi blegtoral (mjelje, majmëri, mjelje e deleve, dhive qumështore, pulave, shpendëve të mishit etj.),
- Bletarët,
- Pemishtet (për rreshtat e mbjella dhe rendimentin)
- Perimet (për sipërfaqet e mbjella dhe rendimentin)
- Pagesa direkte për mbjelljen e kulturave të mëdha (për kulturat e mbjella dhe për rendimentin), si dhe
- Cilësia e qumështit të shitur nëpër qumështore e licencuara dhe pika grumbullimi të licencuara (aplikim çdo 6 muaj).

### **Programi i granteve zhvillimore të MBPZHR për vitin 2023.**

Ky program synon të mbështesë rritjen e konkurrencës së sektorit agro-rural, rritjen e prodhimit dhe produktivitetit, përmirësimin e sigurisë ushqimore, përdorimin e teknologjisë moderne, diversifikimin e aktiviteteve në ferma dhe ndërmarrje rurale, mbrojtjen e mjedisit dhe burimeve natyrore, krijimin e vendeve të reja të punës dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Fondet e grantit ishin të destinuara për rindërtimin dhe ndërtimin e fermave për lopë qumështore dhe dele, për fermat e pulave vozitëse, gjegjësisht vezët në prodhimtarinë blegtorale dhe mjetet e destinuara për prodhimtarinë bimore, si ndërtimi i serave, d.m.th. prodhimi i perimeve në një hapësirë të mbyllur, formimi i plantacioneve të frutave nën kulturën e mollës si dhe frutave të manaferrave (dredhëzave, mjedra dhe të tjera).

### **Në programin e MBPZHR - Thirrje për Grante në 2023**

Sipas kriterëve të përcaktuara, fermerët, agropërpunuesit dhe sipërmarrjet rurale kanë të drejtë të aplikojnë në disa masa dhe sektorë të Programit të Zhvillimit Rural 2023 si: MASA 1: Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore, MASA 3: Investimet në fizike. asetet në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore, MASS 7: Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i biznesit si dhe MASS 5: Zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal — Qasja LEADER.

Sektori i bujqësisë është i angazhuar dhe mobilizuar në mbështetje të vazhdueshme për nxitjen, plotësimin e dokumentacionit për aplikim tek fermerët, përpunuesit e produkteve bujqësore dhe ndërmarrjet rurale.

### **Përpunimi i informacioneve dhe njoftimeve për fermerët lidhur me pjesëmarrjen në konkurse:**

ndihma dhe informatat u janë dhënë fermerëve për grumbullimin e dokumentacionit të caktuar për

konkurs.

**Bashkëpunimi me zyrën rajonale të Bujqësisë në Prizren:** Lajmërimet dhe mbështetja për konkurs në projektet e Granteve dhe Subvencioneve (bletë, lopë qumështore, dele, dhi), organizimi i seminarit se si të bëhet një biznes plan për pjesëmarrje në Grante.

**Këshilla për fermerë dhe grupe të fermerëve:** Organizimi i trajnimeve për fermerët në prodhimtarinë blegtoriale. Aktivitetet bëhen në teren si dhe në hapësirat e sektorit.

**Bashkëpunimi me CARTIAS-in:** Vazhdimi i bashkëpunimit për realizimin e projekteve në sektorin e bujqësisë.

**Bashkëpunimi me IADK-në:** Vazhdimi i bashkëpunimit për realizimin e projekteve në sektorin e bujqësisë.

**Bashkëpunimi me OJQ-të komunale:** Bashkëpunimi për projektet bujqësore (trajnime, takime me të interesuar në sektorin e bujqësisë)

**Vizitat e qumështoreve për grumbullimi dhe përpunimin e qumështit:**

Me qëllim të arritjes së synimeve për ngritjen e kapaciteteve grumbulluese dhe ngritjen e cilësisë së qumështit dhe produkteve të tij. Si dhe ngritjen e cilësisë së qumështit nga ana e fermerëve, si dhe arritjen e qëllimeve në realizimin e subvencioneve nga Ministria për cilësinë e qumështit.

Ka një rritje të kënaqshme të cilësisë së qumështit për 6 muajt e fundit krahasuar me një vit më parë dhe një rritje në vëllim.

**Vizitat e fermerëve në pikat sezonale (verore):**

Kemi bërë disa vizita në terren, problemet mbetën të njëjta, nevojitet mbështetja e autoriteteve shtetërore për përmirësimin e kushteve sanitare dhe higjienike.

**Takimet dhe aktivitetet me bletarët:** Regjistrimi i bletarëve, janë indentifikuar problemet dhe roli i shoqatës dhe Drejtoratit për tejkalimin gjendjes aktuale (gjendja shëndetësore e bletëve). Në bazë të vërejtjeve të të gjithë bletarëve ka shqetësim për mbijetesë të këtij komuniteti. Probleme të dukshme me gjetjen e ilaçeve dhe ushqimit për shkak të lëvizjes së kufizuar të fermerëve.

**Bashkëpunimi me pikat grumbulluese të bimëve mjekësore dhe frutave të malit** - Bashkëpunim i gjerë në zgjidhjen e problemeve të këtij sektori dhe gjetja e mundësive për mbështetje të vazhdueshme me subvencione dhe grante zhvillimore në rritje të kapaciteteve.

**Takime dhe aktivitete me bletarët:** Regjistrimi i bletarëve, mbajtja e evidencës në këtë sektor. Ka nevojë të vazhdueshme për mbështetje me trajnime dhe këshilla të ekspertëve, si dhe mbështetje me subvencione dhe grante për përmirësimin e kushteve të punës në nxjerrjen e mjaltit, parandalimin dhe trajtimin, përgatitjet për mbrojtje nga sëmundjet.

**Bashkëpunimi dhe mbikëqyrja e të mbjellurave pranverore dhe vjeshtore:** Prill, Maj, Shtator-

Tetor.

Mbjellja ishte planifikuar në 100 Ha, ishte realizuar në 75 Ha.

**Organizimi dhe përcjellja e korrjeve:** Korrik-Shtator. korrja është bërë sipas planit pa probleme të dukshme me rendiment mesatar sipas regjionit tonë.

**Realizimi i Thirrjes Publike** - Subvencionimi i ushqimit për kafshë 2023: Ky projekt është realizuar përmes një thirrjeje publike ku janë shpallur kushtet dhe kriteret për aplikim. Në bazë të thirrjes publike kanë aplikuar gjithsej 254 aplikantë për bujqësi dhe të gjithë kanë plotësuar dokumentacionin e tyre, me gjithsej 254 përfitues në vlerë prej 87,807 euro (tetëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e shtatë euro).

Kjo thirrje publike është planifikuar, realizuar dhe financuar nga buxheti i komunës në vlerë të përgjithshme prej 87,807€ për subvencione në:

	<b>Lopë mjelëse</b>	<b>Dele mjelëse</b>	<b>Dhitë mjelëse</b>	<b>Bletë</b>	<b>Fëllënza</b>	<b>Pula</b>
<b>Numri i krerëve</b>	1639	9811	93	3586	650	7790
<b>Vlera për krerë</b>	30	3	3	2	0.3	0.2
<b>Gjithsej</b>	<b>49170</b>	<b>29433</b>	<b>279</b>	<b>7172</b>	<b>195</b>	<b>1558</b>
<b>Gjithsej</b>						<b>87807</b>

**Realizimi i projektit Organizimi i panairit me prodhime lokale-vendore:** Edhe këtë vit, si dhe vitin e kaluar, u organizua panairi i produkteve vendore. Ky projekt është realizuar përmes një thirrjeje publike ku përfitues i zbatimit ka qenë Shoqata e Biznesit të Sharrit të Dragashit, vlera e përgjithshme e projektit është 13.000 euro, është financuar nga buxheti komunal dhe mbikëqyrur nga sektori për bujqësi dhe zhvillim rural.

Në aktivitetet gjatë regjistrimit të prodhuesve bujqësorë dhe fermave, të cilat drejtohen si ferma komerciale, u formua gjendja dhe numri i blektorisë, si dhe sipërfaqja e prodhimit të arave dhe frutave. Në vitin 2023 janë regjistruar edhe 26 fermerë të rinj.

### **Sektori i Inspeksionit:**

1. Viti i inspektimit ishte një nga vitet më aktive.

2. Kontroll më i shpeshtë i tregut të kompanive për shkak të problemeve me 2 euro.
3. Lufta kundër uzurpimit të pronës shoqërore.
4. Rritja e bashkëpunimit me AVUK-në në fushën e zbatimit të vendimeve për ndalimin e pirjes së duhanit në hapësira të mbyllura dhe zbatimin e ligjit të ri për mbeturinat.
5. Statusi vjetor i inspektimit për vitin 2023 është si më poshtë:

Nr.rr.	Emri dhe imbiemri i Inspektorit dhe emri i inspeksionit	Numri i kontrollimeve me	Nr.i procesve me Vendim	Vendime	Numri i kërkesave për procedurë	Asistime	Numri i ankesave të avatuarëve	Paralajmërimet	Numri i inspeksioneve me të tjerët / policia
1	<b>Enis Sylejmani</b> Inspektor i tregut	<u>147</u>	<u>145</u>	<u>/</u>	<u>4</u>	<u>5</u>	<u>1</u>	<u>1</u>	Kontroll pa ndalesë AVUK dhe Policinë
2	<b>Armend Piraj</b> Inspektor Komunal	<u>224</u>	<u>113</u>	<u>206</u>	<u>2</u>	<u>113</u>	<u>19</u>	<u>/</u>	<u>2</u>
3	<b>Vetim Hasani</b> Inspektor i ndërtimit	<u>40</u>	<u>25</u>	<u>15</u>	<u>4</u>	<u>/</u>	<u>/</u>	<u>/</u>	<u>2</u>

### **Sektori i Pylltarisë:**

- Është shpallur oferta përmes zyrës së prokurimit për shitjen e masës teknike në rajonet e planifikuara të komunës, tenderin e ka fituar kompania “ BREDHIKU ” SH.P.K. nga Prizreni, me të cilën u nënshkrua kontrata.

- Ka përfunduar shitja e lirë e masës së drurit për qytetarët e komunës.

- Drejtoria ka realizuar aktivitete përtej kufijve të kompetencës së saj në parkun nacional "Sharri" bazuar në Memorandumin e Komunës së Dragashit dhe Ministrinë e Mjedisit për shkak të zyrtarëve të pamjaftueshëm të parkut për komunën tonë.

- Kemi pasur 11 raste të zjarreve në pyje dhe dëmi vlerësohet në 2163.00.

**Vërejtje:** Sipas ligjit të ri për pyjet e Kosovës, kompetencat e Drejtorisë në fushën e mbrojtjes dhe zbatimit të planit janë bartur në zyrën rajonale të Agjencisë për Pyjet e Kosovës në Prizren.

<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi i të ardhurave</b>	<b>Të ardhurat</b>
<b>I.</b>	<b>Të hyrat e administratës komunale të pylltarisë</b>	
1	Taksa për shitjen e masës drusore - Dru për ngrohje	28 606,80
2.	Taksa për shitjen e masës drusore - Dru teknik	2621,64
3.	Taksa për shitjen e masës drusore 50% nga kontrata 09.12.2022	3625,06
4.	Taksat për shitjen e drurit teknik sipas normës (me pakicë)	811,90
5.	Taksat e pastrimit të pyjeve	171,00
6.	Taksa për degët, degët e lajthisë, plehrat etj.	148,50
7.	Taksat për shërbimet nga pyjet private	632,79
8.	Taksat për transport	3.90
9.	Kompensimi i dëmeve në pyjore	940,67
	<b>Gjithsej</b>	<b>37 576,26</b>

## **TË NDERUAR!**

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Statutit të Komunës së Dragashit, drejtori i Drejtoratit për Inspeksion, Turizëm, Pylltari dhe Zhvillim Rural, dërgon këtë Plan të Punës të Drejtoratit, për vitin 2024.

Plani vjetor i Drejtoratit...përfshinë periudhën prej 02.01- 30.12.2024. Kuptimi i koncepteve për këtë Plan janë mjaft fleksibile me mundësi të përshtatjes së ndryshimeve të shkaktuara, harmonizimit kohor me lëvizje të vërteta dhe zhvillimin e Komunës së Dragashit.

Si qëllime kryesore të këtij Plani janë: përmirësimi i efikasitetit dhe funksionalitetit të Drejtoratit, kontaktet direkte dhe të përhershme me drejtoratet tjerë, ministritë përkatëse, partitë, institucionet ndërkombëtare dhe sigurimi i disiplinës në punë në atë nivel i cili mundëson kushte për punë ligjore të Drejtoratit.

## **SEKTORI PËR BUJQËSI, TURIZËM DHE ZHVILLIM RURAL:**

### **Qëllimet kryesore të sektorit**

1. Krijimi i kushteve për rritjen e kapaciteteve prodhuese, menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore (tokë, pyje, kullota dhe ujëra), modernizimi i bujqësisë, tërheqja e investimeve për krijimin e një mjedisi të favorshëm për rritjen e mirëqenies së qytetarëve në zonat rurale të Komunës së Dragashit.

2. Realizimi i projekteve të zhvilluara gjatë planifikimit, me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës dhe punës nëpërmjet:

- Investimeve kapitale (Infrastruktura e zhvillimit rural)
- Ofrimi i këshillave për fermerët për teknologjitë e reja në prodhimin bujqësor:
- Subvencionet në sektorin e bujqësisë,
- Huluntimi i burimeve financiare për sektorin e bujqësisë,
- Mbështetje për nismat e fermerëve në ngritjen e cilësisë dhe sasisë së produkteve bujqësore.



**3. Bashkëpunimi me institucionet qeveritare dhe joqeveritare, bizneset vendore dhe ndërkombëtare, për realizimin e projekteve zhvillimore komunale për një mjedis më të mirë për zhvillim ekonomik dhe bujqësor.**

**Bashkëpunimi me MBPZHR dhe Zyrën Rajonale:**

**Për çështjet e zhvillimit të projekteve, seminareve për çështjen e projekteve, seminarave për përkrahje, raportim, informata, lajmërimi, ndihma fermerëve për projektet e programeve të subvencioneve të ndryshme, granteve dhe premive.**

**Subvencionet dhe grantet:**

**Pjesëmarrja aktive e shërbimit për projektet e subvencioneve të mjeteve të grantit për prodhimtari bujqësore, njoftimi me kriteret për aplikim të cilat i rekomandon MBPZHR.**

- **Përpunimi dhe kontrollimi i mbjelljeve dhe korrjeve:**
- **Mbjelljet dhe korrjet pranëverore, Prill-Maj,**
- **Mbjelljet dhe korrjet vjeshtore, Shtator-Tetor,**
- **Raportet t'i dërgohen MBPZHR.**

**Bashkëpunimi me donatorët:**

**Me investitor vendor dhe të jashtëm për zhvillimin e Bujqësisë. Me Parkun Nacional “Sharri” lidhur me realizimin e projekteve të Komunës dhe drejtoratit në kufi të parkut për ndihëma në bujqësi për hartimin e kontratave për shfrytëzimin e kullotave të larta për kullotje sezonale në kuadër të Parkut Nacional “Sharri”, si dhe kërkesa nga udhëheqësia e Parkut nacional për hartimin e kontratave me fermerë për tokën e punushme bujqësore për nevojat e mbjelljeve dhe sigurimi i ushqimit për kafshë për fermat ekzistuese, si dhe për qëllime komerciale.**

**Bashkëpunimi me kooperativat, fermerët dhe gupe fermerësh:**

**Çdo muaj këshillime profesionale, trajnime për promovim më të mirë të prodhimeve me theks të vaçantë në prodhimtari blegëtorale. Në kërkesa, probleme dhe nevoja të fermerëve të gjenden zgjidhje të pranueshme. Vizitat e qumshoreve dhe pikave grumbulluese në komunën**

tonë.

**Bashkëpunimi me HELP-in, UNDP-in, CARITAS-in dhe IADK-në:**

të objekteve të kategorisë së parë dhe pa leje, kërkesa kemi 20; nga këto 20 nuk hyjnë në legalizim të objekteve, sepse kanë qenë objekte për të cilat është dhënë apo është kërkuar pëlqimi pas afatit kohor. Kërkesa që janë miratuar janë 3; kërkesa që janë në pritje, jo të refuzuara, janë 17. Tash kalojmë në investimet kapitale që janë menaxhuar, janë hartuar apo janë plotësuar nga ana e Dikasterit tonë. Gjithsej, vetëm në Dikasterin tonë, prej investimeve kapitale kemi pas 80 projekte, nga këto projekte nuk kanë mund të arrihet të punohen, apo të fillohen të punohen – 4. Po i cekim: Kubëzimi i rrugëve dhe murit mbrojtës në fshatin Mlikë – duhet cekur këtu pse nuk është bërë. Ka dalë në tender, kompania është ofertuar, mirëpo për shkaqe të parcelave që nuk kanë leje komuniteti, është rikthyer, kështu që nuk kemi pas mundësi tjetër për me zhvilluar tenderimin. Shpronësimi i parcelës të shkollës së Zgatarit në vlerën prej 10 mijë eurove; Ndërtimi i drenazhës së shkollës në fshatin Kapre – kjo për shkak se hartuesi i projektit e ka prurë shumë vonë, nuk ka pas mundësi implementimi; Rregullimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Shajne, në vlerë prej 5 mijë eurove – tri herë ka qenë në tender, nuk kemi pas ofertues. Do të thotë, këto kanë qenë projekte të cilat nuk kemi mund t'i fillojmë, prej atyre 80 projekteve tjera që i kemi filluar dhe i kemi implementuar, e disa janë në implementim, për shkak se janë dy-tre vjeçare. Nuk do të isha ndalë unë më shumë në Raportin e vitit paraprak, kështu që do të isha edhe më i shkurtër për Planin e Punës të vitit 2024. Si gjithmonë, Dikasteri jonë është i ngarkuar, pothuajse me të gjithë dikasteret tjera në bashkëpunim, që t'i realizojmë ekskluzivisht punimet në projektet e investimeve kapitale. Duke mos anashkaluar edhe të gjitha ato detyra që na cakton dhe na dirigjon ligji. Do të vazhdojmë, përveç investimeve kapitale, me legalizimin e ndërtimeve pa leje, sepse me ligj të Kosovës ky legalizim është shtyrë deri në vitin 2027. Ato të vitit të kaluar, që thamë që ishin në pritje, sivjet do të mundohemi t'i kryejmë, edhe të gjitha ato që na vijnë. Një rëndësi pak më të madhe dhe më të veçantë do ta ketë transferimi i Zyrës Kadastrale Komunale në Zyrën Kadastrale të Agjencisë së Kosovës, sepse me ligjin e ri të Kosovës, zyrat kadastrale komunale i kanë kaluar Agjencionit Kadastral të Kosovës. Kështu që, i kemi do vështirësi derisa të bëhet edhe ky transferim. E ceka, duhet t'i realizojmë të gjitha ato punime që na kanë mbetur, të vitit 2023 që vazhdojnë në 2024-tën, edhe këto do t'i fillojmë. Do të merremi prapë me hartim të projekteve ideore, do të vazhdojmë me mbikëqyrjen e projekteve, me pranimet teknike, me vlerësime, e shumë e shumë kategori tjera sa i përket investimeve kapitale. Për mos me ju lodhë juve, jemi të gatshëm, ato sa dimë dhe ato sa kemi informata, pyetjeve të juaja të ju përgjigjemi. Faleminderit!

**Behar Brenoli:** Në bazë të Statutit të Komunës së Dragashit, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale është përgjegjëse për:

- Sigurimin e kujdesit shëndetësor primar në komunën e Dragashit, në pajtim me rregullat ligjore.
- Inspektimi i qendrave private për kujdesin shëndetësor primar.
- Vlerësimi i nevojave për mbrojtje primare.
- Ngritja e objekteve lokale për kujdesin shëndetësor primar.

- Zhvillimi i buxhetit në bazë të nevojave lokale, duke ndjekur udhëzimet e Ministrisë së Shëndetësisë
- Koordinon dhe mbikëqyr punën e QKMF, QMF dhe AMF-së.
- Funksionimi i Qendrës për Punë Sociale dhe Mirëqenie Sociale.
- Zhvillimi i një plani akomodimi për territorin e komunës.
- Siguron ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare brenda territorit, sipas standardeve të vendosura nga MPMS dhe
- Punë të tjera të përcaktuara nga Kryetari i Komunës.

## SEKTORI I SHËNDETËSISË

### QËLLIMET E PËRGJITHSHME

Ofrimi i kujdesit shëndetësor primar për popullatën e komunës së Dragashit, përmes zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare në sistemin unik të shëndetësisë të Republikës së Kosovës.

- Shërbimet shëndetësore për zhvillimin, parandalimin, trajtimin, shërimin dhe rehabilitimin e sëmundjeve, çrregullimeve dhe lëndimeve.
- Edukimi shëndetësor dhe parandalimi, imunizimi dhe vaksinimi.
- Përcaktimi i diagnozës fillestare dhe kujdesin esencial shëndetësor, kujdesin akut, duke përfshirë kujdesin emergjent, stabilizimin dhe transportin në institucionet përkatëse, kujdesin e sëmundjeve kronike dhe intervenime kirurgjike të vogla.
- Kujdesi në shtëpi përmes vizitave të populates.
- Personeli shëndetësor dhe edukimi i popullsisë, imunizimi dhe vaksinimi.
- Përcaktimi i diagnozës fillestare dhe kujdesit bazë shëndetësor, duke përfshirë edhe intervenimet e vogla kirurgjikale.
- Promovimi i shëndetit oral, i cili e parandalon kariesin e dhëmbëve si kujdesin themelor dentar.
- Sigurimi i shërbimeve shëndetësore diagnostike - analiza laboratorike dhe të rentgenit në kuadër të kujdesit shëndetësor primar.
- Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i personelit shëndetësor dhe jo mjekësor
- Menaxhimi dhe shpërndarja e barnave nga lista esenciale
- Të afrohen shërbimet më afër popullatës.

### ORGANIZIMI I PUNËS

Struktura organizative e QKMF-së bazohet në Statutin e QKMF-së, Ligji për shëndetësi, UA që është në fuqi dhe përbëhet nga departamentet, sektorët dhe njësitë, si vijon:

I - Departamenti i Mjekësisë Familjare, me sektorë dhe njësi:

1. Sektori i mjekësisë familjare
2. Sektori diagnostikues
  - a) Njësia laboratorike
  - b) Njësia e rendgenit (rtg digjitale, UZ)
3. Sektori i Shëndetit Publik
  - a) Njësia e vaksinimit dhe e imunizimit.
4. Njësia e Sistemit Informativ Shëndetësor.
5. Sektori konsultativ
6. Sektori Emergjent

II. Departamenti i Administratës:

III. Departamenti i Stomatologjisë

IV. Farmacia Qendrore - brenda QKMF-së, e cila shpërndan barna nga lista esenciale e barnave në të gjitha QMF-të dhe AMF-të.

## INSTITUCIONET SHËNDETËSORE NË KOMUNËN E DRAGASHIT

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare ( 1 )

Qendra e Mjekësisë Familjare ( 5 )

Ambulanca të Mjekësisë Familjare ( 8 )

Shërbimi i kujdestarisë ( 1 )

## BURIMET NJERËZORE DHE STATISTIKA E PUNËTORËVE

Deri në fund të vitit 2023, numri i të punësuarve në sektorin shëndetësor është 100. Mjekët e mjekësisë familjare -16, dentistë -6, Farmaceut të diplomuar – 1, staf ndihmës -13, motra med. / teknik -58, administrata -1, shoferë -5.

QKMF-ja aktivitetin e saj e ka fokusuar në ofrimin e shërbimeve shëndetësore cilësore të bazuara në konceptin e mjekësisë familjare.

Të sigurohen pajisje, barna dhe materiale sanitare më cilësore.

Planifikimi dhe dinamika e ofrimit të shërbimeve, bazuar në mundësit e disponueshme të burimeve

njerëzore, numrin e institucioneve shëndetësore dhe kapacitetet buxhetore.

Përmirësimi i sistemit të informacionit shëndetësor.

Bashkëpunimi me të gjitha organizatat, si dhe me organizatat qeveritare dhe joqeveritare siç janë: CIMIK (KFOR), MSH, AHQ, AMC, AKK, WHO, UNICEF, Banka Botërore, etj.

## ARRITJET

Gjatë vitit 2023, shumica e institucioneve shëndetësore janë rinovuar.

Vetë Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare ka përjetuar një transformim si nga jashtë ashtu edhe nga brenda. Në të gjithë korridoret si dhe në laborator u vendos dyshemeja e re "Epoksi", e cila jo vetëm në pamje, por edhe në avantazhet e saj kontribuoi në mirëmbajtjen më të lehtë dhe në higjienë më të madhe në institucion. Janë zëvendësuar të gjitha dyert që ishin të vjetra dhe të pandryshuara që nga ndërtimi i objektet disa dhjetëra vite më parë. Muret e brendshme u rinovuan dhe dritat e vjetra u zëvendësuan me drita të reja led për të kursyer energji dhe për të siguruar ndriçim më të mirë në dhoma. U krye rinovimi i tualetit, si dhe ndërrimi i pajisjeve sanitare dhe rubinetave sipas nevojës.

Me zhvendosjen e Farmacisë Qendrore në katin përdhes, u fitua më shumë hapësirë për organizim dhe ruajtje më të mirë të barnave si dhe më shumë hapësirë në Departamentin e Pediatriisë dhe Vaksinimit, si dhe një hapësirë për Nëna dhe Fëmija (një dhomë për përgatitjen e fëmijëve për ekzaminim) dhe një hapësirë për monitorimin e pacientëve.

Renovimi i jashtëm hapi një hyrje të re në QKMF për Departamentin e Pediatriisë dhe Vaksinimit, u rinovuan shkallët dhe pllatoja në hyrjen kryesore, u riparua çatia, u zhvendos gjeneratori dhe u ndërtua një rrugë me një shteg tjetër në hyrjen e dytë. hyrje në Departamentin e Pediatriisë.

Në projektin e dytë të infrastrukturës janë rinovuar objektet: QMF Brodosanë, QMF Bellobrad, QMF Llopshnik, AMF Blaç, AMF Kuk, AMF Kosavë.

Në QMF Brodosanë janë rinovuar tualetet, fasada e brendshme, ndërrimi i qeramikës dhe pajisjeve sanitare, ndërrimi i ndriçimit dhe ndërhyrje të tjera.

Në QMF Bellobrad u rinovua fasada e brendshme, sanitarija dhe uji, ndriçimi dhe rryma, si dhe punimet në rregullimin e oborrit, kubëzimi dhe dera si dhe kanalizimi.

Në QMF Llopshnik u rinovua fasada e brendshme, sanitarija, ndriçimi dhe elektriciteti si dhe qeramika.

Në AMF Kosavë është vendosur fasada e jashtme, ngrohja qendrore, rinovimi i fasadës së brendshme, sanitarija, dyer dhe dritare si dhe dyshemetë.

Në AMF Blaç u rinovua çatia, u ndërruan dyert dhe dritaret, u rinovuan tualetet, është lyer dhe riparuar fasada e brendshme.

Në AMF Kuk u rinovua hyrja e objektit dhe punime të tjera.

Ka filluar edhe ndërtimi i QMF-së Krushevës (projekt dyvjeçar), objekti është ndërtuar (mure dhe pllaka).

Për herë të parë janë ofruar shërbime të specializuara falas për qytetarët e komunës sonë ku në bashkëpunim me OJQ Human Care kemi ofruar shërbime falas të gjinekologut, oftamologut, neuropsikiatrit dhe internistit-kardiolog. Gjatë këtij angazhimi, numri i qytetarëve tonë të cilët kanë marrë shërbime të specializuara:

- Gjinekolog - 761
- Oftalmolog - 836
- Neuropsikiatër – 470
- Internist-kardiolog – 570

Ofrimi i shërbimeve për pacientët pa participim.

Modernizimi i pajisjeve shëndetësore me rritje të shërbimeve, veçanërisht në shërbimet e urgjencës dhe diagnostikimin (laborator, radiologji, stomatologji dhe shërbime të tjera).

Blerja e materialeve për ndihmën e shpejtë dhe ndërhyrjen emergjente.

Blerja e materialit laboratorik dhe reagentëve.

Zbatimi i ligjeve aktuale, Ligjit të Shëndetësisë, Ligjit të Punës, akteve nënligjore dhe UA.

Përmirësimi i imunizimit dhe statutit të vaksinimit në komunën e Dragashit. Gjatë vitit 2023 (janar-dhjetor) janë kryer 4.333 ndërhyrje (vaksinime), nga të cilat 2.851 vaksinime të rregullta, 1.385 vaksina kundër gripit sezonal, 88 vaksina kundër tetanozit, 4 vaksina PCV , 5 vaksina kundër Hep B për të rritur. Vaksinimi i rregullt është organizuar me shumë sukses me një përgjigje shumë të lartë, ndër komunat më të suksesshme në Kosovë, rreth 96%.

Ne kemi vizituar institucionet me qëllim të monitorimit të aktiviteteve dhe eliminimit të dobësive.

Është me rëndësi të theksohet se numri i shërbimeve që kemi ofruar në Diagnostifikim/Laborator në tabelën e paraqitur në bazë të regjistrit i përgjigjet një pacienti, ndërsa duke marrë parasysh analizat individuale të kryera për një pacient, janë deri në 5 shërbime me mbi 25 analiza për pacient.

Në Sektorin e Mjekësisë Familjare, gjatë vitit 2023, janë pranuar gjithësej 88 242 pacientë dhe 370 shërbime ju ofruan pacientëve. 134

## INVESTIMET KAPITALE

Gjatë vitit 2023 janë realizuar projektet si në vijim

1. Renovimi i QKMF-së Dragash
2. Renovimi i oborrit të QKMF-së Dragash
3. Renovimi i objekteve të QMF-së Brodosanë, Bellobrad dhe Llopushnik dhe AMF Blaç, Kuk dhe Kosavë.
4. Ndërtimi i QMF-së në Krushevë (projekt dyvjeçar)
5. Blerja e automjeteve.

## VËSHTËRËSITË

Është e nevojshme që të vazhdohet me renovimin e objekteve shëndetësore që i kemi rinovuar këtë vit, si të tjerat në rajonin e Gorës, si dhe vetë QKMF-në në Dragash.

Kufizimet ligjore në bazë të popullsisë.

Mungesa e stafit, veçanërisht mjekët në komunitetin jo-shumicë.

Furnizimi i pamjaftueshëm me barna nga Farmacia Qendrore pranë Ministrisë së Shëndetësisë

## SEKTORI PËR MIRËQENIE SOCIALE

Raporti për periudhën Janar-Dhjetor 2023 përfshin punën e Sektorit të Shërbimeve Sociale Profesionale, Sektorit të Shërbimeve të Ndhmës Sociale dhe Sektorit të Shërbimeve Administrative-Financiare. Gjatë kësaj periudhe vjetore u mbuluan detyrat bazë të QPS-së, të cilat u zbatuan në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.

Udhëheqësi, zyrtarët e shërbimit social, si dhe në shumicën e rasteve drejtori i QPS-së, problemeve të paraqitura i janë qasur me përkushtim profesional, shumica e rasteve të paraqitura janë zgjidhur me sukses. Gjatë vitit kalendarik 2023, shërbimet e QPS-së janë angazhuar kryesisht në këto kategori:

DSHMS si dhe Shërbimi Profesional i QPS-së ka bashkëpunim shumë të mirë me Departamentin e Politikës Sociale dhe Familjes – në veçanti me Departamentin e shërbimeve sociale, me ministrinë e drjetësis pasi që punojmë dhe veprojmë sipas udhëzimeve të tyre. Ne gjithashtu kemi bashkëpunim të mirë me Departamentin e Politikave Sociale, me QPS-të në nivel rajonal dhe në nivel të Kosovës. Kemi bashkëpunim shumë të mirë me vetëqeverisjen lokale, drejtoritë komunale në përgjithësi. Kemi pasur bashkëpunim shumë të suksesshëm me Policinë, Gjykatën Themelore, Qendrën e Shëndetit Mendor të Komunitetit në Prizren, me OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare, kemi bashkëpunim me sindromën Down Kosova në Prizren për trajtimin e fëmijëve të kësaj kategorie si dhe këshillimin e familjarëve të tyre, me koordinatoren komunal për mbrojtjen e fëmijëve i cili është i punësuar nga UNICEF-i.

Shërbimi i Ndhmës Sociale gjatë këtij viti ka zbatuar me përpikëri Ligjin nr. 04/L-096 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. Ligji për skemën e ndihmës sociale në Kosovë, si dhe Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2013 për procedurat e paraqitjes së kërkesave për ndihmë sociale. Në ndihmën sociale përfshihen dy kategori, kategoria e parë (I) dhe kategoria e dytë (II). Numri i familjeve që përfitojnë ndihmë sociale ndryshon, gjatë stinës së verës numri zvogëlohet, ndërsa gjatë stinës së dimrit rritet. Përfitues të ndihmës sociale janë komuniteti shqiptar, goran dhe boshnjak. Ne kemi qenë gjithmonë në bashkëpunim me Departamentin e Ndhmës Sociale, ku jemi konsultuar për çdo problem.

Nga Ministria e Financave, Punës dhe Transferit, të gjithë përfituesit e ndihmës sociale gjatë vitit 2023 për muajin dhjetor kanë marrë ndihmë prej 120 euro plus për secilin anëtar të familjes 30 euro për subvencionim për ngrohje nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Vlen të theksohet se në këtë periudhë kemi pasur bashkëpunim me Kuvendin Komunal – Drejtoritë për Kadastër dhe Gjeodezi, Administratë, Arsim, Zyra për Punësim, Kryqin e Kuq të Kosovës, Bashkësinë Islame në Dragash, Kforin Turk.

Gjatë këtij viti, Qendra për Punë Sociale ka ndihmuar shumicën e personave në nevojë sociale në rehabilitimin dhe zgjidhjen e problemeve me të cilat ballafaqohen qytetarët e komunës. Kryetari i Komunës së Dragashit ka ndihmuar me 1200 € institucionin STREHIMOREN PËR GRATË DHE FËMIJË - SHTËPI E SIGURTË - PRIZREN, ku strehohen viktimat e dhunës në familje dhe viktimat e trafikimit me qenie njerëzore, fëmijët e keqtrajtuar dhe të neglizhuar.

Në komisionin mjekësor janë pranuar **242** raste, nga të cilat **215** janë miratuar, **8** raste janë refuzuar si dhe për **1** raste janë kërkuar dokumente shtesë.

Gjatë këtij viti kemi pasur **11** ankesa, prej të cilave **3** janë miratuar si dhe **8** janë refuzuar pas rishqyrtimit.

Shuma e taksave komunale për shërbimet e ofruara nga QPS-ja në vitin 2023 është **497 €**.

Në bazë të dispozitave ligjore dhe Statutit të Komunës së Dragashit, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka kryer draft plan-programin dhe aktivitetet që do të zbatohen në periudhën janar – dhjetor të vitit 2024.

## **Qëllimi i përgjithshëm**

*Ofrimi i kujdesit shëndetësor primar për banorët e komunës së Dragashit, përmes zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare në sistemin unik shëndetësor të Republikës së Kosovës*

*Siguron ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare brenda territorit, sipas standardeve të vendosura nga MPMS.*

- Shërbimet shëndetësore për zhvillimin, parandalimin, trajtimin, shërimin dhe rehabilitimin e sëmundjeve, çrregullimeve dhe lëndimeve;
- Edukimi shëndetësor dhe shërbimet e parandalimit, imunizimi dhe vaksinimit.
- Përcaktimi i diagnozës fillestare dhe kujdesin esencial shëndetësor, kujdesin akut, duke përfshirë kujdesin emergjent, stabilizimin dhe transportin në institucionet përkatëse, kujdesin e sëmundjeve kronike dhe intervenime kirurgjikale më të vogla;
- Kujdesi në shtëpi përmes vizitave të popullatës;
- Personeli shëndetësor dhe edukimi i popullsisë, imunizimi dhe vaksinimi;

- Përcaktimi i diagnozës fillestare dhe kujdesit bazë shëndetësor, duke përfshirë edhe intervenimet e vogla kirurgjikale;
- Promovimi i shëndetit oral i cili e parandalon kariesin e dhëmbëve si kujdesin bazë dentar;
- Sigurimi i shërbimeve shëndetësore diagnostike - analiza laboratorike dhe të rentgenit në kuadër të kujdesi shëndetësor primar;
- Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i personelit shëndetësor dhe jo mjekësor;
- Menaxhimi dhe shpërndarja e ilaçeve nga lista esenciale;
- Të afrohen shërbimet më afër popullatës.

## **Aktivitetet**

- Kontrollimi dhe menaxhimi i buxhetit.
- Ndërtimi i objektit të QMF-së në Krushevë;
- Renovimi dhe mirëmbajtja e objekteve shëndetësore;
- Miratimi i statutit të unifikuar të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Dragash;
- Renovimi i instalimeve dhe dyshemeve në Qendrën për Punë Sociale;
- Furnizimi me pajisje mjekësore;
- Vaksinimi i rregullt i fëmijëve si dhe kundër gripit sezonal dhe vaksinat e tjera;
- Furnizim me barna, material mjekësor dhe pajisje.
- Vizita sistematike të fëmijëve në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta.
- Vizita në shtëpi për gratë shtatzëna dhe fëmijët nga 0-3 vjet.
- Ekzaminime të specializuara në QKMF (oftalmolog, internist, neuropsikiatër, gjinekolog dhe të tjerë)
- Ekipet mobile për të moshuarit në vende ku nuk kemi objekte shëndetësore.
- Edukimi dhe trajnimi i stafit për ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët (me theks te mjekët por edhe stafi tjetër);
- Projekti "Mbështetja e Komunitetit", Ndërtimi i shtëpive për strehim social të cilin e realizon Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në bashkëpunim me DSHMS (vazhdim).
- Shërbimet sociale profesionale të ofruara me ligj, si dhe asistenca sociale;
- Krijimi i organit të kujdestarisë në Qendrën për Punë Sociale, si dhe organeve të tjera të parashikuara me akte ligjore.

**Zeni Krasniqi:** I nderuar kryetar, e nderuar kryesuese, të dashur delegatë të Kuvendit, kolegë të nderuar! Raporti i Punës së DKA-së, përkundër volumit të punës që ka Drejtorat, unë do të mundohem që të jem sa më i shkurtër në këtë Raport.

*Drejtoria për Arsim në vitin 2023 ka realizuar aktivitetet e veta në kuadër të dinamikës dhe vëllimit të punës të përfshira në planin e veprimit për këtë vit. Realizimi i detyrave të punës është bërë në harmoni të plotë me Statutin e Kuvendit Komunal, Ligjin për arsimin parauniversitar të Republikën e Kosovës Nr.04/L-032 dhe Udhëzimeve Administrative të nxjerra nga MASHT-i.*

*Në Komunën tonë funksionale janë 36 objekte shkollore dhe atë:*



Shkolla AMË	Shkolla Satelite	SHML – Mesme e lartë
12	23	1

Të gjitha këto shkolla janë në kuadër të arsimit publik ngase në territorin e komunës së Dragashit nuk funksionon asnjë shkollë private. Vlen të theksohet se kanë përfunduar punimet e Çerdhes në Dragash dhe pritet të funksionalizohet.

*Procesi arsimor është i organizuar në këto nivele:*

- *Arsim parafillor- organizohet me qëllim të përgatitjes së fëmijëve për vazhdimin e shkollës fillore dhe funksionon në kuadër të objekteve të shkollave fillore.*
- *Arsim fillor – në kuadër të këtij niveli përfshihen klasat 1-5 gjegjësisht moshat 6 deri në 10 vjeç,*
- *Arsimi i mesëm i ulët - përfshin klasat 6-9 gjegjësisht moshat 11 deri në 14. Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët është i obliguar dhe zgjat 9 vite.*

*Arsimi i mesëm i lartë- është i organizuar në:*

- *Arsimin e përgjithshëm (gjimnaz),*
- *Arsimin profesional.*

*Kohëzgjatja e këtij niveli është 3 vjet varësisht nga profilet arsimore të përcaktuara nga MASHT-i dhe përfshin moshat prej 15 deri në 17 vjeç. Në Sektorin për Arsim punojnë 4 punëtorë përfshirë edhe drejtorin e drejtorisë, kurse në të gjitha nivelet arsimore janë të angazhuar 442 punëtorë nga të dy komunitetet.*

*Në këtë vit shkollor numri i nxënësve në institucionet edukative-arsimore të Komunës së Dragashit është 3041. Duke e përfshirë arsimin parafillor, fillor dhe të mesëm.*

*Vitin shkollor 2023/24 e kanë ndjekur 3041 nxënës, bashkë me 3 paralele, Qendra me Bazë në Komunitet 60 nxënës në Brodosanë dhe 26 nxënës në Dragash **mosha 3-5 vjet**, grupuar në 23 paralele, të shpërndarë në:*

*12 Shkolla Fillore të Mesme të Ulëta;*

*23 Paralele të ndara të Shkollave Fillore;*

*1 Shkollë të Mesme të Lartë (Mikse);*

*Gjatë punës një vjeçare janë punuar 1485 lëndë administrative të cilat janë paraqitur sipas kërkesave e nevojave të shkollave, punëtorëve dhe organeve komunale.*

- *Vendime për ndryshime – kthim nga lehonja, kalimi në pushim lehonie,*
- *Vendim për largim – skadim kontrate, pensionim,*
- *Kërkesa, përgjigje, ankesa, pëlqime etj.*

*Janë realizuar aktivitete kulturo-artistike me rastin e shënimit të ditëve të shkollave.*

*Drejtoria e Arsimit ka bërë mbikëqyrjen e procesit edukativo-arsimor, mbikëqyrje e cila është duke u realizuar në vazhdimësi nga drejtori dhe zyrtarët komunal të arsimit.*

*Sipas dinamikës së planifikuar, drejtori së bashku me zyrtarë kanë realizuar planin operues, si: vizita informuese, speciale, kontrolluese dhe të përgjithshme në institucionet e arsimit, përkatësisht në shkollat fillore të mesme të ulëta dhe në shkollën fillore të mesme të lartë në Komunën e Dragashit. Në kuadër të mbikëqyrjes profesionale dhe kontrollit të vazhdueshëm të ecurive dhe zhvillimeve në procesin e institucioneve edukativo-arsimore të komunës së Dragashit, zyrtarët e Drejtorisë së Arsimit sipas planifikimit dhe dinamikës së paraparë gjatë këtyre muajve, kanë realizuar vizita speciale dhe kontrolluese në institucionet arsimore.*

*- Është bërë kompletimi dhe dërgimi i të dhënave në MASHT me qëllim të publikimit të konkursit për regjistrim të nxënësve në klasën e dhjetë, në SHML (Shkollën e Mesme të Lartë) dhe përcjelljen e procedurës së regjistrimit të nxënësve në shkollën e mesme të lartë.*

*- Përgatitja dhe regjistrimi i nxënësve të klasave parafillore dhe parashkollore.*

*- Përgatitja për regjistrimin e nxënësve në klasën e parë.*

*- Shpallja e konkursit të rregullt dhe plotësues është bërë me kohë për plotësimin e vendeve të lira të punës, mësimdhënës, punëtorë teknik. Janë pranuar 20 mësimdhënës, 2 ass. për fnva, 2 edukatore, 2 punëtor teknik, gjithsej të punësuar në arsim 26. Konkursi për komunitetin boshnjak është në procedurë të rekrutimit (ky konkurs ka përfunduar).*

*Gjithashtu është shpallë edhe konkursi për 6 drejtor shkolle dhe është në procedurë (ky konkurs ka përfunduar).*

*- Furnizimi i shkollave me dokumentacion pedagogjik: ditarë pune, librat të kujdestarisë si dhe kalendarin shkollor.*

*- Përcjellja e punës së shkollave për realizimin e ekskursioneve të maturantëve dhe semimaturantëve.*

*Furnizimi i të gjitha shkollave me lëndë djegëse.*

*- Përgatitja e raportit për suksesin dhe rezultatet e nxënësve të arritura në tri nivelet e arsimit parauniversitar gjatë gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2022/23.*

*- Drejtoria e Arsimit, në funksion të ngritjes dhe përmirësimit të cilësisë në arsim, ka realizuar vizita në drejtoritë e shkollave për të bërë një analizë të detajuar mbi planifikimin dhe realizimin e punëve dhe detyrave të përcaktuara për drejtorët e institucioneve edukativo-arsimore të nivelit të arsimit parauniversitar. Po ashtu janë analizuar të dhënat e ofruara nga drejtorët e shkollave .*

### **Testi i Arritshmerisë për vitin 2023**

Gjithsej **246** semimaturant të planifikuar nga 9 shkolla fillore, 7 shkolla Shqipe dhe 2 shkolla te komunitetit boshnjak.

Testit iu nënshtruan **244** nxënës. Organizimi i këtij testi është bërë në dy qendra testimi: në SHML “Ruzhdi Berisha” dhe në SHFMU “Fetah Sylejmani”- Dragash, në dy pjesë:

Pjesa e parë u mbajt me datë: 04.07.2023 dhe pjesa e dytë u mbajt me datë: 11.06.2023 prapë në qendrën e njëjtë në SHML” Ruzhdi Berisha “dhe në SHFMU “Fetah Sylejmani”- Dragash, në dy pjesë.

**Përqindja e nxënësve pjesëmarrës 99.19 %; 47.95 % M dhe 52.04 % F**

Testi u administrua nga 27 mësimdhënës të komunës tonë, profesorë te SHML-së “ Ruzhdi Berisha “- Dragash.

**Matura Shtetërore për vitin 2023** u organizua në SHML “Ruzhdi Berisha”, me gjithsej **152** maturantë të planifikuar, ku testit ju nënshtruan 152 maturant. Administrimin e testit e kanë bërë mësimdhënësit e komunës së Prizrenit. Në klasa kanë qenë deri në 15 nxënës për klasë. DKA-ja i ka kryer të gjitha përgatitjet e nevojshme teknike me përpikëri. Testi ka filluar dhe ka përfunduar me kohë dhe nuk ka pasur asnjë problem. Përqindja e kalueshmërisë në afatin e **qershorit** dhe në afatin e **gushtit 55.26 %**.

Me datë: 22.05.2023 është mbajt testi TIMSS, në SHFMU”Ilmi Bahtijari”- Blaç, me nxënës të klasës së IV. Me kërkesë të Policisë së Kosovës - Dragash, janë mbajtur ligjërata, për masat dhe sigurimin e një ambienti të sigurt në shkollat e Komunës së Dragashit dhe dokumentarë për vetëdijesim mbi rreziqet e lëndëve narkotike dhe pasojat shëndetësore, shoqërore dhe ligjore" dhe “Ruajtja e Ambientit dhe Trashëgimisë Kulturore”.

Gjithashtu vazhdon bashkëpunim i mirëfilltë me organizata të ndryshme siç janë: UNICEF, Cartiasin Zvicërran, Ambasada Amerikane, JICA si dhe CIMIC-u Italian, Avoko, ECMI.

Me UNICEFIN është hapë Qendra me Bazë në Komunitet në fshatin Brodosanë, me dy paralele me fëmijë të moshës 3-5 vjeç. Gjithashtu janë angazhuar 3 edukatore, me këtë grup moshë me pagesë deri me 31.12.2024. Kemi bërë Draft Planin Komunal të Veprimit për EPRBM i cili është përgatit nga Ekipi Komunal për PRBM në bashkëpunim me MASHT, UNICEF, ECMI.

Drejtoria e Arsimit në Dragash, po ashtu ka ndarë edhe bursa për studentet të Komunës së Dragashit, 110 bursa studentore. Drejtoria e Arsimit i ka plotësuar këto vende duke i zhvilluar procedurat e rekrutimit duke u bazuar në Ligjet dhe Udhëzimet Administrative që e rregullojnë këtë fushë. Pjesëmarrja e zyrtarëve për arsim gjithëpërfshirës në kuadër të projektit të përbashkët të Bashkimit Evropian\ Këshilli i Evropës ‘Ndërtimi i Kapaciteteve për përfshirjen në Arsim’ – INCLUDE, si dhe aktivitete të ndryshme të organizuara nga MASHT-i.

## **SFIDAT PËR VITIN 2023**

1. Zëvendësimi i personelit arsimor (procedurat e stërzgjatura).
2. Rënia e numrit të nxënësve (rënia e numrit të orëve).
3. Problem i pagesës së shujtave (përmbaruesi)
4. Kërkesat për pushim pa pagesë për mësimdhënës

## **REKOMANDIMET**

- Dezinfektimi i shkollave për nxënësit etj.
- Angazhimi i drejtoresve të shkollave për përgatitjet rreth fillimit të vitit të ri shkollor 2023/2024.

DKA do të punoj vazhdimisht për krijimin e kushteve sa më të mira në të gjitha shkollat e Komunës sonë, duke menduar gjithmonë më të mirën për të gjithë nxënësit.

Unë në këtë pjesën tabelare nuk do të ju marr kohë, vetëm në fund do të ju raportoj edhe për investimet kapitale që janë bërë në shkolla.

## **INVESTIMET KAPITALE PËR ARSIMIN NË DRAGASH 2023**

<b>Nr.</b>	<b>Projekti</b>
<b>1.</b>	<i>Renovimi i objekteve shkollore "Fetah Sylejmani"</i>
<b>2.</b>	<i>Renovimi i shkolles fillore "Svetlost" në Krushevë</i>
<b>3.</b>	<i>Renovimi i shkolles "9 Maj" në fshatin Rapçë</i>
<b>4.</b>	<i>Renovimi i shkolles fillore në fshatin Restelicë</i>
<b>5.</b>	<i>Renovimi i shkollës fillore "Ilmi Bahtijari" në fshatin Blaç</i>
<b>6.</b>	<i>Renovimi i shkollës fillore "Sezai Surroi" në fshatin Brrut</i>
<b>7.</b>	<i>Renovimi i shkollës fillore "Shaban Shabani" në paralelet e ndara Buçe, Brezne dhe Llopushnik</i>
<b>8.</b>	<i>Renovimi i shkollës fillore "Zenuni" në fshatin Brod</i>
<b>9.</b>	<i>Rregullimi i nxëmjes qendrore në shkollën fillore "Ulina" në fshatin Kosavë</i>
<b>10.</b>	<i>Ndërtimi i murit mbrojtës në shkollën fillore "Samidin Emin" në fshatin Kuk (faza e parë dhe faza e dytë)</i>

<b>11.</b>	<i>Renovimi i shkollës së mesme “Ruzhdi Berisha” në Dragash</i>
<b>12.</b>	<i>Rindërtimi i shkollës fillore “9 Maj” paralelja në Kërstec dhe parku i lojrave, financuar nga ambasada Bullgare</i>
<b>13.</b>	<i>Renovimi i banjove të shkollës “28 Nëntori”</i>
<b>14.</b>	<i>Renovimi i çerdhës në Dragash</i>

Ju e dini se bëhet këtë vit edhe transporti i nxënësve, ky ka qenë i vjetri, do të thotë relacionet Buzez-Bresanë, Rrenc-Dragash – e kam fjalën për periudhën janar-qershir 2023 – Plavë-Llopushnik, Zym-Bellobrad, Xërxe-Dragash, Kapre-Bellobrad dhe Pllajnik-Kosavë.

***TRANSPORTI I NXËNËSVE TË SHKOLLAVE FILLORE (SHTATOR-DHJETOR 2023)***

<b>Nr.</b>	<b>Transporti</b>
<b>1.</b>	<i>Transporti i nx shkollat fillore Pllajnik-Kosavë</i>
<b>2.</b>	<i>Transportimi i nx shkollat fillore Brrut-Bellobrad</i>
<b>3.</b>	<i>Transportimi i nx shkollat fillore Buzez-Bresane</i>
<b>4.</b>	<i>Transportimi i nx shkollat fillore Zym-Bellobrad</i>
<b>5.</b>	<i>Transportimi i nx shkollat fillore Kapre-Bellobrad</i>
<b>6.</b>	<i>Transportimi i nx shkollat fillore Pllavë-Llapushnik</i>
<b>7.</b>	<i>Transportimi i nx shkollat fillore Rrenc-Dragash</i>
<b>8.</b>	<i>Transportimi i nx shkollat fillore Zaplluxhe-Blaç</i>
<b>9.</b>	<i>Transportimi i nx shkollat fillore Brezne-Llapushnik</i>
<b>10.</b>	<i>Transportimi i nx shkollat fillore Zgatar-Blaç</i>
<b>11.</b>	<i>Transportimi i nx shkollat fillore Buçe-Llapushnik</i>
<b>12.</b>	<i>Transportimi i nx shkollat fillore Xërxe-Dragash</i>
<b>13.</b>	<i>Transportimi i nx i shkollave fillore Restelicë-Dragash</i>

<b>Nr.</b>	<b>Transporti</b>
<b>1.</b>	<i>Transporti i nx shkollës së mesme Llopushnik-Dragash (Brezne, Buçe, Pllavë, Rrenc)</i>
<b>2.</b>	<i>Transporti i nx shkollës së mesme Zaplluxhe-Dragash (Zaplluxhe, Blaç, Bresanë, Kuk, Buzez, Kosavë, Kapre, Zgatar, Brrut, Bellobrad, Zym)</i>
<b>3.</b>	<i>Transporti i nxënësve për ndjekjen e praktikës profesionale në Spitalin e Prizrenit (Dragash-Prizren ose Gjymnaz-Spital)</i>

### **FURNIZIMET NË ARSIM PËR 2023**

<b>Nr.</b>	<b>Furnizimet</b>
<b>1.</b>	<i>Furnizimi me lëndë djegëse në shkolla dhe për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës (dru)</i>
<b>2.</b>	<i>Furnizimi me ditarë në të gjitha shkollat</i>
<b>3.</b>	<i>Furnizim me material shkollor</i>
<b>4.</b>	<i>Furnizimi me lëndë djegëse (naftë për ngrohjen qendrore) në shkollën “Ruzhdi Berisha”</i>
<b>5.</b>	<i>Furnizim me pelet për AMF-te ne Restelicë, Brod, Rapçë dhe shkollën fillore “Fetah Sylejmani” dhe paralelën e ndarë në Shajne</i>
<b>6.</b>	<i>Furnizimi me toner për shkollat e K.K Dragash</i>
<b>7.</b>	<i>Furnizime me Letër A4 për gjitha shkollat</i>
<b>8.</b>	<i>Furnizime me material higjienik për gjitha shkollat</i>
<b>9.</b>	<i>Furnizime me fotokopjues në të gjitha shkollat amë</i>
<b>10.</b>	<i>Furnizime për zyrë</i>
<b>11.</b>	<i>Furnizime me inventarë</i>

Ky – të dashur delegatë – ishte Raporti i Punës në pika të shkurta. Sa i përket Planit të Punës, unë do të isha ndalë më shumë, por s’e di a ka nevojë me e zgjat shumë. Ju e keni para jush, në formë tabelare është paraqit, shumë është konkret.

*Analiza e suksesit të nxënësve gjatë vitit 2023/2024 në fund të gjysmëvjetorit të parë dhe të dytë; Informat mbi fillimin e vitit shkollor 2024 -2025; Hartimi i dinamikës dhe përcjellja e fillimit të vitit shkollor. Vizitë me kryetarin e komunës, qëllimi: urim për vitin e ri shkollor; Përgatitja dhe regjistrimi i nxënësve para fillor dhe klasë të parë; Java e gjelbërimit për të gjitha shkollat; Vazhdimi i bashkëpunimit me lidhjet e krijuara, Drejtori Komunale e Arsimit – Shkolla me shtete të ndryshme, si dhe krijimi i lidhjeve të reja me interes për shkollat dhe Arsimin – Dragash; Organizimi i garave, kuizeve të diturisë, në nivel komune me nxënës të shkollave fillore të mesme të ulta; Bashkëpunimi me MASHT –in, Zyren rajonale të inspeksionit në fusha të ndryshme të arsimit; Përgatitja e projekteve për rregullimin e infrastrukturës shkollore, oborreve dhe këndeve të gjelbërta të shkollave; Organizimi i garave shkollore në sport: futboll të vogël, basket dhe atletikë; Kompletimi dhe dërgimi i të dhënave në MASHT me qëllim publikimi i konkursit për regjistrim të nxënësve në SHML; Përcjellja e procedurës së regjistrimit të nxënësve në SHML; Shpallja e konkursit të rregullt për plotësimin e vendeve të reja të punës me mësimdhënës të kualifikuar...*

Thashë, e kemi konkursin e rregullt, normal, që duhet...

Përgatitja e objekteve shkollore për vitin 2024/2025, s’e di a ka nevojë me hy; Furnizimi i shkollave me lëndë djegëse, me dru, naftë e pelet, përzgjedhja e operatorit; Riparimi i nyjeve sanitare; Furnizimi me mjete shkollore, salla, kabinete; Furnizimi me inventarë shkollore, banka, karrika, tavolina etj; Mirëmbajtja dhe rregullimi i oborreve të shkollave, i terreneve sportive; Furnizimi dhe mbikëqyrja e furnizimit të nxënësve me tekste shkollore; me mjete higjienike, me materiale administrative; Furnizimi i shkollave me material për zhvillimin e aktiviteteve, implementimin e pjesës që ka të bëjë me Planin Zhvillimor të DKA-së. Mandej për këto tjerat, aktivitetet që kanë të bëjnë me procesin edukativo-arsimor, nuk po i përmendi. Mandej, aktivitetet dhe bashkëpunimi i DKA-së me kryetarin e Komunës, KKSB-në, MASHTI-n dhe drejtoritë tjera komunale; Bashkëpunimi i DKA-së me organet e sigurisë, OJQ-të, mediat dhe komunitetin; Bashkëpunimi me përfaqësues të Komunës për implementimin e projekteve që kanë të bëjnë me integritet evropiane. Edhe investimet nëpër shkolla, kemi paraparë më pak investime këtë vit:

<b>Nr.</b>	<b>Lloji i projektit për vitin 2024</b>	<b>Data e fillimit dhe mbarimit</b>
1	<i>Renovimi i shkollësfillore në fshatin Restelicë</i>	03.2024-12.2026
2	<i>Renovimi i shkollës fillore Zenuni në fshatin Brod</i>	01.2024 -12.2024
3	<i>Rregullimi i nxemjes qendrore në shkollën fillore Ulina në Kosovë</i>	02.2024-12.2024



4	<i>Ndërtimi i dyshemesë dhe blerja e paisjeve për sallën e Ed. Fizike në SHFMU “ 28 Nëntori “ - Brodosanë</i>	02.2024 -12.2026
5	<i>Ndërtimi i tereneve sportive në SHFMU “Svetllost” – Krushevë, , Zlipotok dhe Glloboqicë</i>	02.2024-12.2026
6	<i>Ndërtimi i rrugës dhe oborrit të SHFMU-së “ Ulina “ - Kosavë</i>	02.2024 -10.2024

Ju falënderoj për vëmendjen!

**Arijeta Skeraj:** Faleminderit, z.Krasniqi! Para se me ua dhënë fjalën anëtarëve të Kuvendit, ju kisha lut të gjitha drejtorive, t’i shkruani të gjitha pyetjet që jua bëjnë edhe të gjithë anëtarëve të Kuvendit duhet t’u jepni përgjigje!

**Bexhet Xheladini:** Të nderuar asambleistë, ju falënderoj për durimin që keni pasur me i dëgjue raportet e drejtorive dhe te kryetarit të Komunës! Unë ju kisha lut, ata të cilët kanë me m’u drejtue me pyetje mu dhe drejtorit të Administratës, ju kisha lut të orientoheni në fillim t’i bëni këto pyetje, për arsye se unë kam me udhëtue jashta vendit në ora 15:00. Kështu që, nuk kam shumë kohë.

**Nedžmidin Sejdir:** Unë e kuptoj që Bean Hadziasan nuk është drejtor, ai është një kukull, drejtori i vërtetë është ai që ishte këtu tani. Është plotësisht e qartë, por të paktën tregoni vizualisht se keni një drejtor. Të dashur qytetarë, prej 3 vitesh nuk e dimë se si duket Beani. A mund të flasë fare? Dhe çdo vit kur duhet të raportojë para kuvendit është gjithmonë në rrugë. Nuk ka asgjë nga ky asamble, këtu të gjitha projektet llogariten paraprakisht. Ne jemi manipuluar nga autoritetet eprore për të përmbushur vizualisht disa standarde. Kjo administratë do të mbahet mend se ka uzurpuar organin më të madh të komunës - Kuvendin. Unë jam mirënjohës për kohën, sepse së shpejti do të shohim kurrizin tuaj. Drejtori i lartpërmendur ka tre vite që është në rrugë. Sa herë që duhet t’i drejtohet kuvendit, ai është në rrugë. Unë bëra një pyetje specifike në lidhje me ngrohjen në QKMF. Pse nuk e keni rregulluar ngrohjen vitin e kaluar, dhe se stafi ngrohet me ngrohje kuarci. Keni blerë një ambulancë Citroen në 2021, a e keni bërë servisën sepse shoferët ankohen se nuk mund të ecë më shumë se 40 km/h. E keni vënë re që nuk ka ventilim në Qendrën Emergjente? Asnjë dritare nuk hapet. Ju nuk e keni vënë theksin tek pajisjet mjekësore, por vetëm tek rinovimi. A e dini se nuk ka ujë të nxehtë atje lart? E shtypa atë çelës me këtë gisht, shkova sërish atje të nesërmen dhe ndodhi e njëjta gjë, Loshaj është dëshmitar im. A do të gjeni një elektrikist për të ndezur dritën? Nuk keni drita atje. Sa keni paguar për shampon dhe antifrizin e makinave? Çfarë keni bërë me Sensen, duke pasur parasysh se ajo ka manipuluar paratë dhe pajisjet e komunës, nëse ato para dhe pajisje i janë kthyer komunës. Projekti OJQ-ve DO Gore dhe Zaeno za Brod, çfarë kanë bërë, kam informacione se e kanë shkruar projektin, kështu që nëse është kështu,

gjysmën e parave t'ia kthejnë komunës. Ku u shpenzuan ato 2000 euro që i janë dhënë OJQ-së DO Gore. Ato para i dhanë për projektin apo për ta nxjerrë TV RTK-në nga kjo sallë kur duhej të shtynin projekte katastrofike për Gorën. Rruga për në Krushevë është bërë e rrezikshme sidomos kur bie shi. Vihet re se edhe një pjesë e rrugës është shembur. Jo vetëm që bien gurë e gurë, por është shembur edhe një pjesë e rrugës. Jam i vetëdijshëm që është rrugë rajonale, por duhet të jemi të vetëdijshëm se kemi obligim të kujdesemi për sigurinë e qytetarëve tanë. A keni bërë të njëjtën gjë dhe cila është zgjidhja e përhershme për këtë çështje.

**Arijeta Skeraj:** Faleminderit, z.Sejdilar! Para se me ua dhënë anëtarëve fjalën, kryetari i Komunës kërkoi që, pyetjet që do t'i drejtohen kryetarit dhe drejtorit të Administratës, ju kisha lut që veç kryetarit dhe drejtorit t'i bëni pyetje, për arsye se duhet me e lëshue kryetarin, se do të udhëtojë jashtë vendit.

**Samidin Xheladini:** Të nderuar drejtorë, kryetar dhe i gjithë stafi, ju falënderoj për raportin shumë të bukur, shumë voluminoz, 146 faqe, të përpiluar me kujdes, edhe për punën që e keni bërë. Raporti ka qenë me të vërtetë punë e mirë e të gjithëve që kanë marrë pjesë. Tash, këto janë domethënë raportet e punës të vitit 2023. Dhe Planin, prapë është Plani shumë i mirë. Besoj që duhet ta realizoni me përpikmëri. Por, çka ka këtu që duhet të diskutohet? Unë nuk dua të hyj tash në resorët tjerë, për shkak se do t'u lë hapësirë edhe tjerëve. Por, unë po dua këtu, zyrtarisht, ta ngris një çështje shumë me rëndësi për mu personalisht, edhe për pacientët. Qe dy vite reagensa nuk ka për laborator. Në fillim të mandatit, kryetari i Komunës na ka ftue mu, drejtorin, drejtorët, të QKMF-së, drejtorin e Drejtoratit, shefin e Laboratorit, laborantët, të gjithëve na ka ftue edhe na ka njoftue se ka mjete të mjaftueshme për funksionimin e laboratorëve në të gjitha QMF-të dhe QKMF. Dhe, ka pas vërejtje si mjek, ka thënë, më është drejtue mu, pse laboratorët nuk bëjnë analiza mirë, pse s'po i bëni analizat saktë? Çka është në pyetje, aparatura, reagensat, apo çka? Unë vetë kam thënë nuk po di me i bo analizat. Shefi Agim Dauti ka thënë jo, s'është e vërtetë. Po çka është? Faktori njeri. Ali Hoxha-Hoxhë Alia. Po tash faktori njeri, se na ka thënë që ka mjete, por ma e keqja që ka ndodhë, reagensa nuk kam pas. Çdo pacient do me e ditë, pse s'ka reagensa. Kam ladrue poshtë e naltë, te drejtori i QKMF-së, te shefi, sa që edhe unë po duhet atje edhe fizikisht me u trajtue me atë zotërinë atje, për me kërkue reagensa. Këtë nuk e kam debatue me vëllain, as si kryetar e as si vëlla, se s'kam dashtë me e shqetësue, i ka punët e veta, unë i kam punët e mia. E njoftova edhe drejtorin, dhe shumë herë drejtorin kam shkue e kam zënë, i kam ballafaque, me e ditë ku është faji. Unë prej drejtorit kërkova edhe parëz, me na dhënë përgjigje. Unë këtë e konsideroj sabotim. Kush po saboton në këtë drejtim, le të japë llogari. Unë po kërkuj që të ngrihet një komision bile, le ta vlerësojë, se ai thotë jo e kam çue kërkesën atje, jo e kam çue atje. Tash, në këtë moment, prej se u bo drejtor ky Endrit Piraj, menjëherë tenderi ka dalë, edhe unë në Komision kam qenë, edhe po më vjen mirë. Na kemi problem, se unë nuk po mundi me i dhënë përgjigje çdo pacientit atje, laboratori në Dragash s'funksionon, në Krushevë s'po funksionon, në Bresanë, në

Bellobrad. Ai s'e di çka bon, a punon a s'punon, a shkon në punë a s'shkon, e drejtë e tija është. Në Bresanë laboratorit që një kohë të gjatë, që tre muaj unë nuk kam fare reagensa. Edhe e dyta drejtor, 100 herë kam thënë edhe prapë po them, unë i kam 4 mijë e 200 e diçka pacientë dhe qaq shërbime. Kur ta llogaritish, unë i kam pas mbi 22 mijë e diçka shërbime në laborator në Bresanë, se s'i mora shënimet, i kam nxjerrë qatë. Pse po i hupni shërbimet, kur drejtori i QKMF-së në Prizren ka përfitue nga këto shërbime që i ka pasqyrue në laborator. Laboratori i QKMF-së në Prizren ka marrë mjete voluminoze për laboratorë. Një pacient nuk e ka një shërbim, po i ka afër 50 shërbime, mbi 20. Veç pasqyra e gjakut i ka 20 shërbime. Pse po i hupni shërbimet, në vazhdimësi, prej se jam këtu delegat hupin qatë shërbime. Veç në laborator po flas, plus shërbimet tjera. Pse mos me i pasqyrue në ministri, me i çue na raportet që i kemi edhe me kërkue prej Ministrisë që këto shërbime bëhen. Unë s'e di sa ndikon, po unë edhe me zyrtarin atje lartë kam pas probleme, ai po më kallxon mu se jo kështu është, jo kështu është. Po më kallxon rrena. Se ai po priton me punue, s'po i pasqyrojnë edhe po i marrin kallup, po i qesin knej edhe andej edhe u krye muhabeti. Drejtor, me marrë masa të lutem, drejtori i Shëndetësisë s'është këtu, drejtor ti me marrë masa për këtë punë edhe me na dhënë shpjegim për këto probleme. Faleminderit!

**Shpetim Hajredini:** Përshëndetje edhe një herë për të gjithë! Kisha pas dëshirë të jetë këtu drejtori i Administratës dhe të diskutoj me të, po pasi që nuk e kemi, besoj edhe kryetari ka mundësi të më japë përgjigje për pyetjet e mia që do t'i parashtoj, e që i përkasin Drejtorisë së Administratës. Nuk do të diskutoj atëherë për përmbajtjen e materialit i cili na është sjellë nga Drejtoria e Administratës, pasi që, diskutuam apo jo, Raporti është i përfunduar dhe nuk do të ndryshojmë asgjë. Unë do të paraqes para jush një raport të performancës së Administratës, të cilën po e kryjke gjithmonë, çdo vit, MAPL-ja. Në këtë raport pasqyrohen dy aspekte kryesore në të cilat bazohet MAPL-ja, e të cilat janë mënyra e qeverisjes së komunave bazuar në legjisllacionin në fuqi, dhe ofrimin e shërbimeve në aspektin sasior dhe cilësor kur është e mundur. Raporti nxjerr përfundimet e përgjithshme për shkallën e të arriturave të komunave dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e shërbimeve, në bazë të rregullave juridike në fuqi dhe standardeve të kërkuara qeverisëse. Kur marrim dhe e shikojmë tabelën në të cilën është bërë krahasimi ndërmjet komunave për shërbimet publike administrative, shohim se Komuna e Dragashit qëndron shumë keq. Qëndron e treta për nga fundi. Prej 30 komunave, qëndron e treta nga fundi. Unë kisha pas qef, thashë edhe në fillim, që të jetë këtu vetë Vetimi, edhe ta diskutojmë këtë temë pak më gjerësisht, të shoh se çk mendon ai në këtë drejtim. Unë personalisht besoj që, ta shikojmë në aspektin e përgjithshëm, Drejtoria e Administratës ka punuar, nuk mund të themi që nuk ka punuar dhe nuk ka bërë ndryshime. Mirëpo, kjo statistikë e MAPL-së po e tregon të kundërtën. Andaj, besoj që në Planin e Punës, e kam lexue në detaje, ka dhënë disa shpjegime që besoj që do të ndikojnë në Grantin e Performancës të vitit të ardhshëm, por edhe do të ndryshojë dhe do të kalojë në renditje pak më lart sesa qëndron tani, pasi që kjo tabelë dhe kjo performancë për mu është shumë e ulët, pasi që

krahasohet ...vetëm Mamusha dhe Graqanica janë më ulët se ne. Nëse nuk keni mundësi të më jepni detaje, kryetar, nuk është problem, atëherë mund ta lëmë në seancën e ardhshme, kurdo që të jetë Vetimi, edhe e marrim përgjigjen prej tij, besoj që ai ka përgjigje dhe m'i jep me detaje përgjigjet të cilat po i kërkoj. Unë kam për të bërë pyetje edhe për drejtoritë tjera, po pasi që veç kërkoje që ta kryej vetëm për Drejtorinë e Administratës, atëherë po e lë me kaq dhe vazhdoj pastaj. Ju faleminderit!

**Uran Halimi:** Meqenëse e kemi të caktume vetëm për kryetarin dhe për drejtorin e Administratës, s'kam qef me i bo pyetje njerëzve që mungojnë këtu, se është sikur me folë vetmevete. Mungesa e drejtorëve, sidomos në raport të punës edhe në plan të punës, kryetar është e pajustificueshme. Ata e kanë ditë, se seanca u thirrë që ma shumë se një javë, unë po besoj. Edhe, me të vërtet, nëse mungon një drejtor – kemi edhe drejtor që kanë mungue gjithmonë në raport të punës – mirëpo mungesa e drejtorëve është me të vërtet a pajustificueshme. Do votues të juajit edhe unë si votues i juaji, kam qef me e ditë çka keni punue dhe çka po planifikoni me punue, edhe pse jeni t'u e dëshmue që me punën jeni shumë larg. Përveç reagimeve që i bëjsh në Facebook, ti kryetar je i mirë në Facebook, e qeverisish mirë Facebook-un, s'di kush t'i shkrun ato reagimet, po i ke edhe ato të rrejshme. Arsyeja që po dyshoj ku po t'i shkrun ato është se na njihemi, po po të shtin me rre me ato reagimet. Me m'ngue mu, lexoi përpara se me t'i postue ata njerëz, thuj po i lexoj unë ni herë. Janë reagime me të vërtet gënjeshtër. Puna jote si kryetar, në kundërshtim me Qeverinë e Kosovës, është e vërtetë që llogaritet si punë antishtetërore. T'u i shpërblye njerëzit e strukturave paralele që kanë bo punë të dyshimta, t'u i punësue në Komunë, t'u i shkarkue në qendër e t'u i punësue e t'u i shpërblye ti, kjo nuk të qet mirë kryetar. Mos të them tipari yt prej tradhtari, se po më vjen shumë e ulët, po vazhdimisht, prej fillimit të qeverisjes e ke pas këtë tipar, me votuesit, me VV-në, me njerëz të partisë juaj. E dish shumë mirë çka ju ke bo disa prej tyre. Kam fillue me të njoft edhe po ta hulumtoj edhe të kalumen tënde, vazhdimisht e ke përdorë intrigën, dallaverën, me i zhgënje shokët tu edhe me ardhë në pushtet t'u i tradhtue ata. Tradhtinë qa ia ke bo LVV-së po ta fali, kur po e shoh çka ju ke bo kolegëve tu bashkëpartiakë.

**Arijeta Skeraj:** z.Uran, unë të kërkoj falje, a ka mundësi, këtu nuk kisha lejue...

**Uran Halimi:** Po kryetari s'ka me qenë në eventuale. Kjo është arsyeja pse unë po ia them këto tash.

**Arijeta Skeraj:** Okej, për të kalumen e të ardhmen e kryetarit, të isha lut, edhe një herë po ta bëj vërejtje, që mos të dalësh në personale. Hera e fundit është, përndryshe unë kam të drejtë ty me ta ndalue fjalimin. Asnjë delegat, ose asnjë nga ekzekutivi nuk e lejoj që me u lëshue në personale. Mundesh me vazhdue! Faleminderit!

**Uran Halimi:** E nderuar kryesuese, tendenca jote për me ma ndalë fjalimin, u pa edhe te pika eventuale, që ti e ke hek prej rendit të ditës, po është mirë mos me na ndalë fjalën, se na kemi të drejtë këtu. Na ka delegue qytetari për me folë këtu. Ne jemi zëri i qytetarit. T'u ma ndalë mu fjalën, ia ke ndalë fjalën qytetarëve.

**Arijeta Skeraj:** Të lutem Uran, pika eventuale ka qenë kërkesë e disa anëtarëve të Kuvendit që të hiqet, për arsye që nuk ka qenë kryetari.

**Uran Halimi:** Mundesh me i përmend me emra.

**Arijeta Skeraj:** Jo, nuk mundem me i thënë me emra, se për me emra unë nuk i klasifikoj njerëzit. Po si parti, kanë lyp disa nga anëtarët që pikën eventuale, kur nuk është kryetari, mos me e qit në rend të ditës. Tash mundesh me vazhdue!

**Uran Halimi:** Faleminderit shumë! Tash veç edhe një minutë, e nderuar kryesuese. Tendenca për me ma ndalë fjalën mu edhe çdo delegati këtu, është tendencë për me thy edhe për me shkelë demokracinë. Ne kemi ardhë këtu përmes votës së qytetarit, ne përfaqësojmë qytetarin. I bijmë këtu, sidomos te pika eventuale, na bijmë shqetësime të qytetarëve. Ju lutem, nuk mundesh mos me e qit në rend të ditës pikën eventuale edhe nuk mundesh me ma forcue ose me më tregu se çka duhet unë me thonë. Ne jemi Kuvend këtu, për me u shpreh. Nëse doni na mos me u shpreh, atëherë po dalim krejt jashtë edhe po e lëmë këtë seancë.

**Bexhet Xheladini:** Të nderuar delegatë, sa i përket pyetjes të Raportit të performancës, unë edhe në fjalimin tim kur e dhashë Raportin e Punës, thashë se jemi në mesin e 11 komunave përfituese të Grantit të Performancës. Nga 38 komuna sa kanë konkurrue, 11 jemi kualifikue dhe kemi përfitue grant, jo vetëm këtë vit por edhe vitin e kaluar. Në Plan të Punës të Drejtoratit për Administratë edhe në Planin tim të Punës, është që të përmirësohet performanca e Komunës. Këto tri javët e fundit kemi pas edhe disa trajnime, e kemi trajnue stafin i cili bën ngarkimin e të dhënave në sistem. Kemi pas probleme në këtë drejtim, sepse njerëzit të cilët kanë qenë dhe janë anëtarë të Grupit të Performancës, disa të dhëna i kanë ngarkue gabim. Kështu që, besoj se në raportin e ardhshëm të performancës, ne këso gabime nuk do të kemi edhe do të jemi jo vetëm përfitues të Grantit të Performancës, por edhe do ta kemi një performancë shumë më të mirë sesa që e kemi tash. Kështu që, nuk është e vërtetë që jemi në mesin e atyre tri komunave më të këqija në Kosovë. Unë e tregova një realitet, jemi në mesin e 11 komunave më të mira që kemi fitue. Sa i përket reagimit të Uranit, më vjen keq që ai nuk është këtu tash, ai kaloi në disa çështje personale dhe etiketime të cilat nuk i përkasin një asambleisti, se ai nuk ka hy me e lexue edhe me e pa biografinë time, cila është e kaluara ime. Mirëpo, sa i përket akuzave për punësime të njerëzve të cilët janë në struktura paralele, kjo nuk është e vërtetë. Asnjë njeri, asnjë person nuk e kemi punësuar në Komunë që është i strukturave paralele. Bëhet fjalë për një person të shkarkuar nga Kryeministri Kurti, i cili ka qenë punëtor i kësaj Komune, dhe sigurisht është marrë ai në punë në vitin 2019, kur unë nuk kam qenë kryetar. Dhe, prapë unë kur nuk kam qenë kryetar, ai është emëruar si këshilltar politik apo zëvendësministër – nuk e di çka ka qenë – i Qeverisë Kurti. Para dy muajve ai është shkarkue, në Vendimin e tij nuk shkruan asgjë, për çka është shkarkue, vetëm ‘shkarkohet nga detyra’. Personi në fjalë ka të drejtën ligjore dhe kushtetuese që të kthehet në vendin e tij të mëparshëm,

për arsye se në kontratën që e ka nënshkruar kur është emëruar si këshilltar politik, aty shkruan që ai duhet të kthehet në vendin e tij të punës. Ne nuk kemi bërë asgjë tjetër, nuk e kemi punësuar, por e kemi kthyer në vendin e tij të punës. Gjithashtu, unë nuk kam njohuri, as të dhëna, se ai është punëtor i strukturave paralele, dhe se zhurma që është bërë ndaj tij edhe kundër tij, është bërë për një fotografi e cila është shkrepur në një ndejë, në një restorant në vitin 2019, kur kanë hëngër drekë disa persona. Dhe, unë si kryetar i Komunës nuk muj të kërkoj me e larguar prej punës në bazë të një fotografie ku shihen se ata persona janë duke hëngër drekë. Ne nuk jemi në kohën e Millosheviqit, me i larguar njerëzit, me i përzënë njerëzit, por jemi në kohën e demokracisë, Kosova është një shtet demokratik, është Republikë dhe ajo nuk i diskriminon njerëzit në baza të përkatësisë së tyre. Por, unë në këtë rast e kam zbatuar ligjin edhe ai u kthye në vendin e tij të punës. Sa i përket të punësuarit tjetër që ai deshti me e thënë, Elvis Ibrahimimi, unë dje e kam bërë edhe një reagim në Facebook në këtë drejtim dhe i jam përgjigj dezinformatave të LVV-së dhe Uran Halimit, por dje kam dhënë edhe një intervistë në Televizionin T7, ku kam deklaruar se Elvis Ibrahimimi ka konkurrue në Konkursin e shpallur nga DKA-ja, dhe aty në atë konkurs është kërkuar diploma e fakultetit. Ai aty ka konkurrue me diplomë të fakultetit të kryer në Universitetin “Ukshin Hoti”. Ndërsa, akuza ka qenë se ai e ka krye shkollën e mesme në Dragash, këtu në atë shkollë paralele në fshatin Mlikë. Nëse e shikojmë atë dëftesë, shihet se ajo është me origjinë nga Novi Sadi, dhe ai shkollën e mesme e ka kryer në Novi Sad. Të njëjtën shkollë të mesme ai e ka nostrifikuar në institucionet e RKS-së, ku në mes tjerash, thuhet: Kjo diplomë është valide dhe me këtë diplomë personi ka të drejtë të regjistrohet në të gjitha fakultetet e RKS-së. Ai me atë diplomë është regjistruar në fakultet të RKS-së, e ka krye fakultetin në Universitetin “Ukshin Hoti” dhe në bazë të asaj ai është punësuar. Dhe, ka qenë i vetmi kandidat i cili i ka plotësuar kushtet e konkursit, në krahasim me kandidatët tjerë. Ka qenë fjalë për konkursin për afër 9 vende të punës, me kërkesë të Inspektoriatit, për arsye se këta persona kanë qenë joadekuat. Aty, në reagimin e VV-së janë apostrofuar edhe dy të afërm të drejtorit të Shëndetësisë, baba i drejtorit dhe një i afërm tjetër me mbiemrin Brenoli. Siç e dini, baba i Brenolit është një punëtor i cili e ka hap shkollën në gjuhën boshnjake, me mësim në bazë të planprogrameve të RKS-së. Është një person i cili i ka afër 25 vjet përvojë pune, dhe atij i është shpallë konkursi për arsye se është joadekuat dhe, pasi se nuk ka pas kandidat tjerë të cilët i kanë plotësuar kushtet, është marrë prapë në punë, ai faktikisht ka qenë edhe duke punuar, nuk i është ndërprerë marrëdhënia e punës. Unë nuk besoj që ka dikush tjetër ndonjë pyetje me ma bo në këtë drejtim. Unë ju falënderoj edhe një herë!

**Shpetim Hajredini:** Nuk është problemi ma përmende e s'ma përmende, duhet pak me qenë ma real edhe me kuptuar qytetari çka kam dashtë unë me thënë edhe ti çka deshte me thënë. Atë çka ti m'u përgjigje mu, unë nuk e parashtrova pyetjen. Unë e parashtrova pyetjen vetëm për shërbimet e Administratës. Do të thotë, MAPL-ja e bën ndarjen, Granti i Performancës është i kompletuar, merret

si komplet, si pako është. Unë fola vetëm për Administratën dhe shërbimet në Administratë, aty i ka vlerësue MAPL-ja shumë ulët. Për atë thashë. Do të thotë, MAPL-ja – unë për me qenë edhe i qartë, nuk po e mbaj as kah kamerat, ty ta bie tash e sheh – jo s’ka nevojë, unë ia dërgoj kryetarit dhe e sheh ku renditet me shërbime Administrata në bazë të MAPL-së. Në bazë të kriterëve të cilat i ka përcaktue MAPL-ja, Komuna e Dragashit është niveluar prej fundit e treta. Prej 30-ve, është e treta prej fundit. Shërbimet administrative, këtu shkruan shumë qartë. Këtu ishte problematika, që deshta me e ditë nëse Vetimi ka marrë këtë informacion – besoj që e ka marrë – dhe pse ka ndodhë kjo. A lidhet me atë që ti e thaje pak më herët, që zyrtarët nuk kanë pas njohuri të bartjes së informacioneve përmes sistemit të informimit, SMPK që thaje ti. Apo është diçka tjetër? Këtë unë nuk po e di, për këtë edhe e parashtrova pyetjen, pse qëndrojmë të tretit prej fundit? Vetëm këtë deshta me e ditë, po pasi që nuk është ai, unë thashë nuk po të obligoj ty me më dhënë përgjigje, kur të vjen Vetimi, ai besoj që e di dhe ma jep një shpjegim pak më të detajuar. Sa i përket për Grantin e Performancës, ne krejt e dimë që e ka fitue Komuna e Dragashit, dhe krejt është në rregull, është okej. Mirëpo, unë besoj që me një ndryshim dhe me një ngritje pak më të lartë në këtë statistikë, ne do të marrim edhe një shumë pak më të lartë edhe të Grantit të Performancës, pasi që lidhet me këtë dhe është zinxhir. Dhe nuk shkon vetëm me buxhet, po shkon edhe me shërbimet administrative dhe janë katër kriteret të cilat e përcaktojnë Grantin e Performancës. Nuk shkon vetëm po e realizoj komplet buxhetin edhe po e marrë GP-në, e merr të ulët shumë nëse nuk i ke këto tjerat. Po de, qato po e them edhe unë, po e lidhi me atë që nuk është kriteri kryesor vetëm shpenzimi i buxhetit, janë edhe tri tjera të cilat e përcaktojnë GP-në. Ju faleminderit!

**Driton Ademi:** Një pyetje për kryetarin, një përgjigje me dalë me e thënë, se ia kam thonë edhe herërn e mromë, edhe Samidini është prezent këtu. Dole edhe thaje këtu na e kemi bo fasadimin në Bresanë, në QMF. Po ti nuk ke bo fasadim, veç ngjyrosje ke bo, edhe plus një banjo e ke ndreq aty. 3 mijë euro një ngjyrosje e ke bo edhe një banjo e ke ndreq. Mos del me i manipulue qytetarët në Bresanë, se shumë mirë e di Samidini, punon aty. Një ngjyrosje edhe plus pjesa ku marrin infuzion, hajde kqyre edhe sot qysh është, ato sallat qysh janë. Edhe pjesa e Samidinit ku është në laboratorin. Domethënë është katastrof aty. Me 3 mijë euro – ju thashë edhe në seancën e kaluar – keni bo ma keq se që keni investue. Drejtor, një pyetje: sa ka qenë marrëveshja e bashkëpunimit mes Drejtorisë së Shëndetësisë edhe “Human Care”? Marrëveshja e bashkëpunimit, sa ka qenë çmimi që e keni marrë? Edhe një pyetje për drejtorin e Arsimit: shumë statistika drejtor në arsim, po asnjë statistikë sa nxënës kemi bre drejtor, s’po e dimë na. As në Gjimnaz, as në shkollë fillore, as të ndamë nëpër secilën shkollë s’po e dimë sa nxënës kemi. Ju e keni marrë një masë që me i pru nxënësit, sidomos të Gjimnazit, prej të gjitha fshatrave me i pru në Gjimnaz, prej shtatorit. Pyetja është: çfarë ndryshimi keni në regjistrimin e

nxënësve në Gjimnaz prej vitit 2022 në vitin 2023. Edhe pse ju thoni se ia kemi lehtësue, është e vërtetë, ia keni lehtësue me autobus, me udhëtim, po a bën me e ditë çfarë ndryshimi ka të nxënësive, edhe nëse ka ndryshim, a pritet të ketë edhe në vitin 2024? Faleminderit!

**Artan Loshaj:** Përsëritje, të nderuar kolegë! Unë, para se me ia nis, kërkoj vëmendje nga drejtorët, e sidomos nga drejtori i Drejtoratit për Shëndetësi. Unë sa e di, nuk e njeh shumë mirë gjuhën shqipe, është mirë le t'i vë dëgjueset, le t'i merr mirë pyetjet dhe përgjigjet, se po më vjen se po na injoron si qysh e ka marak me na injorue. Po nejtse, unë prapë po vazhdoj. Te Raporti i Punës për shëndetësi edhe Planin për 2024-tën. z.Sejdilari diskutoi shumë edhe të gjitha këto, jo janë të vërteta, po janë shumë shumë të vërteta. Veç deshta pak me e përmbush këtë diskutim të Nexhës. Për shembull, nuk kemi material higjienik. Në këtë vit – në Raport shkruan që ka pas mbi 55 vizita shëndetësore dhe mbi 78 shërbime. Si është e mundur në këtë shekull mos të ketë shampun, mos të ketë letra për pastrimin e duarve, mos të ketë ujë të nxehtë. Çdo e dyta fjalë e drejtorit është parandalimi dhe edukimi i stafit edhe i pacientëve. Çfarë parandalimi mujsh me bo pa ujë të nxehtë edhe pa shambon e pa palloma. Si është e mundshme, edhe në EC kur shkon pacienti me krye shërbim aty, nuk ka send aty. Është e pafalshme. E dyta është që, thatë se ka mungesë të stafit, sidomos të mjekëve, në pjesën e Gorës. Po i njëjti drejtor dhe po e njëjta parti, kur kishte mjek, për çështje personale, partiake, nuk i kanë pranuar dhe tani ata mjekët punojnë jashtë Kosovës edhe janë mjekë me zë edhe me emër. Këtu diskutuam më herët edhe për shumë sende, unë po due me i thënë drejtorit që problemi i dritave, e di shumë mirë, e kemi edhe motrën kolege këtu, Nedžmidini shpesh na viziton aty, problemi i rrymës në Urgjencë, që shpeshherë nuk e dinë pacientët nga cila hymje me hi, është problemi se para tri-katër viteve është ndërtuar Urgjenca e re, kryetari sapo pat ardhë në pushtet e pat pre shiritin, e njëjta Urgjencë kur është pre shiriti para dy viteve, pikon kulmi, edhe nga kulmi gjithë ai problemi i rrymës elektrike është. Nuk kemi drita për me e ditë, bare një shenjë nuk e kanë bo njëdrejtimshme me shkue për me hy në Urgjencë. Pacientët ka mundësi edhe natën me u kthye prapë. z.Drejtori, me krejt këtë Raportin që ka gojën plot me tendera, këtij më shumë – i kam dhënë edhe më herët – i shkon për shtati me qenë drejtor i Urbanizmit, se drejtor i Shëndetësisë, se për gjashtë vjet e mos me u mësue pak me udhëheq, jo që duhet me çue me e kontrollue, po ky është një laik i shëndetësisë, edhe po më vjen keq qysh munden me qenë një këshilltar i një doktori me 40 vjet përvojë pune. E fundit për participimin, ju z.drejtor nuk e respektoni Vendimin e këtij Kuvendi, ju kam thënë edhe disa herë, po ju po e bëni për çështje politike, bile edhe sot më shumë keni bo politikë këtu, na opozita edhe Kuvendi veç ju kemi ngue çka po folni – më 29.04.2021 është marrë Vendimi që participimi të ndërpritet në Komunën e Dragashit, deri sa të është Pandemia. Zyrtarisht, Pandemia ka përfundue qe gjashtë muaj, e ju qe gjashtë muaj punoni ilegalisht edhe nuk e respektoni këtë Kuvend. Ju kam thënë edhe në seancën e parë, po të them edhe këtë herë, për herë të fundit, se me siguri këtë herë ke me m'dëgjue. Edhe unë jam për vazhdimin e participimit, mos me iu



marrë qytetarëve, po të lutem, me atë kokëfortësinë tënde, zbutu pak, ktheju këtij Kuvendi, bjere në Kuvend për miratim, për me vazhduë participimin, mos iu me marrë, ose me fillue me u marrë participimi. Edhe e fundit, tash s'po di cilin me e pyet, a drejtorin e Financave apo zyrtarin nga Urbanizmi, vazot e luleve në trotuaret në Dragash, i keni largue kur ra bora, kur do t'i ktheni, a i keni çue kah Durrësi ato lulat me u rrit prapë a qysh janë sendet, se bajagi është një tender goxha i bukur. Faleminderit!

**Shpetim Hajredini:** E di që jena lodhur të gjithë, po patjetër jemi të detyruar për hir të qytetarëve që ta vazhdojmë seancën dhe të paraqesim para drejtorëve përkatës ato shqetësimet të cilat i preokupojnë qytetarët, por edhe neve natyrisht. Do të vazhdoj me Drejtorinë e Financave. I nderuar drejtor, një prej sektorëve apo njësive kryesore të kësaj drejtorie është edhe zhvillimi ekonomik. Kam nxjerrë edhe statistikën dhe performancën e Komunës së Dragashit sa i përket edhe zhvillimit ekonomik. Nuk e di ti saktë nëse e ke shikuar se ku gjendemi ne si komunë. Unë po ta jap si informacion, që Komuna e Dragashit sa i përket këtij sektori, do të thotë zhvillimit ekonomik, në krahasim me komunat tjera qëndron pak më mirë se ajo që ishte shërbimet administrative, dhe është diku i dhjeti apo i njëmbëdhjeti, në mos gabofsha, prej fundit. Çka do të bëhet në vitin e ardhshëm, ke planifikuar diçka të veçantë dhe ke diskutuar, besoj, me njerëz përkatës të MAPL-së të cilët tregojnë ngecjet në këtë drejtori, dhe besoj që një gjë të tillë ti e ke bërë. Pres përgjigje, të më tregosh se çfarë do të ndodhë në vitin e ardhshëm për të rritur performancën dhe për të arritur edhe marrë edhe Grantin shumë më të lartë se që e kemi marrë këto dy vite. Tjetra: në Raportin e vitit 2023, gjatë leximit hasa prapë që është potencuar dhe ka vazhduar aty të qëndrojnë prapë Raporti periodik për zbatimin e progresit. Unë nuk e maj në mend këtë që e kena pas. Ta kam thënë edhe vitin e kaluar, Raportin e Progresit Periodik nuk e kena pas në seancë. Prandaj, kjo është dashtë në Raport të shlyhet, të hiqet dhe mos të qëndrojnë në material. Tjetra, i nderuar drejtor, kena marrë Vendim për faljen prej 100 eurove të tatimit në pronë për vitin 2023. Ke dhënë përgjigje në seancën e kaluar, por ajo përgjigje nuk ka pas të bëjë me atë që kanë kërkuar assembleistët, ti pak i ke lakue, i ke driblue, ata po thojnë na ka driblue drejtori. Unë kisha pas qef mu mos me më driblue, ma jep vetëm përgjigjen direkt. Pse nuk kemi mbajtur seancë e cila do të ishte përfundimtare për faljen e 100 eurshit për qytetarët e Dragashit? Tjetra, na përmende, e pashë, dhaje lavdata për tatimin në pronë. Rritja e inkasimit thaje, prej 9% në vitin 2023 në krahasim me vitin 2022. I nderuar drejtor, kjo rritje e pagesës së faturave apo kjo lavdatë e punonjësve të tatimit, sa është reale me atë që e thaje ti? Mos rastësisht, i nderuar drejtor, kjo rritje qëndron për shkak të rritjes së faturave? Apo pagesave më të larta që i kanë krye qytetarët, në krahasim me vitet tjera? Tjera pyetje nuk kam për drejtorin e Financave. Do të vazhdoj pak me Drejtorinë e Shëndetësisë, besoj që e kena – po, e paskemi këtu, respekt për drejtorin. I nderuar drejtor, realisht në vitet e kaluara nuk jam marrë fare me Drejtorinë e Shëndetësisë, se nuk i takoj atij sektori dhe nuk marr shumë vesh në atë drejtim. Gjithmonë i kam lejuar

kolegët e mi të cilët i përkasin asaj lëmie që të merren me të. Por, pas parashtrimit të disa pyetjeve të qytetarëve, jam i detyruar atëherë t'i parashtroj ato para jush. E para ka të bëjë me laboratorin në QKMF dhe në QMF – Bresanë. Pse nuk ka punuar, në bazë të disa qytetarëve, një periudhë kohore të gjatë? Pastaj, edhe Rëntgeni gjithashtu në Dragash. Dhe, tjera... besoj që një pjesë të pyetjeve të cilat m'i kanë parashtruar, pata me i parashtruar, i bëri veç Artani, nuk kam pse t'i përsdyti. Vazhdojmë me Drejtorinë e Bujqësisë, Turizmit dhe Zhvillimit Rural, drejtori të cilën unë e kam për qefi dhe kam shumë dëshirë që të diskutoj për këtë drejtori. Por fatkeqësisht, kjo drejtori gjithmonë është lënë si dytësore, si nga ana e PDK-së, si ju tash. Në vend se ta kem ne Drejtorinë e Bujqësisë, ta mbajmë, ta kemi si primare, ne e lëmë si dytësore. Por, kjo nuk është në dorën time dhe kjo nuk varet nga unë. I nderuar drejtor i Bujqësisë, do të mundohem të jem i qartë. Në vitin e kaluar, gjatë raportimit, në Planin e Punës unë pata kërkuar që, në bazë të mundësive financiare, të ndihmohet sektori i qumështit edhe pse ndihmohet direkt edhe nga Qeveria. Pra, të ndihmohet qumështi edhe nga ana e Komunës, me mundësi – kam thënë – financiare, 2 a 3 cent, sa të ketë mundësi t'i shtohet, pasi që ky sektor ka nevojë që edhe ne si Komunë t'u gjendemi pranë. Por, nuk ka ndodhur një gjë e tillë në vitin e kaluar. A ka mundësi të di – edhe pse në Planin e Punës prapë që e kam lexuar – nuk shikova diçka të tillë, nuk lexova diçka të tillë që është planifikuar të ndodhë edhe për këtë vit. Kisha pas dëshirë që të më jepni përgjigje, pse nuk e keni planifikuar një gjë të tillë. Tjetra, i nderuar drejtor, të cilën deshta ta kërkoj prapë për këtë sektor, është dhe ka të bëjë me subvencionimin e mështjerrave, të cilat mështjerra apo ta them më realisht, një pjesë, ne jemi të gjithë të fshatit dhe e kuptojmë, janë ajo moshë prej se lindin deri në moshën kur arrijnë të japin qumështin apo e kryejnë lindjen. Gjatë kësaj periudhe kohore, një pjesë e komunave po i subvencionojnë 600-700 euro. Kjo po bëhet për hir të asaj që ky sektor, këta njerëz, këta qytetarë, me të madhe po largohen nga veprimtaria e tyre. Prandaj, i nderuar drejtor, subvencionimi i kësaj kategorie është shumë i nevojshëm dhe momenti, edhe kohor, është i duhuri. Pasi që, vetëm subvencionimi i kësaj kategorie që po e kërkoj unë, jam i bindur që do të ndikojë edhe në rritjen dhe zhvillimin ekonomik, pasi që ndikon në rritjen e numrit të bagëtive të cilat do t'i mbajnë fermerët. Ndikon në rritjen e numrit të punëtorëve, direkt, dhe realisht, këto janë zinxhir dhe ndikon gjithashtu edhe në rritjen ekonomike të Komunës, pasi që më këta fermerë nuk do të kenë nevojë që të blejnë lopë të ardhura nga qytetet – qytetet të themi, prapë ndikon në vendin tonë – po shtetet përreth. Dhe, një pjesë e madhe e të hyrave të fermerëve po kalon në shtetet tjera, pasi që ata po blejnë, po bëjnë rritjen e numrit të bagëtive nga ardhja e lopëve nga shtetet tjera në shtetin tonë. Një mundësi tjetër të cilën e kemi ne si Komunë dhe të cilën besoj që duhet ta aplikoni këtë vit, është edhe ndihma në mjetet bujqësore. Secila prej këtyre triave që t'i propozova unë, ti ta kesh parasysh dhe ta aplikosh, do të ndikojë në të mirën e tyre. Prandaj, i nderuar drejtor, po besoj që këto pyetje të mia, këto nevoja të fermerëve nuk do të hasin në vesh të shurdhër dhe nuk do të mbesin vetëm si pyetje, por së paku njëra prej tyre të aplikohet dhe po

shpresojmë që do të ndikojë në të mirën e tyre dhe do t'i ndalë që mos të zhduket ky sektor i tërë, pasi që edhe Komuna jonë është e varur nga këta dy sektorë. Ju faleminderit!

**Sabahat Hasani:** Prapë përshëndetje! Artani nuk është. E bëri pyetjen ku kanë mbet dhe çka do të bëhet me vazot e luleve që ishin tërhek në kohën e dimrit. Këto vazo rikthehen tash, në muajin prill. Janë të deponume, ashtu ka qenë tenderi që të deponohen nga ajo kompani që i ka pru. Tash do të risillen, së bashku me mbjellje të luleve të reja. Kjo ishte ajo sa për Artanin, mirëpo nuk është këtu. Janë të deponume, e kemi vendin dhe e dini ju shumë mirë, po po keni kapak marak në këtë Ramazan iftarin me na bo përpara. Shnet!

**Behar Brenoli:** Të nderuar, e kuptoj që opozita ka të drejtë të kritikojë, por kur disa individë tentojnë të abuzojnë me këtë foltore, nuk është mirë, në radhë të parë për ta, populli e sheh çdo ditë se kush po bën të njëjtën gjë dhe sa po punohet në ndonjë sektor, veçanërisht në shëndetësi. Në QKMF, ngrohja funksionon edhe është e ngrohtë lart. Ngrohja qendrore punon deri në orën 15:00, sepse nuk është e dobishme të ngrohet i gjithë objekti pas kësaj kohe dhe nuk mund të ndahet një pjesë nga tjetra. Vetëm duke ndërprerë ngrohjen pas orës 15:00, kemi kursyer rreth 15,000 litra naftë. Dhoma e urgjencës ka tre lloje të ngrohjes dhe nuk është ftohtë atje. Vitin e kaluar kemi marrë një udhëzim për kursimin e energjisë ku kërkohet rreptësisht 19 gradë, nuk ka ndodhur pa qenë nën 21 apo 22 gradë. Ne cdo dhomë ka kondicioner, kemi edhe ngrohje. Pak më parë ju votuat buxhetin ku do të vendosim pompa nxehtësie që do të kursejnë energji. Sa i përket automjeteve, ne nuk kemi një automjet, kemi 8 automjete. Kemi veshtiresi me servisim, vetura citroen e cekur ka problem, ndodh ndonjëherë për shkak të karburantit që vetura të humbe karburant për një moment dhe të mos marrë me shume se 2000 rrotullime dhe kjo nuk ndodh kur vetura shkon në Prizren me pacient. Ne kemi 3 automjete në shërbimin e urgjencës, jo një. Sa për ajrim, urgjenca ka ventilim, nuk e di kush të genjen se nuk ekziston. I gjithë godina ka ajrosje dhe projekti është bërë nga inxhinierë. Ka pasur një problem me dritën, ne kemi një projekt të ri rinovimi dhe do ta zgjidhim atë problem gjatë kësaj. Sa i përket reagentëve kemi pasur vështirësi, e dini si ka qenë situata vitin e kaluar me dështime të pajisjeve, nuk dua të them më shumë se kaq dhe të them se ndoshta ka pasur një lloj sabotimi, nuk kam asnjë provë.. Nga departamenti i prokurimit kam informacion se jemi drejt fundit të nënshkrimit të kontratës për reagentët dhe të gjithë laboratorët tanë do të punojnë me kapacitet të plotë. Ne kemi pasur një renovim në Brodosanë dhe duhet të vazhdojmë kështu. Mirëmbajtja ishte një problem atje dhe kjo çoi në një situatë të tillë, tani është shumë më mirë. Ka pasur problem me ujin dhe një tub të lagësht, nëse vazhdon kështu do të përfundojmë të gjithë sistemin e ujit. Mjeku i përmendur është larguar në Turqi në vitin 2009, unë jam drejtor i shëndetësisë që nga viti 2018 dhe kur e kam marrë atë mandat kemi punësuar 3 mjekë nga komuniteti jo shumicë. Çdo vit kemi një konkurs. Të gjithë, veçanërisht punonjësit e shëndetësisë, mund të dëshmojnë se si ka qenë situata para vitit 2018 dhe si është tani.

**Nuhija Tairovci:** Më ka pasur një pyetje në lidhje me rrëshqitjen e dheut në rrugën për në Restelicë, kjo pyetje është përcjellë, në planin e punës që kam dhënë thotë: të përfshihet në listën e investimeve kapitale ndërtimin e mureve mbajtëse dhe rrjeteve në vende më të rrezikshmit.. Obligim i Drejtorisë është që të jetë në kontakt me Institutin Gjeologjik të Kosovës, të cilët vazhdimisht janë në kërkim të të dhënave të nevojshme. Duke qenë se është rrugë rajonale, duhet të bëjnë diçka konkrete për të. Ndoshta këto rrugë janë rajonale, por njerëzit që lëvizin atje janë qytetarët tanë. Këtë duhet ta planifikojmë nga fondet tona ose të planifikojmë një pjesë të mjeteve me të cilat do të fillojmë me rehabilitimin e rrëshqitjes.

**Erdžan Limanče:** Tashmë e kemi në planin për një grant për teknologjinë, subvencionet e qumështit, kemi pasur nja dy takime ku kemi propozuar që të organizohet dhe të ndërtohet një mini-uzinë dhe të tregtohet më mirë. Prodhuesit kanë ofruar mbështetjen e tyre. Subvencionet për qengjat, nuk kemi mundur të bëjmë asgjë, sepse kriteret tona janë bazuar në kriteret e ministrisë.

**Qamil Kolloni:** Unë do të nisem prej Shpetimit. Shpetim, të gjitha pyetjet të cilat janë parashtruar, realisht janë pyetje që ia vlen me diskutuar edhe kërkojnë njëfarë zgjidhje. Sa i përket zhvillimit ekonomik dhe performancës, realisht edhe vetë unë si drejtor nuk jam i kënaqur për shkak të punës dhe vëllimit të punës që e kemi bërë, dhe rangimet në të cilët jemi, për arsye se kanë ndodhë disa lëshime teknike nga stafi i performancës. Nuk kemi dashtë shumë me i elaboruar. Por, gjithashtu është edhe një problem, se në kuadër të DEFZh-së hyn edhe sektori i Financave, ku kemi pas një lëshim teknik. Të gjitha raportet tremujore të cilat janë dhënë në Kuvend, për fat të keq, vetëm për shkaqe teknike nuk

janë protokollue dhe kanë ndikue shumë, na kanë ulë performancën e Drejtoratit. Gjithashtu, kemi pas edhe një gabim teknik, me dashje apo pa dashje, ku gabimisht njëri prej sektorëve të Shëndetësisë ka bërë plasimin e informatave të cilat janë diskualifikuar tërësisht dhe, faktikisht, këtë vit kemi pas një ramje në këtë Drejtorat. Por është edhe një problem esencial, që është shumë më i rëndësishëm dhe shumica edhe nuk e kuptojnë. Është problemi se në Komunën tonë, në bazë të statutit komunal kemi dualizëm të punëve nëpër drejtorate, që do ta diskutojmë në një seancë tjetër, dhe ku do të bëj një kërkesë për grupet parlamentare dhe juve si delegatë të PDK-së, që të bëjmë edhe strukturimin dhe ndarjen e drejtoratëve, për arsye se DEFZh bën dualizëm me Drejtoratin e Bujqësisë, Pylltarisë, Turizmit dhe Zhvillimit Rural. Realisht, një pjesë edhe e trashëgimisë kulturore bjer në DKRS dhe është pjesë e zhvillimit të turizmit, dhe ne duhet të ulemi të rregullojmë statutin në përgjithësi edhe drejtoratët, që të kemi mundësi në aspektin teknik të mos na shkaktohen këso probleme. Megjithatë, për shkak të shumë punëve që janë bërë, jemi klasifikue ma naltë por nuk jemi të kënaqur, ngase këto lëshime teknike nuk është dashtë të na ndodhin. Unë shpresoj që i kemi ndërmarrë të gjitha masat këtë vit dhe vitin tjetër nuk do të na përsëriten. Sa i përket Raportit të Progresit, kjo është detyrë e brendshme e drejtoratit, i cili i jipet zyrtarit për Integritet Evropian në periudha gjashtëmuajore. Besoj që e kanë praktikue edhe më herët sesa na kur kemi ardhë, e kemi si detyrë të vazhdueshme brenda drejtoratit, ku na çon zyrtari për Integritet Evropian, a e plotësojmë atë dhe e kthejmë. Falja e borxhit të tatimit në pronë, pas gjitha atyre rekomandimeve të cilat i kemi çue, Kuvendi i Komunës së Dragashit buxhetin për vitin 2024 e ka miratue para Vendimit përfundimtar të Qeverisë që mund në disa komuna të falen deri në 100 euro. Në qoftë se e kqyrim në aspektin kur na kemi diskutue, në fuqi ka qenë vendimi i gjykatës e cila iu ka dhënë të drejtë komunave. Prandaj, për këtë arsye, na kemi tregue se faturat në Komunën e Dragashit dhe vlerësimi që është bërë, edhe norma, nuk ka pas nevojë, për arsye se mbi 70% e klientëve dalin pa tatim në pronë. Dhe pyetja tjetër ishte se a është si rezultat i rritjes së faturave. Realisht, në Komunën tonë ne kemi pas zbritje të tatimit që nga viti 2021 dhe nuk kemi pas rritje. Në vitin 2022 ne kemi marrë vendimin për uljen e përqindjes dhe të interesit, nga 17 në 15. Gjithashtu, kemi pas nga 250 në 200, dhe faktikisht secila faturë ka pas 20 euro zbritje. Por kjo ka ndikue pozitivisht, se nga 3000 kemi mbri në 6000 anëtarë të cilët i kanë krye obligimet dhe kjo ka dhënë rezultat për ngritje të inkasimit. Sa i përket çështjes së subvencioneve, ato kryesisht jepen prej të hyrave vetanake. Meqenëse jepen prej të hyrave vetanake, disa projekte që në vazhdimësi Komuna i ka paraparë dhe mbulohen deri më tash, edhe subvencionet që i japim, nuk ka shumë lluft që ta rrisim. Ne jemi duke diskutuar me e gjet metodët që të gjithë fermerët të subvencionohen, në këtë rast edhe fermerët e mjedrave. Siç bëhen subvencionimet për secilën kategori, që në qoftë se gjejmë mjete, pse jo mos me i financue, kur i vetmi sektor për zhvillim ekonomik ka mbet bujqësia, konkretisht blegtoria në Komunën tonë. Sa i përket Nexhës, Nexho, pse bre po më pyesish kur kontrata është publike, sivjet

i ka kalue, e bëjmë kontratën tjetër për furnizimin e këtyre, shamponit edhe antifrizit, edhe ishalla më nuk bëhet temë diskutimi se bolla e kemi bo për PDK-në, tash më s'po e bëjmë ma tutje. Po e përfundojmë me kaq, kur të bëhet kontrata e re, e shohim çmimi i antifrizit sa po shkon, se ai është problem i përbashkët i joni, ma merr mendja.

**Zeni Krasniqi:** Të nderum delegatë, pyetja e parë e juaja ishte sa... përkundër statistikave që i kemi ofruar, numrin e nxënësve nëpër shkolla, pikërisht për shkak të volumit të punëve të mëdha, mos me ju ngarkue juve shumë me statistika, na numrin e përgjithshëm të nxënësve veç e diktuam. Këto i kemi, i kemi dërgue atje në SMIJA për secilin, por duhet me marrë parasysh, ju e dini, kemi lëvizje shumë të mëdha. Kurse sa i përket pyetjes së dytë, sa ka ndikue ky transporti i nxënësve, s'e di. Ne duke marrë parasysh xhepin, se po goditet për çdo ditë xhepi i qytetarëve, ne e pamë të arsyeshme që t'ua ofrojmë këtë mundësi qytetarëve, të cilët e kanë mirëprit këtë. Edhe sa ka ndikue ajo pozitivisht këtu në numrin në rritje ose ndryshimin e numrit, nuk mund ta marrim si barometër. Përkundër asaj, na edhe si Komision, përveç kësaj kemi punue edhe në hapjen e drejtimeve të reja në Gjimnaz, i kemi hap dy drejtime në ekonomi edhe në infermieri për drejtimin boshnjak. Po tash s'mundim me e ditë nëse ka raste ose është rrit numri i nxënësve. Por kjo normalisht se ka ndikue në xhepin e qytetarëve. Ai që e ka pas mendjen me udhëtue për Prizren, më nuk udhëton atje se e ka transportin falas. Faleminderit!

**Driton Ademi:** Drejtor i Shëndetësisë, ta bëna pyetjen a mundish me na tregue sa është marrëveshja që e keni bo me "Human Care". Çmimin e marrëveshjes sa është, edhe për sa është kontrata, a është njëvjeçare, dy apo sa është? Faleminderit!

**Nedžmidin Sejdlar:**shqip

**Arijeta Skeraj:** Faleminderit, z.Sejdlar! A do dikush tjetër? Pasi që u shterrën të gjitha, atëherë e qesim në votim. Kush është pro këtij Plani të ekzekutivit? A ka kundër? Abstenim? Me 12 vota pro, 1 kundër dhe zero abstenim, e miratojmë Planin e Punës të ekzekutivit. Atëherë fillojmë te pika e fundit, te pika eventuale. A do dikush me e marrë fjalën? Ju kisha lut të hiqen mediat dhe ekzekutivi, anëtarët e Kuvendit të mbesin brenda!

Atëherë, e kemi për vizitën studimore. Dy herë jemi takue me shefat e grupeve parlamentare, ata i kanë bërë disa kërkesa, edhe ju kisha lut, dikush që do me ndryshue ose me bo diçka rreth vizitës studimore. Unë e kam pas një kërkesë, gratë asambleiste kanë kërkuar që tri ditë të jetë vizita studimore, edhe ne

si kërkesë do ta qesim që kush ta fitojë atë tender, kush do me u kthye mas tri ditëve, e na me vazhdue pesë ditë. Katër netë e pesë ditë, si vjet qysh kemi qenë. Kush do me e marrë fjalën? Planifikimi është bërë që do të jetë në Venezia të Italisë dhe do të mundohna që me ndonjë komunë ta kemi një takim zyrtarisht, por deshta një herë mendimin tuaj dhe me e vazhdue këtë procedurë.

**Samidini Xheladini:** Unë gjithnjë, në vazhdimësi kam qenë kundër vizitave studimore, edhe gjithmonë kam kërkuar mos me i bo vizitat. Edhe kur s'kemi qenë në pushtet, edhe kur jemi në pushtet. Edhe prapë jam. Edhe kqyre, prapë s'po e kuptoni ju rolin tonë. Vendimet e Asamblesë janë ligj. Atëherë u votue dhe votohet, gjithnjë u votue edhe unë i jam përgjigj vendimit të Asamblesë. Ju nuk jeni institucionalistë, se vendimet unë gjithmonë kam votue dhe kam qenë kundër. Kam qenë edhe prapë jam kundër. Jam kundër, mos me shkue në vizitë studimore. Edhe unë po ju lus që mos me e votue. Me votue për mos me shkue. Këtë deshta me dalë me e thënë. Unë thashë, vendimi i Asamblesë është obligativ edhe shkojsh. Nuk ka hajgare, seriozisht po them, nuk bën me shkue në vizitë studimore, është fund me i dhënë mo, me e mbyllë këtë kapitull.

**Nedžmidin Sejdilar:** I nderum koleg Xheladini, s'pate nevojë me ardhë këtu me folë jam kundër vizitës. Veç mos hajde, ditën e mirë, u kry puna. Ku është problemi? Po nuk e di a e keni vërejt se i kemi përjashtu mediat, qytetari s'na sheh. Badihava edhe marketingun e pate. Kryesuese, a ban të vazhoj tash, se pata pak humor me Samidinin, se e due unë Samidinin shumë. Kështu, unë jam i mendimit, destinacioni është okej, plani është okej, e dimë Italinë, Venezia është në agjendë, masanej agjendën komisionet do të takohen, do të bëjnë ndonjë agjendë edhe e shpallim në tender edhe ditën e mirë. Do të thotë, propozimi im është, destinacioni është Italia, në atë agjendë e dimë Venezian që do ta vizitojmë. Edhe jam i mendimit tuaj që pa qare duhet me e vizitu ndonjë institucion atje, me pa pak përvojën qysh e kanë shtetet evropiane. Ndoshta na jemi knej gabim, ose jau tregojmë këtyre, ju jeni gabim, merrni shembullin tonë. Ju faleminderit shumë!

**Arijeta Skeraj:** Okej! Destinacioni është Italia. Kur të bëhet komisioni, atëherë vendoset agjenda ku kemi me qëndrue. Edhe, shefat e grupeve të Kuvendit kanë kërkuar që të jetë gjysma e muajit maj. Jo fundi, por prej 15 e tutje me qenë, gjysma e dytë e majit. Për financat, i kemi financa diku 20 mijë euro, kështu e përcaktuam. Diçka tjetër a doni me diskutue? Po, do të formojmë, por do të jenë shefat e grupeve. Janë anëtarët e Kuvendit të cilat janë nëna me fëmijë të vegjël, ato kanë planifikue që tri ditë me qëndrue, pesë ditë nuk mundin me i lënë. Por, me kompaninë që do ta marrë, do ta kemi mundësinë që kush kthehet do të kthehet. Të gjithë shefat e grupeve kanë kërkuar që asnjë mos me qenë jashtë Kuvendit, përveç tre kanë me qenë nga ekzekutivi, kryetari me dy persona që ai vetë ka me i përzgjedhë. Okej, e qesim në votim këtë vendimin që duhet të shkojmë veç anëtarët e Kuvendit dhe kryetari me dy nga ekzekutivi. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? 14 vota pro, 1 kundër dhe zero abstenim, e miratojmë këtë. E mbyllim këtë seancë!